

MUHAMED MUTEVELI ESH-SHAËRAVI

MADHËSHTIA E ISLAMIT

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik

KAPITULLI I PARË

Dinamika dhe Statika
Njeriu dhe ligji i ndryshimeve
Mendja dhe zbulimet shkencore
Me fuqinë e Allahut, jo me fuqinë tënde
Sekretet dhe vetmashtimi i njeriut

Dinamika dhe Statika

Çështjes së *përfundimit të botës* i është dhënë rëndësi e veçantë nga shkencëtarët, bile për të kanë folur edhe magjistarët e injorantët. Secili prej tyre është munduar që të jep analiza për kohën e sodit apo për kohën në të cilën po kalon bota në të cilën jetojmë.

Të gjitha teoritë shkencore të cilat janë thënë apo thuhën, baza e tyre është vetëm hipotetike, imagjinare dhe nuk jopraktike. Kjo nga shkak se kapaciteti i diturisë njerëzore në këtë çështje është i kufizuar dhe nuk mund të arrij në *dituri të sigurt*.

Astronomia është ende një fëmijë i cili sapo ka filluar të rritet. Edhe pse zbulimet më të reja shkencore të njeriut kanë arritur pikën kulmore, ne prapë u themi: Ekzistojnë yje dhe planetë, të cilët janë larg tokës, në largësi të miliona viteve të dritës, por edhe më larg. Sa i përket qiellit, atë çka ne e njohim për të, është shumë e vogël në krahasim me atë çka nuk e dimë. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'anin fisnik na ka lajmëruar se *qiell* është çdo gjë që është mbi ne. Qiell nënkupton çdo gjë që të mbulon dhe që është mbi ty. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَالسَّمَاءَ بَنَيْنَاهَا بِأَيْدٍ وَإِنَّا لَمُوسِعُونَ ﴿٤٧﴾

“Ne, me forcën tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë.” (Edh-Dharijat : 47)

Në këtë rast, zgjerimi nuk ka të bëjë me atë çka e parasheh njeriu, por atë çka e ka në fuqi Zoti i Lartmadhëruar, për këtë arsye, çdo herë kur shkencëtarët mendojnë se kanë arritur në fund të një teorie, e bëjnë një zbulim të ri i cili është në kundërshtim me atë çka kanë deklaruar më parë, sepse para tyre paraqiten dimensione (kosmose) të reja. Teoritë e tyre ndryshojnë për çdo vit. Prej tyre vërtetohet vetëm ajo se, kanë menduar se kanë arritur tek e vërteta, mirëpo në realitet ata nuk kanë arritur askund.

Nëse i vështrojmë magjistarët dhe parashikuesit, do të shohim se ata, për çdo vit apo për çdo dekadë lajmërojnë se fundi i botës do të ndodhë në këtë apo në atë ditë. Është interesant se shumica e njerëzve u besojnë atyre edhe pse ata nuk kanë njohuri shkencore.

Ka ndodhur në Amerikë, që një parashikues ka lajmëruar (ka parashikuar) se fundi i botës do të jetë në filan ditën dhe njerëzit i kanë besuar dhe i kanë lënë shtëpitë e tyre dhe janë ngjitur në lartësitë më të larta të kodrave, duke menduar se atje do të jenë të sigurt dhe do të shpëtojnë.

Natyrisht, ajo ditë ka kaluar dhe nuk ka ndodhur asgjë. Dhe tek atëherë, njerëzit e kanë kuptuar se janë mashtruar.

Ekzistojnë me dhjetëra e dhjetëra parashikues hindusë dhe të tjerë të cilët për fundin e botës kanë dhënë parashikime interesante dhe që të gjitha me vonë kanë dalë të jenë gabim. Këto parashikime nuk kanë pasur asgjë të përbashkët me logjikën dhe shkencën, por kanë qenë (dhe do të jenë) vetëm parashikime false me të cilat synohet fitimi i pasurisë. Kjo për shkakun se fundin e botës nuk e di askush tjetër pos Allahut të Lartmadhëruar dhe këtë lajm Ai nuk ia ka treguar askujt, bile as melaqeve më të afërta të Tij.

Para se të fillojmë bisedën për temën, patjetër duhet të flasim për statikën (bota ekzakte) dhe dinamikën (të ndryshueshmen).

Statika (bota ekzakte) është bota të cilën Zoti i Lartmadhëruar e ka krijuar për njeriun. Këtë hapësirë kozmike, prej tokës deri në qiell, Zoti i Lartmadhëruar e ka bërë që të jetë e nënshtruar (në shërbim) për njeriun, që të veprojë sipas ligjeve (të fizikës) të cilat nuk ndryshojnë, përderisa njeriun, për të cilin është krijuar gjithësia, e ka bërë që të jetë i ndryshueshëm.

Njeriu ndryshon, prej fortësisë së tij në dobësi, prej shëndetit në sëmundje, prej aftësisë në paaftësi, prej jetës në vdekje, prej gjendjes së shëndoshë psikike në sëmundje psikike.

Ndryshimet e njeriut në jetën e tij, kalojnë prej një faze në fazën tjetër, kurse *gjithësia* nga natyrshmëria e tij është statike dhe nuk ndryshon.

Nëse i bëjmë një vështrim *ndryshimit* i cili i ndodh njeriut, shohim se ky ndryshim ndodh në bazë të një *ligji* të cilin nuk e dimë (nuk e njohim). Kalimi i njeriut prej gjendjes së shëndoshë në sëmundje, ose prej aftësisë në paaftësi, ose prej gjallërisë në të vdekur, të gjitha këto çështje në përgjithësi nuk dihen se kur ndodhin. Kjo nënkupton se ne nuk mund ta përcaktojmë se kur njeriu do të kalon prej gjendjes së shëndoshë në gjendje të sëmundjes, sepse po të dinim t'i përcaktojmë ligjet e saj (ndryshimit), ndoshta do të kishim mundur ta pengojmë dhe ta ndalim.

Ai është *ligj sekret* për ne dhe për këtë dijetarët thonë: Medicina nuk mund të arrij deri aty, por vetëm deri te *ligji i supozuar*, i cili ndërtohet në bazë të statistikave të cilat japin disa mendime, por ato janë vetëm mendime dhe nuk janë të vërteta shkencore.

Mirëpo, parashtrohet pyetja: Pse njeriu është dinamik (i ndryshueshëm), përderisa gjithçka tjetër që është krijuar për të i nënshtrohen ligjeve (ekzakthe) dhe janë të pandryshueshme?.

Përgjigjja është se: kjo gjithësi është krijuar për të (si lloj), për t'ia plotësuar mjetet dhe nevojat e ekzistencës dhe nuk është krijuar vetëm për një gjeneratë dhe që ajo gjithësi të përfundoj me përfundimin e asaj gjenerate. Por (gjithësia) është krijuar për të gjitha gjeneratat deri në ditën e Kijametit. Kështu që gjithësia pranon gjeneratë pas gjenerate dhe për të gjitha gjeneratat vlejnë të njëjtat ligje.

Prej Ademit a.s. e deri më sot, nëse në tokë e mbjell farën, e ujit dhe kujdesesh për të, në bazë të sezoneve të saj jep fryte dhe ia plotëson (njeriut) nevojat ushqimore.

Prej kohës së Ademit a.s. e deri më sot, asnjëherë nuk ka refuzuar toka që të jep të vjela, të korrura dhe fryte. Asnjëherë nuk ka thënë se do të jap fryte për këtë gjeneratë dhe nuk do të jap fryte për gjeneratën tjetër e cila vjen pas saj, por e njëjtë ka qenë për secilën gjeneratë.

Dielli, prej kohës së Ademit a.s. e deri më sot lind me llogaritje precize dhe perëndon me llogaritje precize dhe ne nuk dimë se ndonjëherë ka ndodhur që ai (dielli) të ketë rrezatuar për një gjeneratë dhe të mos ketë rrezatuar për një gjeneratë tjetër.

Po ashtu, shiu dhe qielli, dhe mjetet e tjetra të jetës, që të gjitha funksionojnë (shërbejnë) për secilën gjeneratë dhe kurrë nuk kanë ndryshuar. Këtë e tregon edhe thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

الشَّمْسُ وَالْقَمَرُ بِحُسْبَانٍ ﴿٥٠﴾

“Dielli dhe Hëna, lëvizin në bazë të llogaritjeve precize.” (Err-Rrahman) Kjo do të thotë se (dielli dhe hëna) lëvizin në mënyrë precize, duke mos ndryshuar as për një sekondë.

Kjo pra, tregon se kemi:

- të krijuar; dhe
- të krijuar për të krijuarën.

E krijuara për të cilën janë krijuar sendet është *njeriu*. E shohim se ndryshon dhe transformohet prej një gjendje në një gjendje tjetër. Ai ndryshon, por qenia (të qenurit) e tij vazhdon të mbetet. Që nënkupton se, ai është i gjallë në gjendje të ndryshme. Pastaj pas kësaj ndryshon me zhdukjen e tij pas vdekjes së tij. Këto ndryshime nëpër të cilat kalon njeriu, pa marrë parasysh gjatë jetës së tij apo pas vdekjes së tij, nuk kanë kufij apo

llogari fikse, as gjendje dhe as shkaqe fikse. Ato janë ligje dhe rregulla të panjohura për ne.

Njeriu dhe ligji i ndryshimeve

Njeriu në jetën e tij ndryshon çdo ditë. Ne vërejmë se njeriu i nënshtrohet ligjeve për të cilat nuk di asgjë. Kur është i zgjuar ka ligj, ndërsa kur të jetë duke fjetur ka ligj tjetër, për të cilën gjendje (ligj) nuk dimë asgjë.

Për këtë arsye, kur të flenë njeriu, ëndërron gjëra të cilat nuk i nënshtrohen mendjes dhe logjikës. Sheh ëndërr:

- ose duke folur me njerëz të cilët kanë shkuar në botën tjetër shumë kohë më herët;
- ose bie prej një kodre të lartë dhe nuk i ndodh asnjë e keqe;
- ose shkon në fund të botës dhe kthehet për disa sekonda;
- ose sheh por sytë i ka të mbyllur;
- ose ecë ndërsa këmbët i ka në shtrat dhe nuk i lëvizin;
- ose flet ndërsa gjuha e tij nuk lëvizë;
- ose sheh duke u ndëshkuar, ose sheh duke u kënaqur, etj..

E gjithë kjo ndodh për një çast të vetëm. Kalimi i gjumit prej ligjit të gjumit në ligjin e zgjimit ndoshta ndodhë për më pak se një sekondë. Kjo na bën që të kuptojmë se për Zotin e Lartmadhëruar ta beje që njeriu të kalojë prej një ligji në një ligj krejtësisht tjetër, është proces i lehtë. Nëse e lexojmë Kur'anin, shohim se Zoti i Lartmadhëruar thotë:

اللَّهُ يَتَوَفَّى الْأَنفُسَ حِينَ مَوْتِهَا وَالَّتِي لَمْ تَمُتْ فِي مَنَامِهَا فَيُمْسِكُ الَّتِي قَضَىٰ عَلَيْهَا الْمَوْتَ

وَيُرْسِلُ الْأُخْرَىٰ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٤٢﴾

“Allahu ua merr shpirtat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes dhe atyre që nuk kanë vdekur, por që janë në gjumë. Pastaj Ai ndal shpirtin e atij që i është caktuar vdekja, ndërsa të tjerëve ua lë deri në afatin e caktuar. Nuk ka dyshim se në këto (dukuri) ka shenja dhe argumente për njerëzit që mendojnë.” (Ez-Zumer : 42)

Kalimi i njeriut prej zgjimit në gjumë, i përngjanë kalimit të tij prej jetës në vdekje. Dallimi është se, kur të zgjohet i fjeturi, me zgjim i kthehet shpirti, ndërsa kur të vdes, nuk i kthehet më shpirti deri në ditën e gjykimit.

I dërguari i Allahut s.a.v.s. thotë:

“Pasha atë te i cili është shpirti im, ju do të vdisni sikurse kur të bini me fjet dhe do të ringjallen sikurse kur të zgjoheni, dhe për vepër të mirë do të shpërbleheni me të mirë ndërsa për veprën e keqe do të ndëshkoheni me

të keqe dhe do të jeni në xhenet përgjithmonë ose në xhehenem përgjithmonë.”

Ai i cili vdes, në momentin e ringjalljes sheh gjëra të cilat nuk i sheh në momentin e zgjimit. I sheh melaqet dhe gjërat të cilat deri në atë moment kanë qenë sekrete për të dhe e kupton përfundimin e tij se a do të jetë në xhenet apo në xhehenem.?

Ky është kalim prej një ligji në një ligj tjetër. Ky proces realizohet pa e ditur asnjë njeri mënyrën e ndryshimit prej një gjendje në një gjendje tjetër. Të gjitha këto janë ligje të panjohura për ne, përkundër faktit se ndodhin mbi ne dhe ndikojnë dhe lënë gjurmë në ne.

Nëse e shikojmë në përgjithësi kozmosin, e shohim se rrotullohet ashtu që është në dobi për ne, por ne nuk e dimë se si sillet. Shembull: Ujin e shiut e pi çdo gjë në tokë. Uji është bazë e jetës, kjo vërtetohet në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

أَوَلَمْ يَرَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنَّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ كَانَتَا رَتْقًا فَفَتَقْنَاهُمَا وَجَعَلْنَا مِنَ الْمَاءِ كُلَّ شَيْءٍ حَيٍّ أَفَلَا يُؤْمِنُونَ ﴿٣٠﴾

“Dhe Ne kemi bërë nga uji, çdo gjë që është gjallë.” (El-Enbijaë : 30)

Njeriu ka jetuar me shekuj dhe nuk ka ditur asgjë për ujin e edhe sot nuk e di se si mbushet deti prej liqeneve, pastaj se si avullohet uji në qiell, pastaj se si zbret shiu. Edhe pse në të kaluarën njeriu nuk e ka ditur se si zbret shiu, a mos ka qenë pengesë shfrytëzimi i tij për ujitje, për pije, etj..? Jo! Bile edhe sot, sa i përket shfrytëzimit, nuk ka dallim prej atij i cili e di se si zbret shiu dhe atij i cili nuk e di se si zbret shiu. Një pjesë e vogël e dinë, kurse shumica nuk e dinë, por që të gjithë e shfrytëzojnë ujin e shiut. Njësoj është edhe me çështjen e diellit, ajrit dhe tokës. I di apo nuk i di sekretet e tyre, ti i shfrytëzon ato.

Shkencëtarët kanë shpenzuar shumë kohë në hulumtimin e sekreteve të gjithësisë dhe Zoti i Lartmadhëruar ka dashur që të zbulojnë shumë sekrete të saj.

Me këto zbulime shkencore Allahu ia ka shtuar edhe dijen njeriut se: Allahu ka vendosur rregulla dhe ligje në tokë.

Mësimi i atyre ligjeve, ia lehtëson njeriut jetën edhe më shumë sepse me lehtësi arrin rezultate të cilat më herët i ka arritur me mund, lodhje dhe vështirësi. Dihet se në të kaluarën njeriu është dashur të shkoj te burimi të pi ujë, kurse tash ai e ka sjell ujin në dhomë të shtëpisë, tash vetëm me një

prekje në kuzhinë e sheh ujin para vetes. Me këtë kanë shënuar arritje në shfrytëzim, por nuk kanë arritur diçka në të shfrytëzuarën.

Mendja dhe zbulimet shkencore

Prej momentit kur Zoti i Lartmadhëruar e ka krijuar gjithësinë, gravitacioni e ka kryer funksionin e vet. Edhe pse njeriu deri vonë nuk e ka kuptuar këtë çështje, ai prapë e ka luajtur rolin e vet. Po ashtu aparatet e zërimit, etj.. Të gjitha këto kanë qenë dhe janë në shërbim të njeriut, pa marrë parasysh a i di a nuk i di njeriu ligjet e tyre (ligjet natyrore).

Që ta kemi më afër këtë ilustrim në mendjet tona, themi se, ti nëse shkon te një njeri analfabet dhe i thua: Nëse dëshiron që të kesh dritën e ndezur në këtë vend, preke këtë sustë. Kjo mosdije e këtij analfabeti a mos ndikoi që të mos e shfrytëzon dritën e rrymës elektrike, apo të mos i përcjell programet televizive!? Jo! Sepse çdo herë kur të ketë nevojë për dritë, vetëm e prek dhe ajo ndizet. Çdo herë kur të dëshiron të shikoj programet televizive e prek sustën dhe e përcjell TV.

Kështu pra, mosdija në çështjet e rrymës elektrike dhe rregullat e saj, ose mosdija e transmetimit televiziv dhe programeve të saj, nuk është pengesë për përfitim të saj apo shfrytëzimin e saj. Kështu është gjithësia dhe kështu do të mbetet. Sa herë që hulumton mendja e njeriut dhe Allahu ia mundëson t'i zbuloj argumentet e tij në gjithësi, zhvillohet civilizimi njerëzor për përfitim dhe shfrytëzim.

Gjërat, të cilat kanë mundur të realizohen me angazhim dhe mund të madh dhe për një kohë të gjatë, sot mund të realizohen me angazhim të lehtë dhe në periudë të shkurtë. Ai i cili e ka bartë në shpinë thesin me grurë dhe gjatë bartjes së tij prej një vendi në një vend tjetër është lodhur shumë, sot ai e bartë me lehtësi me mjete transportuese. Pastaj, njeriu ka përparuar, pasi që ka filluar t'i kryej punët me mjete teknologjike dhe jo me mjete mekanike. Zhvillimi teknologjik me pastaj ia ka lehtësuar vështirësitë njeriut.

Mirëpo, këto zbulime dhe ky përparim shkencor, a mos shpiki ndonjë materie e cila nuk gjendet në tokë?. Natyrisht se jo!

Zoti i Lartmadhëruar është Ai që vendos për çdo çështje në gjithësi, që prej fillimit të ekzistimit të krijesave dhe deri në ditën e Kijametit. Sa herë që njeriu zhvillohet dhe i kupton argumentet e Allahut në gjithësi, siguron jetë edhe më komode. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

هُوَ الَّذِي خَلَقَ لَكُمْ مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا ثُمَّ أَسْتَوَىٰ إِلَى السَّمَاءِ فَسَوَّاهُنَّ سَبْعَ سَمَوَاتٍ وَهُوَ
بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿٢٩﴾

“Ai është Allahu i cili ka krijuar për ju në përgjithësi gjithë çka ka në tokë.” (El-Bekare : 29)

Fuqinë e Krijuesit dhe pafuqinë e krijesës e shohim për çdo ditë. Për atë që angazhohet njeriu në shkencë dhe zhvillohet shkencërisht, Allahu i jep atij dhe ia zbulon sekretet të cilat kanë qenë të panjohura më parë për të.

Njeriu nuk krijon diçka të re dhe nuk prodhon gjë tjetër pos asaj e cila veç ka qenë që më parë. Edhe pse ka disa gjëra për të cilat disa njerëz thonë se njeriu është autor i atyre zbulimeve, si f.v.: në bujqësi: drithërat hibride dhe zbulimet e reja të cilat janë në shërbim dhe dobi të njerëzve, si f.v.: prodhimi i aeroplanëve, lëshimi i satelitëve në hapësirë, ose shkuarja në hënë; që të gjitha këto, nuk e kanë fillimin me kohën e zbulimit, këto kanë qenë të realizueshme edhe më parë, por kanë qenë të fshehura për ne, deri në momentin e zbulimit.

Njeriu, për të zbuluar raketë, më parë i është dashur t'i mësoj rregullat e ajrit, e pastaj rregullat e fuqisë e cila i nevojitet raketës, e pastaj... Parashtrihet pyetja: A mos këto rregulla (ligje) nuk kanë qenë në gjithësi dhe hapësirë prej se e ka krijuar Allahu gjithësinë?. Natyrisht se kanë qenë! Ato janë prej krijesave të Allahut prej momentit të parë kur Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë gjithësisë “Bëhu”.

Pa marrë parasysh arritjen e nivelit shkencor, askush nuk mund të thotë se ka krijuar atmosferë të re për tokën ose e ka zëvendësuar me atmosferë tjetër, ose e ka ndryshuar atmosferën e cila e bartë satelitin për ta dërguar mbi tokë, ose që e ka hapur një derë të atmosferës rreth tokës, ashtu që njeriu të kalon nëpër atë derë dhe të shkon në hënë. Askush nuk mund të thotë se vet e ka bërë atë. Allahu është Ai i cili e ka krijuar dhe e ka paraparë të jetë në atë mënyrë, pastaj ia ka bërë të mundur njeriut ta zbulojë dhe ia ka mësuar mënyrën e shfrytëzimit.

Kështu pra, çdo herë kur zhvillohet në jetën e tij njeriu, shtohet dituria e tij për argumentet dhe shenjat e Allahut në gjithësi. Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَمِنَ النَّاسِ وَالْذَوَّابِ وَالْأَنْعَامِ مُخْتَلِفٌ أَلْوَنُهُ كَذَلِكَ إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ
 إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ غَفُورٌ ﴿٢٨﴾

“Prej robërve të Allahut, ata të cilët më së shumti i frikohen Atij, padyshim se janë dijetarët (shkencëtarët)”. (El Fatir : 28)

Pse duhet që shkencëtarët të jenë ata që më së shumti i frikohen Allahut?

Sepse ata janë të cilët i kanë mësuar dhe i kanë zbuluar disa shenja dhe argumente të Tij në gjithësi. Ato shenja dëshmojnë për Madhështinë e Krijuesit dhe precizitetin e krijimtarisë së Tij. Por për çudi, disa dijetarë në vend se të bien në sexhde dhe t'i përulen Madhështisë së Allahut, kanë filluar te mburren dhe të tregojnë se si dhe çka kanë zbuluar prej fshehtësive të gjithësisë, thuaja se ata i kanë krijuar vetë. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

سَرُّهُمْ ءَايَتِنَا فِي الْأَفَاقِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ حَتَّى يَتَبَيَّنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ أَوَلَمْ يَكْفِ بِرَبِّكَ أَنَّهُ
 عَلَى كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿٢٩﴾

“Ne do t’u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në veten e tyre, deri sa t’u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kur’an) është e vërteta. Po a nuk po të mjafton ty që Zoti yt është dëshmues për çdo gjë?”. (Fusilet : 53)

Në çdo kohë, në çdo dekadë, dhe në çdo shekull, po e lexojmë ajetin fisnik **“Ne do t’ua tregojmë...”**, dhe e shohim se ajetet e Allahut të Lartmadhëruar në janë në gjithësinë e Tij dhe në krijesat e Tij deri në ditën e Kijametit.

Patjetër se duhet të ndalemi pak që të shohim se si është vendosur me përpikëri planprogrami i Allahut dhe t’i besojmë ato sepse ato e orientojnë njeriun drejtë besimit. Gjithçka ka në këtë gjithësi është vendosur me urtësi në shërbim të besimit dhe ne drejtim të realizimit të programit të Allahut.

Zoti i Lartmadhëruar e ka zgjedhur planprogramin e jetës për krijesat e tij dhe paralelisht me të ka vendosur “Udhëzuesin” e besimit.

Ne nuk e shohim Zotin e Lartmadhëruar sepse për ne është i padukshëm. Mund të vij ndonjë njeri dhe të thotë: Unë besoj vetëm atë që e shoh.

Ne i themi: Ekzistenca e diçkaje është çështje më vete, ndërsa perceptimi i saj (ekzistencës) është krejtësisht çështje tjetër. T’i marrim si shembull mikrobet, të cilat depërtojnë në trupin e njeriut dhe i shkaktojnë sëmundjen. Këto mikrobe a nuk kanë qenë që nga fillimi i krijimit të krijesave?. Po!

Kanë ekzistuar. Mirëpo, për shkak të trupit tepër të vogël të tyre ne nuk kemi mundur t'i shohim. Me kalimin e kohës, shkenca ka përparuar dhe ka zbuluar mikroskope të cilat i zmadhojnë gjërat me qindra e mijëra herë dhe i kane zbuluar. Por edhe më e rëndësishme se kjo është ajo se, këto mikrobe e kanë luajtur rolin e tyre shumë të rëndësishëm në gjithësi edhe pse ne për to nuk kemi ditur asgjë.

Pasi i zbuluam këto mikrobe, pamë se: ato janë në kulminacion të imtësisë dhe se kanë ligje të veçanta të cilat janë të posaçme për ta. ato kanë role në gjenerimin e tyre, në shumëzim dhe kalimin e tyre prej një gjenerate në gjeneratë tjetër.

Ne mund të djegim lëkurën tonë, por nuk mundemi të ndjejmë prezencën e tyre. Ne mund të shikojmë në enët e gjakut, por nuk mund të ndjejmë prezencën e tyre, sepse nëpërmjet qumështit të nënës, nëpërmjet gjidhënies hyn në gjak (të fëmijës), pastaj shtohen aty dhe aty zhvillohet betejë ndërmjet tyre dhe rruazave të bardha të gjakut, etj., deri te gjërat tjera të cilat i kemi zbuluar dhe i dimë.

Parashtrohet tani një pyetje: A mos janë krijuar këto mikrobe në momentin kur i kemi zbuluar?!

Përgjigja është: Jo! Ato kanë ekzistuar prej se janë krijuar, mirëpo ne nuk e kemi ditur, me fjalë tjera nuk e kemi perceptuar (kuptuar) ekzistencën e tyre. Kështu është me çdo gjë tjetër në gjithësi, me atmosferën, apo me ajrin i cili e transmeton tani zërin dhe fotografitë dhe e bën shpërndarjen e tyre në tokë për pak sekonda, saqë edhe ti në shtëpinë tënde mund ta shohësh drejtpërdrejtë se si ngritet njeriu në hënë dhe zbret në të, dhe gjithë këtë ngjarje të rëndësishme e sheh në shtëpinë tënde e cila është larg kësaj ngjarje me mijëra kilometra.

Pyetja është: A mos njeriu e ka shtuar një atmosferë tjetër të veçantë për transmetimin e zërit dhe fotografive rreth tokës për disa sekonda?

Natyrisht se, përgjigja është negative (Jo!). Atmosfera është po ajo atmosferë e cila ka qenë dhe po me ato specifika të cilat i ka pasur edhe më parë. Por, për ne kanë qenë të panjohura deri në momentin e kohëve të fundit kur i kemi zbuluar ato specifika sikurse bie fjala me zbulimin e fluturimit të aeroplanëve në hapësirën qiellore, me gjithë njerëzit dhe mallrat me barrë të rënd në hapësirë.

Kështu pra, që kur i ka krijuar Allahu i Lartmadhëruar, të gjitha keto specifika kanë ekzistuar në gjithësi por ne nuk i kemi zbuluar vetëm se në momentin kur Allahu ka dhënë leje për zbulimin e tyre, dhe që nga ai moment na është shfaqur, dhe ne pasi që kemi mësuar i kemi shfrytëzuar. E

gjithë kjo është bërë që të jetë në shërbim të çdo gjallese në gjithësi për çështje të besimit.

Nëse një njeri vjen dhe thotë: Ne nuk po e shohim Zotin, e si ta besojmë?

Ne i përgjigjemi: Zoti i Lartmadhëruar na ka dhënë argumente të mjaftueshme në gjithësi të cilat na bindin thellësisht se mund të ekzistojnë gjëra edhe pse për ne janë të padukshme. Patjetër se kjo situatë i ndihmon shkencës që më shumë të na e sjellë pranë çështjen e besimit (imanit). Sa herë që Allahu na zbulon diçka, ne themi: Allahu i Lartmadhëruar është Ai i cili e ka krijuar, e ka shpikur dhe e ka formësuar.

Mirëpo, në vend se shkencën ta marrim si çështje e cila na afron shumë e më shumë me besimin, përkundrazi ne kemi krijuar bindje se te këto gjëra ne vet kemi arritur dhe ne i kemi zhvilluar në gjithësi dhe janë prodhim i yni. Meritat ia kemi atribuar vetes tonë, në vend se t'ia atribuojmë Krijuesit absolut të atyre zbulimeve dhe çuditërisht njerëzit kanë filluar ta shfrytëzojnë shkencën për ta luftuar besimin (imanin), por, e vërteta është se shkenca është vërtetues i besimit (imanit).

Me fuqinë e Allahut, jo me fuqinë tënde

Këto janë të këqijat me të cilat jeton bota sot. Ne e shohim se çdo gjë çka është statike në gjithësi i shërben njeriut gjeneratë pas gjenerate pa dëshirën e njeriut dhe pa i ditur dhe pa i perceptuar ligjet e saj.

Mirëpo është përmbysur gjithçka pasi që ne pretendojmë se ne e kemi nënshtruar vet tokën dhe ne e bëjmë që toka të sjell të lashta me fuqinë tonë, bile e kemi tepruar me këtë koncept, duke tentuar të kritikojmë pesë sekretet për të cilat Allahu na ka thënë se janë sekrete, e që njeriu i ka zbuluar ato pesë sekrete të Allahut.

Kemi ardhur në një pozitë saqë një të dal para kamerave televizive dhe të thotë: Njeriu e zbrit shiun nga qielli, edhe pse zbritja e shiut nga qielli bëhet pa veprimin tonë.

- Asnjë njeri nuk mund të thotë se ai është i cili mbizotëron rrezet e diellit mbi oqeanë, ashtu që ujin e deteve dhe oqeanëve ta ngritë në hapësirë qiellore.

- Asnjë njeri nuk mund të thotë se ai e mbledh atë ujë dhe e ngrit dhe bën mjegulla në qiell.

- Asnjë njeri nuk mund të thotë se i urdhëron erërat që të shkojnë të lëshojnë shi.

- Asnjë njeri nuk mund të thotë se ai bën që ato mjegulla të ngjiten në majat e maleve të ftohta dhe të bie shi. I tërë ky proces realizohet dhe ne nuk dimë asgjë për të. Lexo fjalën e Zotit të Lartmadhëruar:

وَهُوَ الَّذِي يُرْسِلُ الرِّيْحَ بُشْرًا بَيْنَ يَدَيْ رَحْمَتِهِ ۖ حَتَّىٰ إِذَا أَقْلَّتْ سَحَابًا ثِقَالًا سُقْنَهُ لِبَلَدٍ مَّيِّتٍ فَأَنْزَلْنَا بِهِ الْمَاءَ فَأَخْرَجْنَا بِهِ ۖ مِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ ۚ كَذَٰلِكَ نُخْرِجُ الْمَوْتَىٰ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ



“Ai i dërgon erërat si lajmëtar të mëshirës së Tij. Kur erërat lëvizin retë e rënda me shi. Ai i dërgon ato tek ndonjë vend i vdekur, kur lëshon shi dhe me anë të tij nxjerr lloj-lloj frutash. Po kështu do t’i ringjallë edhe të vdekurit. (Këta janë shembuj) Me qëllim që të mendoni.” (El Earaf : 57)

Allahu i Lartmadhëruar me fuqinë e Tij, është Ai i cili i krijon retë dhe ai i orienton të shkojnë si do Ai. Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ يُزْجِي سَحَابًا ثُمَّ يُؤَلِّفُ بَيْنَهُ ثُمَّ يَجْعَلُهُ رُكَّامًا فَتَرَى الْوَدْقَ يَخْرُجُ مِنْ خِلَالِهِ وَيُنَزِّلُ مِنَ السَّمَاءِ مِنْ جِبَالٍ فِيهَا مِنْ بَرَدٍ فَيُصِيبُ بِهِ مَنْ يَشَاءُ وَيَصْرِفُهُ عَنِ مَنْ يَشَاءُ يَكَادُ سَنَا بَرْقِهِ يَذْهَبُ بِالْأَبْصَارِ ﴿٤٣﴾

“A nuk e vëren ti se Allahu i shtyn retë dalëngadalë e pastaj i bashkon e i grumbullon njërrën mbi tjetrën, deri sa të shohësh shiun se si del prej tyre dhe bie nga qielli?! Ai, prej reve të mëdha si mali, lëshon breshrin e me të godet kë të dojë dhe e shmang prej kujt të dojë. Shkëlqimi i vetëtimës së tij gati t’i merr sytë.” (En-Nur : 43)

Sekretet dhe vetmashttrimi i njeriut

Në Kur'anin fisnik, Zoti i Lartmadhëruar na tregon se, sa i përket shiut, ligji i tij është i pandryshueshëm. Por, pasi që shkenca ka zbuluar se nëse i hedhë lëndë kimike në re, atëherë retë lëshojnë shi, mund të ndodhë që ndonjë i mashtruar të vjen në një moment dhe të thotë se, ai (njeriu) e zbret shiun dhe një prej pesë sekreteve të cilat i ka veçua Allahu të jenë sekrete, ai i ka zbuluar. Këto sekrete përmenden në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

إِنَّ اللَّهَ عِنْدَهُ عِلْمُ السَّاعَةِ وَيُنَزِّلُ الْغَيْثَ وَيَعْلَمُ مَا فِي الْأَرْحَامِ وَمَا تَدْرِي نَفْسٌ مَّذَا تَكْسِبُ غَدًا وَمَا تَدْرِي نَفْسٌ بِأَيِّ أَرْضٍ تَمُوتُ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿٣١﴾

“Padyschim se tek Allahu është

- 1. dija e ditës së gjykimit, dhe**
- 2. ai e zbret shiun, dhe**
- 3. ai e di se çka ka në mitra, dhe**
- 4. asnjë njeri nuk e di se çka do të bëjë të nesërmen, dhe**
- 5. asnjë njeri nuk e di se në cilën tokë (vend) do të vdes.**

Vërtetë Allahu është i ditur, i informuar.” (Llukman : 34)

Ne atij njeriu do t'i themi: Ku je ti në zbritjen e shiut?

Ajo zbritje e shiut, është një proces i gjerë dhe i gjatë. Fillon nga oqeanet dhe deri te zbritja e shiut. Edhe nëse i ndihmojnë e tërë bota njëri-tjetrit, nuk mund ta zbresin as edhe një pikë të shiut. Po të kishte pasur mundësi bota të zbresë shiun, do ta bënte që shiu të shkonte vetëm në vendet shkretinore, që ato vende t'i bënte të pëlleshme, ose kur të binte shi i furishëm dhe i fuqishëm do t'i merrte ato re dhe do t'i bartte dhe t'i dërgonte në ndonjë vend tjetër, e të shpëtonin banorët e atij vendi nga vërshimet dhe përmbytjet. Zoti i Lartmadhëruar është Ai i cili e zbret shiun nga qielli dhe atë ujë e pi i tërë njerëzimi, bagëtitë e tyre dhe çdo gjallesë në fytyrën e tokës. Zoti i Lartmadhëruar ka krijuar lumenj të cilët gjatësinë e tyre e kanë me mijëra kilometra. A mundet njeriu që të na e bëjë neve një përroskë të vogël në mes të shkretëtirës?!

Është për t'u pikëlluar kur sheh se si njerëzit në vend se ta shfrytëzojnë shkencën në mënyrë të arsyeshme, që t'i shërbej besimit (imanit), kanë shkuar në drejtim krejtësisht të kundërt, e ata e shfrytëzojnë në shërbim të pabesimit dhe ateizmit dhe në vend se të thonë gjithçka ka në

gjithësi është nën fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar, ata ia atribuojnë vetes dhe thonë është fuqia jonë.

Përfundimi i temës është se, e tërë gjithësia është krijesë e Allahut, e cila është në shërbim të njeriut dhe gjithësia është statike, nuk ndryshon. Përderisa, sa i përket njeriut, ai ndryshon prej një gjendje në një gjendje tjetër, me ligje të fshehta dhe të panjohura për ne dhe se Zoti i Lartmadhëruar shenjat në gjithësi i ka bërë që të jenë në shërbim të çështjes së besimit (imanit), ndërsa njeriu e ka lakuar drejtimin dhe e ka bërë që të jetë në shërbim të çështjes së pabesimit dhe ateizmit.

KAPITULLI I DYTË

Fillimi dhe Mbarimi
Njeriu dhe elementet e tokës
Çka është shpirti?
Shpirti është prej çështjeve të Zotit tim
Mos u mashtro, se vdekja të vjen në befasi

Fillimi dhe Mbarimi

Zoti i Lartmadhëruar është I Vetmi dhe i Domosdoshmi. Ai është Zoti i Pafillim dhe i Pambarim, kurse çdo krijesë prej krijesave të Tij, e ka fillimin dhe mbarimin. Gjithësia dhe çdo gjë që është në të dhe me të, e ka fillimin dhe mbarimin. Kur të ndodhë Dita e gjykimit, do të shkatërrohet çdo gjë në këtë gjithësi: dielli, hëna, yjet, malet, oqeanet, etj.. Këtë realitet Zoti i Lartmadhëruar e tregon në Kur'anin fisnik kur thotë:

يَوْمَ تُبَدَّلُ الْأَرْضُ غَيْرَ الْأَرْضِ وَالسَّمَوَاتُ وَبَرَزُوا لِلَّهِ الْوَاحِدِ الْقَهَّارِ ﴿٤٨﴾

“Atë ditë kur do ta zëvendësojmë këtë tokë me një tokë tjetër e edhe qiejt (në qiej tjerë), dhe do të paraqiten para Allahut, të Vetmit mbizotërues dhe Absolut.” (Ibrahim : 48)

Kështu, në Kur'anin fisnik, Zoti i Lartmadhëruar na tregon se toka në të cilën jetojmë ne, ka shkaqe (ligje) të cilat janë të ndërlidhura me kete gjithësi deri në ditën e gjykimit.

Kur të vjen Dita e tubimit, kjo tokë shkatërrohet dhe vjen në tokë tjetër. Ajo është toka në të cilën do të kthehen njerëzit, në të cilën do të tubohen dhe do të merren në pyetje për të dhënë llogari. Do të dalim nga varrezat tona dhe do të dërgohemi në tokën e dytë. Kjo do të sqarohet në mënyrë edhe më të detajuar në fazën e mëvonshme.

Ne besojmë, dhe e dimë, se me siguri do të vjen fundi i kësaj bote. Mirëpo, ka të tillë të cilët tentojnë të sjellin huti në këtë çështje, duke trumbetuar se pas vdekjes nuk ka gjë. Të gjithë ata të cilët e thonë këtë, janë prej radhëve të materialistëve, komunistëve dhe të ngjashmit me ta, të cilët janë pjesë e drejtimit ateist, i cili është produkt i ideologjive të pabesimit të çdo gjenerate. Ateizmi është një ideologji e cila vazhdimisht përsëritet, por asnjëherë nuk arrin asgjë sepse është i ndërtuar mbi baza të brishta. E pa baza i përsëritë pretendimet e saja në forma të ndryshme por kurrë nuk sjell diçka të re. Lexoje thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَقَالُوا مَا هِيَ إِلَّا حَيَاتُنَا الدُّنْيَا نَمُوتُ وَنَحْيَا وَمَا يُهْلِكُنَا إِلَّا الدَّهْرُ وَمَا لَهُم بِذَلِكَ مِنْ عِلْمٍ
إِنَّهُمْ إِلَّا يَخْطِبُونَ ﴿٢٤﴾

“Dhe thonë, kjo jetë nuk është asgjë tjetër, pos që jetojmë dhe vdesim dhe na zhduk koha. Në lidhje me këtë, ata nuk kanë kurrfarë diturie, ata vetëm japin mendime të dyshimta.” (El Xhathije : 24)

Nëse i marrim të gjitha deklaratimet e pabesimtarëve, do të shohim se, edhe pse kanë ideologji të ndryshme, filozofi të ndryshme, bashkohen në atë se:

- e mohojnë ringjalljen; dhe

- e fshehin ekzistimin e Zotit të Lartmadhëruar, i cili na krijoi, do të na bëjë të vdesim dhe do të na ringjallë.

Shpresa më e madhe e pabesimtarit është që të mos ketë ditë të gjykimit, Kjo nga shkakut se ata kanë dëshirë që të flasin dhe të veprojnë sipas tekave të tyre. Dëshirojnë që, të vjedhin, të gënjejnë, të vrasin, të keqpërdorin pasurinë e të tjerëve, të dëshmojnë rrejshëm, e në fund të mos bëhet asgjë. Kjo është ambicia më e madhe e tyre. Por, kjo shpresë e tyre është e kotë, sepse të gjithë ata do të befasohen në ditën e gjykimit, kur Zoti i Lartmadhëruar do t'i marr ata në pyetje për çdo mëkat të cilin e kanë bërë, bile do të japin llogari edhe për bindjet e tyre të kota. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَالَّذِينَ كَفَرُوا أَعْمَلُهُمْ كَسَرَابٍ بِقِيعَةٍ يَحْسَبُهُ الظَّمْآنُ مَاءً حَتَّى إِذَا جَاءَهُ لَمْ يَجِدْهُ شَيْئًا
وَوَجَدَ اللَّهَ عِنْدَهُ فَوَفَّاهُ حِسَابَهُ وَاللَّهُ سَرِيعُ الْحِسَابِ ﴿٣٩﴾

“Shembulli i atyre të cilët e mohojnë Zotin e tyre, veprat e tyre janë sikurse paraqitja e mirazhit në një kodrinë dhe i eturi mendon dhe llogaritë se është me ujë. Por, kur shkon aty, nuk gjen asgjë por befasisht e gjen Allahun dhe jep llogari para Tij. Padyshim se Allahu llogarit shpejt.” (En Nurë : 39)

Kjo është e vërteta të cilën e urren pabesimtari. Pra, ai do të mbetet i befasuar kur do të shoh që nuk do t'i bëjë dobi pasuria e kësaj bote.

Njeriu dhe elementet e tokës

Para se të flasim për fundin e botës, patjetër duhet të paraqesim fillimin e botës në mënyrë të përgjithshme, që të shohim se si Zoti i Lartmadhëruar i ka dhënë njerëzve argumente, të cilat e bëjnë që të besojnë, dhe të shohim se si në këtë çështje Zoti i Lartmadhëruar i ka barazuar të gjithë njerëzit, në mënyrë që secili prej tyre t'i kuptoj ato, e jo vetëm ata që e kanë fatin të bëhen shkencëtar.

Zoti i Lartmadhëruar e ka krijuar njeriun prej elementeve të tokës. Studimet më të fundit shkencore kanë vërtetuar se trupi i njeriut përbëhet prej 16 elementeve, të cilat elemente i posedon e dhe toka (dheu). Kështu, ne e shohim se shkenca e ka vërtetuar atë çka e ka zbuluar Kur'ani fisnik para 14 shekujve.

Zoti i Lartmadhëruar pasi që e ka formësua Ademin me duart e tij, i ka fry në shpirtin e tij, e pastaj ka filluar gjallëria dhe jeta në trupin e Ademit a.s., pastaj prej Ademit ose prej një pjese të trupit të tij e ka krijuar Havën.

Kështu pra, njeriu përbëhet prej:

- Trupit; dhe
- Shpirtit.
- Sa i përket trupit, i cili përbëhet prej elementeve lëndore, Zoti i Lartmadhëruar ia ka lënë njeriut në dispozicion, që me kalimin e shekujve, t'i zbuloj ligjet e tij dhe në masë të caktimit që e ka caktua të zhvillohet njeriu shkencërisht, mirëpo,
- Sa i përket shpirtit, atë e ka lënë një sekret me dyer të mbyllura për njeriun, deri në atë masë sa njeriu nuk mund të arrij aty.

Të gjitha hulumtimet dhe studimet të cilat bëhen për shpirtin, janë të kota, sepse ajo çështje është një sekret të cilin njeriu nuk mund ta arrij. Shpirti nuk mund të bëhet pjesë e studimit shkencor (eksperimental). Ti nuk mund ta marrësh shpirtin dhe ta vendosësh në laborator kimik dhe të bësh analiza në mënyrë që të kuptosh ligjet e saj. Njeriu ka tentuar, dhe ende bën hulumtime që të kuptoj diç prej saj. Një shkencëtar zviceran ka dashur që të bëj një eksperiment ashtu që e ka vendosur një njeri që ishte pranë vdekjes, dhe e ka vendosur në peshore precize, dhe në fund ai ka konstatua se në momentin e vdekjes apo me fjalë tjera kur të del shpirti prej trupit, njeriu humb një masë të vogël të peshës së tij. Pas eksperimentit, ky shkencëtar ka deklarua se shpirti ka peshë shumë të lehtë, saqë nuk e tejkalon masën e një

të qindtës së një grami. Ky shkencëtar zviceran ka deklarua se shpirti ka peshë shumë të lehtë.

Disa prej dijetarëve nuk e pranojnë ekzistimin e shpirtit, ata deklarojnë se kjo botë është vetëm një kohë e jetës së njeriut, thjeshtë është natyra e cila zhduket me zhdukjen e saj.

Disa kanë mendime të tjera duke deklaruar se shpirti i jep trupit jetë.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'anin e urtë ka thënë:

وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الرُّوحِ قُلِ الرُّوحُ مِنْ أَمْرِ رَبِّي وَمَا أُوتِيتُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا ﴿٨٥﴾

“Do të pyesin për shpirtin tuaj: Shpirti është prej çështjeve të Zotit dhe juve u është dhënë shumë pak Dituri.” (El-Isra : 85)

Duhet të dimë se kemi:

- Shpirt;
- Trup; dhe
- Nefs.

Nefsi është: bashkimi i shpirtit me materien, me fjalë tjera bashkëpunimi i shpirtit me trup. Obligueshmëria prej Zotit të Lartmadhëruar nuk bie vetëm në shpirt, sikurse nuk bie vetëm në trup kur del shpirti, por obligueshmëria vjen kur të bashkohet shpirti me trup. Kjo duke u bazuar me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَنَفْسٍ وَمَا سَوَّاهَا ﴿٧﴾ فَأَلْهَمَهَا فُجُورَهَا وَتَقْوَاهَا ﴿٨﴾ قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا ﴿٩﴾

وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا ﴿١٠﴾

“Pasha nefsin (shpirtin me trup) dhe për Atë që e ka përsosur, duke ia mundësuar atij që të njoh të keqen e të mirën!

Vërtetë, do të shpëtojë kushdo që e pastron atë (nefsin: shpirtin dhe trupin),

ndërsa do të dështojë, kushdo që e shtyp atë (nefsin me punë të këqija).” (Esh-Shems : 7-10).

Kështu pra, ne e shohim se ngarkesa (obligueshmëria) bie në nefsi, e ajo obligueshmëri është në kohën kur bashkohet shpirti me materien, po ashtu edhe dënimi dhe begatia në botën tjetër bie në nefsi. Për këtë arsye Zoti e kthen shpirtin në krijesa.

Zoti i Lartmadhëruar i rikthen trupat që të hyjnë shpirtat në ta, për të dhënë llogari. Për këtë arsye ne e shohim se si ajetet e Kur'anit fisnik kur flasin për botën tjetër, nuk e përmendin vetëm shpirtin, as nuk e përmendin

vetëm trupin, por e përmendin NEFSIN (shpirtin me trup). Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَمَا كَانَ لِنَبِيِّ أَنْ يَعْلَلَّ مِثْلَ بِلْعَانِ يَوْمِ الْقِيَمَةِ ثُمَّ تُؤْفَىٰ كُلُّ نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ
وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿١٦١﴾

“...e pastaj do t’i jepet çdo nefsi (secilit) ajo që ka fituar dhe atyre nuk do t’u bëhet padrejtësi.” (Ali Imran : 161)

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَجَاءَتْ كُلُّ نَفْسٍ مَّعَهَا سَائِقٌ وَشَهِيدٌ ﴿٢١﴾

“Çdo nefsi (shpirt me trup) do të vijë i shoqëruar me një (engjell) grahës dhe një (engjell) dëshmitar.” (Kaf : 21)

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَمَا تَنْفَعُهُمْ شَفَاعَةُ الشَّافِعِينَ ﴿٤٨﴾

“Frikohuni ditës kur nuk do t’i bëj diçka dobi asnjë njeri (nefs) ndonjë njeriu tjetër (nefs).” (El Mudethir : 48)

Kështu ne e shohim se: ngarkesa bie mbi nefsin, dënimi mbi nefsin, begatia mbi nefsin. Kjo duke pasur parasysh bashkimin e shpirtit me trup, me fjalë tjera, të bashkuarit e shpirtit me materien.

Çka është shpirti?

Nëse na kërkohet ta definojmë shpirtin, ne themi: **“Ai është sekreti i Zotit, i cili i jep jetë materies.”** ose ajo është dëshirë e Allahut të Lartmadhëruar për të na dhënë jetë (ngjallë), dhe nëse Allahu e largon këtë dëshirë, merr fund jeta e kësaj bote. Vdekja nuk është fundi i udhëtimit, por është fundi i një faze të atij udhëtimit dhe fillimi i një faze të re. Ajo ka rregullat dhe ligjet e saj të jetës, të cilat i di vetëm Allahu.

Ne edhe më herët e kemi sqaruar se Brenda një çasti të vetëm, njeriu kalon prej një ligji në një ligj tjetër.

Kur njeriu e vendos trupin në dysHEME dhe kokën e tij në jastëk, që nga momenti kur e zë gjumi, kalon prej një ligji në një ligj tjetër, këtë veç e kemi sqaruar.

Kur zgjohet nga gjumi, menjëherë kalon prej ligjit të gjumit në ligjin e zgjimit. Që të dyja ndryshojnë nga njëra-tjetra.

I dërguari i Allahut s.a.v.s. na ka sqarua se kohëzgjatja e jetës së kësaj bote në krahasim me botën tjetër është afatshkurte. Kohëzgjatjen e kësaj jete e ka krahasuar me *udhëtarin i cili qëndron një kohë të shkurtë nën hijen e një peme dhe pastaj vazhdon rrugën*. Me këtë na ka pasqyrua në mënyrë precize për kohëzgjatjen e shkurtë të kësaj bote, në krahasim të rrugëtimit të gjatë. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

“Çka kam unë në këtë botë dhe çka jam unë në këtë botë?. Kjo botë është sikur një kalorës i cili pushon nën hije të një lisi dhe vazhdon rrugëtimin dhe e lë pas vete atë hije.”

Njeriu gjithmonë ka qenë kureshtar për të ditur çështjen e shpirtit, bile jehudët e kanë pyetur edhe të dërguarin e Allahut s.a.v.s. për shpirtin dhe si i jep shpirti jetë trupit? Ata kanë menduar se Muhamedi s.a.v.s. do të jep mendim të tij personal, e kanë dashur që pastaj ta akuzojnë Pejgamberin s.a.v.s. me mossinqeritet.

Për këtë arsye ka zbritur ajeti prej Zotit të Lartmadhëruar:

وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الرُّوحِ قُلِ الرُّوحُ مِنْ أَمْرِ رَبِّي وَمَا أُوتِيتُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا ﴿٨٥﴾

“Dhe të pyesin ty për shpirtin? Thuaj: Shpirti është prej çështjeve të Zotit tim, ndërsa prej diturisë juve u është dhënë vetëm pak.” (El Isra : 85)

Kjo nënkupton se edhe në të ardhmen shpirti do të mbetet sekret prej sekreteve të Allahut dhe ne nuk do të dimë për të deri në ditën e gjykimit.

Mirëpo, duhet ditur se shpirti i cili është i padukshëm për ne, është çështje që Zoti i Lartmadhëruar e ka bërë argument për besimin (imanin), është forcë e cila na tregon për Fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar e cila na mëson si të shkojmë drejt besimit (imanit), që ne të bindemi në Ekzistencën e Zotit, Krijuesit të gjithësisë. Të bindemi thellësisht në krijimin tonë dhe të gjithësisë.

Shpirti, edhe pse jeton në trupin tonë, trupi ynë nuk di asgjë për të. Nuk e di se si ka hyrë, nuk e di se si del, ku e ka vendin (ku qëndron) dhe në cilën pjesë të trupit gjendet:

- A është në mendjen e cila i jep udhëzime çdo pjese të trupit që të lëvizë?
- Apo mos është në zemrën e cila formësohet deri sa embrioni është në barkun e nënës dhe vazhdon të qëndron pa dëshirën tonë deri sa të përfundon jeta?
- Apo mos është në dorën me të cilën punojmë?
- Apo në këmbët me të cilat ecim?
- Apo në sytë me të cilat shohim?
- Apo në veshët me të cilat dëgjojmë?
- Apo në gjuhën me të cilën flasim?

Pra, ku është shpirti?!

Shpirti është prej çështjeve të Zotit tim

Shkencëtarët të cilët kanë folur për Zotin pa kurrfarë njohurie, kanë rezultuar të jenë të paaftë në perceptimin e shpirtit dhe qenien e saj, sepse ata elementin bazë në besim (iman) e kanë materien.

Edhe pse ata mundohen të thërrasin në pabesim dhe ateizëm, duke fshehur besimin në ekzistencën e Zotit, ata nuk po mundin të fshehin ekzistencën e shpirtit i cili është në trupin e tyre dhe i cili është pjesë e pandashme deri në fund të rrugëtimit tyre në këtë botë.

Nëse u parashatrojmë këtë pyetje: A ekziston shpirti apo nuk ekziston?

Përgjigjja e tyre është e prerë: - Natyrisht se Shpirti ekziston, se ajo i jep trupit jetë.

Ne u themi atyre: Pasi që ju e pranoni ekzistimin e shpirtit, e cila është krijesë e Allahut të Lartmadhëruar, e cila me siguri po ekzistua në trupin tuaj dhe këtë nuk po mund ta mohojë askush prej juve, me siguri se ekzistenca e tij është edhe në çdo qenie të gjallë, Përderisa edhe pse ajo ekziston, ju prapë nuk po keni mundësi ta shihni dhe të njihni qenien e saj, edhe pse ju po i shihni gjurmët (ndikimet) e saj në trupin tuaj. Nëse jeni të paaftë të shihni shpirtin, atëherë si po dëshironi që ta shihni Zotin e Lartmadhëruar, atëherë pse po deklaroni se fakti se Zoti nuk shihet, është argument se ai nuk ekziston.

A nuk po ju mjafton ky fakt në trupin tuaj, pra fakti se shpirti jeton me ju gjatë gjithë jetën, që t'ju vërtetoj juve se ju jeni duke trilluar dhe jeni duke shpifur për Allahun, sepse po të kishit logjikuar, do t'i kishit rënë në sexhde fuqisë së Allahut të Lartmadhëruar, fuqi e cila e ka vendosur në ju këtë mrekulli që tu tërheq vëmendjen për fuqinë e Allahut dhe diturinë e Tij të pakufishme.

Parashtrohet një pyetje: Pse Zoti i Lartmadhëruar ia ka fshehur njeriut diturinë për shpirtin dhe nuk e ka pajisur me këtë dituri, por sa i përket shpirtit i ka dhënë vetëm një njohuri të paktë?

Përgjigjja na sjell disa arsye, e ato janë:

E para: Që të kuptojmë madhësitinë e fuqisë së Allahut. Që të bindemi se kjo forcë (shpirti) e cila është e vendosur në trupin e njerëzve dhe e cila jep jetë, pa ditur ndonjë njeri diçka për të, është prej fuqisë së Allahut, dhe me këtë të ndiejmë madhësitinë e Krijuesit të Lartmadhëruar i cili e ka vendosur këtë sekret në ne, pa pasur mundësi ta zbulojmë.

E dyta: Është argument se ekzistojnë çështje edhe pse ne nuk i shohim. Ne jemi të sigurt se shpirtrat janë në trupat tanë. Këta shpirtra i japin jetë trupave tanë, dhe kur të dalin, ndërpritet jeta. Kjo na bën të bindemi se e padukshmja ekziston edhe pse nuk mund ta kuptojmë, pra edhe pse ne nuk e shohim shpirtin dhe çështja e saj është sekret për ne, nuk do të thotë se nuk ekziston. E pra, dëshmitari më i mirë i asaj se duhet besuar edhe ajo çka nuk shihet është shpirti, i cili është i fshehtë në trupat tanë. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَفِي أَنْفُسِكُمْ أَفَلَا تُبْصِرُونَ ﴿٦١﴾

“Dhe (keni dëshmi) në veten tuaj, a nuk po e shihni?.” (Edh-Dharijat : 21)

Njeriut, për të besuar i është dashur t’i mjaftoj si argument vetëm vetja e tij, se si ajo e cila është e fshehtë (shpirti) manifeston me gjurmët dhe ndikimin e saj. Nëse ky argument nuk i mjafton, a nuk mjafton i tërë kozmosi me gjithë çka ka në të, e cila është e mbushur me mrekulli dhe fuqi më të mëdha se e gjithë forca e njerëzimit, vetëm e vetëm që të na tregoj se ekzistenca dhe madhështia e Allahut të Lartmadhëruar është e padiskutueshme.

E treta: Gjithësia me të gjitha të vërtetat shkencore dhe ligjet e fizikës, e kanë kryer detyrën e tyre edhe para se t’i zbulonim (mësojmë) ne. Pse ne i kemi zbuluar së vonshmi, nuk do të thotë se ne i kemi krijuar (vendosur), por kjo ka ndodhur sepse Zoti i Lartmadhëruar ka dashur që të na mësoj neve ato ligje dhe mrekulli, por ata i kanë kryer detyrat e tyre edhe pse nuk kemi pasur njohuri për ta.

Dikush mund të pyes: Nëse kjo është dëshmi e mjaftueshme për besimin, atëherë pse Zoti na e ka fshehur shpirtin nga ne?

Ne përgjigjemi: Njerëzit kanë nevojë që të mësojnë dhe të studiojnë derisa të arrijnë tek zbulimet shkencore. Mirëpo a do të thotë kjo që analfabetin i cili nuk di të shkruaj dhe të lexoj dhe i cili nuk ka kapacitet të arrij dituri, ta lëmë pa ia argumentuar?

Zoti i Lartmadhëruar të gjithë njerëzit i ka barazuar. Ekzistenca e shpirtit në trup është diçka e cila nuk ka nevojë të dihet, sepse çdonjëri e di se shpirti jeton me të dhe ai jeton me shpirtin. Nëse në cilindo njeri hyn dyshimi për diçka, mjafton t’ia ilustrorsh shembullin e shpirtit që të kuptoj edhe injoranti, edhe profesori i cili lexon dhe studion, por edhe ai i cili nuk e ka lexuar asnjë shkronjë në jetën e tij.

Pa marrë parasysh e dimë apo nuk e dimë të vërtetën e çështjes së shpirtit, as nuk bën më shumë dobi edhe as nuk shkakton më pak dëm.

Nuk është e domosdoshme që të dish të vërtetën e shpirtit për të pasur dobi prej tij. Shpirti të jep jetë dhe fuqi edhe nëse nuk di asgjë për të. Duhet që të analizojmë me vëmendje thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

قُلِ الرُّوحُ مِنْ أَمْرِ رَبِّي وَمَا أُوتِيتُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا ﴿٨٥﴾

“Thuaj: - Shpirti është prej çështjeve të Zotit tim (emri Rabbij).” (El Isra : 85)

Çka nënkupton fjalia **“...prej çështjeve të Zotit tim (emri Rabbij).”** apo me fjalë tjera si realizohet kjo çështje?

Këtë e përkufizon thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَنْ يَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ ﴿٨٦﴾

“Nuk ka dyshim se çështja e Tij (emruhu) është se, kur të dëshiroj Ai diçka, vetëm i thotë asaj çështje bëhu dhe menjëherë bëhet.” (Jasinë : 82)

Pra, çështja (emruhu) e Zotit është: Dëshira e Zotit të Lartmadhëruar që diçka të transmetohet prej ditorisë së tij të përhershme pa fillim në jetën e njeriut, me fjalën **“bëhu”**. Për këtë arsye, patjetër se duhet t’ia bëjmë një vështrim thënies së Zotit të Lartmadhëruar **“...i thotë asaj...”** dhe përderisa Zoti i Lartmadhëruar i thotë asaj, kjo do të thotë se ajo ekziston në diturinë e tij e cila përfshinë çdo gjë, qoftë në gjithësi, qoftë prej ngjarjeve, dhe kjo Dije përfshinë gjithçka prej fillimit dhe deri në ditën e gjykimit dhe çka ekziston pas ditës së gjykimit.

Te Zoti i Lartmadhëruar ekziston lindja e çdo gjëje, për këtë arsye kur është pyetur një dijetar:

Çka ndodh prej ngjarjeve të jetës së njeriut?

Ai është përgjigjur: Ato janë çështje që ndodhin edhe pse ne nuk i bëjmë të ndodhin.

Pra dije se, jeta e kësaj bote, me të gjitha ngjarjet, është në diturinë e Allahut. Llogaria, dita e gjykimit, xheneti, xhehenemi, të gjitha janë në diturinë e Allahut, dhe kur Ai dëshiron që t’ia mundësoj ndonjërit prej krijesave që të zbulojnë diçka, ai e zbulon atë. Lexoje fjalën e Zotit të Lartmadhëruar:

مَا أَصَابَ مِنْ مُصِيبَةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي أَنْفُسِكُمْ إِلَّا فِي كِتَابٍ مِّن قَبْلِ أَن نَّبْرَأَهَا إِنَّ ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ﴿٢٢﴾

“Çdo ndodhi që ndodh në tokë apo në veten tuaj, ekziston në libër, para se ta regjistrojmë atë. Kjo për Allahun është e lehtë.” (El Hadidë : 22)

Ndodhitë në këtë botë dhe ndodhitë (që do të ndodhin) e botës tjetër, që të gjitha vijnë prej diturisë së Allahut të Lartmadhëruar tek dituria e njeriut me fjalën **“bëhu”**. Mirëpo, siç e ka cilësuar Zoti i Lartmadhëruar, njeriu tregohet i padrejtë dhe injorant. I padrejtë nga shkaku se është i mashtruar, beson se ai është ai i cili vet i ka arritur këto zbulime, këtë zhvillim dhe këtë civilizim në të cilin jetojmë, e në realitet nuk ka krijuar asgjë pos që:

- e ka shfrytëzuar mendjen e tij, të krijuar prej Zotit të Lartmadhëruar:
- për të pasqyruar fuqinë e krijuar të tij prej Allahut, në materien e krijuar prej Allahut,
- për t’ia zbuluar Allahu çka dëshiron prej ligjeve të kozmosit dhe që t’i shfrytëzoj për të ngritur kapacitetet e jetës së tij.

Ngritja e kapaciteteve të tij është që me sa më pak angazhim dhe në kohë sa më të shkurtë, të realizoj diçka.

Në të kaluarën, për tu ngjitur në ndërtesa të larta na duhej që të ngjiteshim shkallëve duke ecur. Kjo ngjitje ka qenë e mundimshme, por sot me prodhimin e ashensorit ngjitemi në katin më të lart shumë shpejt dhe me shumë pak angazhim.

Në të kaluarën, kur dëshironim të shkonim në ndonjë vend, shkonim në këmbë, kurse sot shkojmë me automjet ose me aeroplan ose me mjete të tjera transportuese, për kohë shumë më të shkurtë dhe me pak mundim.

Mirëpo çka ndodhi kur njeriu e arriti këtë përparim shkencor?

Ai filloi ta adhuroj këtë botë.

Ai është bërë injorant për shkak të injorancës se tij dhe për shkak se qëndron indiferent në dy çështje:

E para: Ai kalon një periudhë kohore në këtë botë dhe e lë këtë botë, mirëpo Krijuesi nuk e lë krijesën e tij.

E dyta: Ai vepron diçka fshehurazi dhe dëshiron që të fshihet prej njerëzve që të mos e shohin, më këtë mendon se nuk mund ta zbuloj askush, mirëpo ai harron se Allahu e sheh në çdo vend dhe në çdo kohë dhe nuk mund t’i

fshihet askush, saqë e di edhe çka fshihet në gjoks (zemër). Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“O robërit e mi!

Nëse mendoni se nuk ju shoh juve, e meta është në besimin (imanin) e juaj.

Nëse e dini se ju shoh juve, pse më keni bërë shikuesin më të dobët tuajin?.”

Këtë realitet e dinë që të gjithë, por ose e harrojnë ose e bëjnë që të harrohet vetëm për ta ngopur epshin. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا وَهُوَ الْعَزِيزُ الْغَفُورُ ﴿٢﴾

“Ai krijoi vdekjen dhe jetën që të ju sprovtoj (testoj) se cili bën vepra më të mira.” (El Mulk : 2)

Kur Zoti i Lartmadhëruar flet për urtësinë e krijesave, kur flet se jeta është çështje e lirisë së zgjedhjes së veprimit, ne duhet ta kuptojmë në funksion të asaj që ne ta përmirësojmë dhe të rrisim kapacitetin e zhvillimit dhe të energjisë, që të bëjmë adhurim sa më të mirë dhe t'i përmbahemi programit të Allahut.

(Në ajet) Vdekja është përmend para jetës, e kjo me qëllim që ne ta përmbysim dhe mos ta lejojmë mashtrimin e dunjasë në veten tonë.

Zoti i Lartmadhëruar e ka përmend vdekjen që të dihet se çdo gjë në këtë botë prej pasurisë apo prej begative, e ka përfundimin dhe nuk është e përhershme. Njeriu kur ta kujtoj vdekjen, nuk mund ta mashtroj bota, prej së cilës gjithsesi do të shkëputet. Mirëpo mashtrimi i njerëzve qëndron në atë se ata mendojnë se do të jetojnë vite e vite deri sa ata të arrijnë pleqërinë, kështu ata habiten dhe mendojnë se kohën të cilën e kanë para vetes së tyre është periudhë e gjatë.

Mos u mashtro, se vdekja të vjen në befasi

Zoti i Lartmadhëruar e ka bërë që vdekja të ndodhë pa shkaqe. Ajo mund të na befasoje në çdo çast. Ai i cili ka shëndet të plotë nuk do të thotë se do të jetojë gjatë. Fëmija i cili ka para vetes së tij afatin e gjatë të jetës, nuk do të thotë se nuk vdes si fëmijë. Vdekja i vjen si fëmijës ashtu edhe plakut, si të shëndoshit ashtu edhe të sëmurit. Njeriu edhe i sëmurë mund të jetojë deri në pleqëri te skajshme.

Nga shkaku se Zoti i Lartmadhëruar na do, nuk dëshiron që kjo botë të na mashtrohet dhe të mendojmë se është e përgjithmonshme, por dëshiron që ne të jemi të gatshëm për fundin e saj në çdo çast, që të mos nxitojmë vetëm në të mirat e kësaj bote dhe të kënaqemi me mëkate, sepse, për shembull, në qoftë se unë e di se do të vdes kur t'i mbushi të pesëdhjetat ose të gjashtëdhjetat, atëherë unë do të bëja mëkate, do tu bëja padrejtësi njerëzve, do fitoja pasuri haram, deri sa të arrij një vit ose dy vite para vdekjes, dhe pastaj do të pendohesha dhe do të bëja vepra të mira.

Nëse do ta dinim momentin e vdekjes, bota do të stërmbushej me mëkate, ndërsa veprat e mira do të ishin të pakta. Mirëpo, kur e di se vdekja më vjen në çdo çast, atëherë unë do të nxitoj në punë të mira. Ta shohim se si Zoti i Lartmadhëruar na i përshkruan robërit e mirë dhe të devotshëm, ata të cilët kanë pozitë të lartë te Zoti dhe me në krye pejgamberët. Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

إِنَّهُمْ كَانُوا يُسْرِعُونَ فِي الْحَيَرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا وَكَانُوا لَنَا خَشِيعِينَ ﴿٩٠﴾

“...në të vërtetë, ata nxitonin në vepra të mira dhe na luteshin Neve me frikë dhe me shpresë.” (El Enbijaë : 90)

Për shkak se njeriu nuk e ka të sigurt të nesërmen, kërkohet përshpejtimi në punë të mira. Kjo është një prej urtësive të sekretit të momentit të vdekjes, me qëllim që para se të na zë vdekja, e cila të zë në çdo çast prej çasteve të natës apo të ditës, t'i kthehemi sa më shpejt planprogramit të Allahut.

Nëse dëshirojmë të përmbledhim me fjalë të shkurta atë që e sqaruam për këtë temë, mund të themi se: E tërë kjo gjithësi është krijuar për njeriun. Kjo gjithësi, me fuqinë e Allahut i nënshtrohet njeriut dhe nuk i nënshtrohet njeriut me dëshirën e njeriut. Njohja e ligjeve të gjithësisë në tokë, të cilat kanë ekzistuar që nga fillimi i krijimit, por që për ne kanë qenë të fshehura, të cilat ligje Zoti i Lartmadhëruar na ka mundësuar t'i zbulojmë, na dëshmon se njeriu në këtë botë nuk posedon asgjë, madje nuk e posedon as

veten e tij. Shpirti i cili hyn në trup, hyn për të dhënë jetë, dhe kur del, njeriu vdes, se shpirti është prej urdhrit të Allahut, dhe Askush nuk mund të dijë për sekretin e saj. Përderisa në këtë gjithësi, njeriu nuk e posedon as jetën e tij, si mundet atëherë të pronësoj gjithësinë?!

Sa herë që kjo botë i afrohet fundit të saj, njeriu, në vend se ta shfrytëzoj për ta pranuar Fuqinë dhe Madhësinë e Allahut, ai mendon se ka kapacitet ta shfrytëzoj, ta pronësoj dhe mbizotëroj, atë që Vet Allahu ia ka mundësua për ta zbuluar. Pra, ai e shfrytëzon shkencën për të luftuar besimin (imanin).

Mirëpo, parashtrohet pyetja:

Si duhet ta pranoj besimtari shkencën e cila përparon për çdo vit?

Në fundin e botës, si do të mendoj njeri se është i aftë të mbizotëroj gjithësinë e Allahut?

Me dëshirën e Allahut, këtë do ta sqarojmë në kapitullin e dytë.

KAPITULLI I TRETË

Jeta (civilizimi) dhe Besimi (imani)
Allahu është Krijuesi më i bukur
Kjo është krijimtaria e Allahut
Besimi dhe zhvillimi shkencor
Argumentet e Allahut dhe civilizimi njerëzor

Jeta (civilizimi) dhe Besimi (imani)

Zoti i Lartmadhëruar dëshiron që jeta, me ligjet e saj, të na drejtojë për në rrugën e besimit, rrugë e cila na e bën me dije se çdo zhvillim shkencor arrihet me ndihmën e Allahut dhe Madhështinë e Tij, e që ai zhvillim shkencor të na e forcoj besimin në Krijuesin e gjithësisë. Mirëpo, në realitet po ndodhë e kundërta.

Përkundër asaj se Zoti i Lartmadhëruar na ka sqaruar se, çdo ngjarje e cila ndodhë në gjithësi ka qenë e ditur në diturinë e Tij para krijimit të gjithësisë, ne çdo zbulimi shkencor i japim kah të kundërt. Adhurojmë inteligjencën njerëzore dhe largohemi nga programi i Allahut.

Ka prej atyre të cilët japin opinione se inteligjencia njerëzore mund ta rregulloj ardhmërinë e tij si i pavarur, por sa herë që zhvillohet shkenca, vërtetohet se ekzistojnë ligje të reja të gjithësisë të panjohura më parë. Me zbulim të ligjeve po mendohet se ato ligje i kemi krijuar ne dhe se ato ligje veprojnë me urdhrin tonë dhe jo me fuqinë e Atij i Cili na e ka nënshtuar gjithësinë dhe i Cili na ka mundësuar që me diturinë tonë, të realizohen dhe të bëhen gjërat sipas dëshirës sonë. Mirëpo, përderisa gjithësia është brenda kornizës së dëshirës së Allahut, njeriu është i paaftë që të prodhojë dhe të veproj si i pavarur në gjithësi, sepse nuk ka asgjë në gjithësi që mund të del nga urdhri i Tij.

Mund të thotë ndonjë njeri: A është dëshirë e Allahut të Lartmadhëruar që pabesimtarët të mos besojnë?

Ne u përgjigjemi: Pabesimtarët nuk mund ta kundërshtojnë urdhrin e Allahut në gjithësi, por mund të kundërshtojnë vetëm atë që Allahu e ka lënë në kompetencë të njeriut. Njeriu ka mundësi të kundërshtoj Allahun vetëm në urdhëresa dhe ndalesa, kjo nga shkaku se Allahu i ka krijuar njerëzit me të drejtën e zgjedhjes, që të sprovohen se a janë të dëgjueshëm apo të padëgjueshëm. Po mos t'ua kishte dhënë Allahu këtë liri, këtë të drejtë zgjedhjeje, asnjë prej tyre nuk do të kishte pasur mundësi të bëjë mëkate.

Njerëzit dhe xhinët janë krijuar me programin e lirisë së zgjedhjes vepro ose mos vepro, përderisa çdo gjë tjetër në gjithësi është krijuar që të mos ketë të drejtë zgjedhjeje.

Atyre të cilët deklarojnë se kanë liri të pakufishme në gjithësi, u themi: Nëse ju nuk e pranoni programin e Allahut dhe nuk e dëgjoni atë, mos mendoni se keni liri absolute dhe të pakufishme në gjithësi,

përkundrazi, ju i nënshtroheni përcaktimeve të Allahut. Nëse nuk është kështu, atëherë na thoni:

Kur të paraqitet sëmundja, a keni mundësi të mos e pranoni atë sëmundje dhe të thoni se ne e kemi zgjedhur shëndetin në trupin tonë dhe jo sëmundjen?.

Normalisht se nuk mundeni.

Kur të paraqitet sëmundja, kundërshtojeni atë caktim të Allahut dhe thoni: Nuk vdesim.

Ju as këtë nuk mund ta bëni.

Kur të të ndalet zemra, a mund t'i riktheni të rrahurat e saj përsëri dhe të jetoni?

Prapë nuk do të mundeni. Kjo nga shkaku se:

- ju jeni të mbizotëruar nga disa çështje për të cilat nuk keni liri; dhe
- keni disa çështje për të cilat keni të drejt zgjedhjeje.

Të kesh të drejtë zgjedhjeje, është dëshirë e Allahut, por mos lejo që të të mashtroj kjo liri e zgjedhjes dhe ta konsiderosh veten se je i pavarur nga Krijuesi në gjithësi.

Kur Zoti i Lartmadhëruar ia mundësoi njeriut t'i zbuloj disa sekrete të kësaj bote, siç janë: fluturimin e aeroplanit në qiell (ajër), zhytëset në thellësi të oqeanëve, zbritjen në hënë, prodhimin e mjeteve të qarkullimit me të cilat zvogëlohet distanca kohore, këto zbulime ndikuan që njeriu të mendoj se ka mundësi të bëjë çdo gjë. Atyre të cilët pa kurrfarë njohurie mendojnë kështu, u themi: Fuqinë që e ke arritur me anë të ndonjë zbulimi, të bën ty që ti të mbetesh aty ku je dhe jo më shumë se ai që je, sepse ti me urdhrin e Allahut ke arritur që t'i shfrytëzosh ligjet e Allahut në tokë, mirëpo nuk mund t'i bësh ato ligje të veprojnë në bazë të epshit dhe dëshirave tua. Ka gjëra të cilat ndodhin jashtë mundësive të të gjithë njerëzve, dhe kjo argumentohet me atë se po të mos ishte kështu, atëherë njerëzit nuk do të befasoneshin me fatkeqësitë natyrore të cilat i ndodhin.

Zoti i Lartmadhëruar është i vetmi i cili e ka edhe sundimin dhe ekzekutimin: Ai ka mundësi të marrë jetë, pushtet ose pasuri, brenda një dite e një nate, ose prej një momenti në moment tjetër. Nëse dikush ka arrit pushtet vetëm me suksesin dhe me eksperiencën e tij, atë pushtet nuk do të mund t'ia merrte askush, mirëpo duhet të dihet se ai njeri pushtetin e ka arritur duke i pasuar shkaqet e Allahut dhe me fuqinë e Allahut, shkaqe dhe fuqi të cilat janë të vendosura në gjithësi. Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar në çdo moment ka mundësi t'ia merr pushtetin atij të cilit ia

ka dhuruar dhe ta zëvendësoj me një pushtetar tjetër. Lexoje njëherë thënien e Zoti të Lartmadhëruar:

قُلِ اللَّهُمَّ مَلِكُ الْمُلْكِ تُؤْتِي الْمُلْكَ مَنْ تَشَاءُ وَتَنْزِعُ الْمُلْكَ مِمَّنْ تَشَاءُ وَتُعِزُّ مَنْ تَشَاءُ وَتُذِلُّ مَنْ تَشَاءُ بِيدِكَ الْخَيْرُ إِنَّكَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٦٦﴾

“Thuaj (O Muhamed): Zotërues i gjithë Pushtetit.

Ti i jep pushtet kujt të duash.

Ia heq pushtetin kujt të duash.

Ti e lartëson kë të duash dhe

e poshtëron kë të duash.

Çdo e mirë është në dorën Tënde.

Vërtetë, Ti je i Plotfuqishëm për çdo gjë.” (Ali Imran : 26)

Kështu pra, pushteti nuk vjen prej shkaqeve të tua dhe nuk merret për shkak të dëshirës tënde, por këto janë caktime të Zotit të Lartmadhëruar. Caktimet e Zotit të japin pushtetin dhe caktimet e Zotit të marrin pushtetin. Nëse e respekton detyrën, ta cakton Allahu ty dhe të jep atë që e dëshiron, por nëse rebelohesh ndaj ligjeve të Zotit, ajo që të është dhënë, të merret. Zoti i Lartmadhëruar në një hadith kudsij ka thënë:

“O biri Adem! Nëse pajtohesh me atë që ta kam caktuar, e qetëson zemrën dhe trupin tënd. Nëse nuk pajtohesh me atë që ta kam caktuar, pasha Madhërinë Time, do ta bëjë që të të sundoj bota, do të përulesh sikurse egërsira kur përulet në shkretëtirë dhe prej asaj pozite nuk do të arrish vetëm se atë që ta kam caktuar dhe do të jesh i nënçmuar tek Unë.”

Zoti i Lartmadhëruar prej fuqisë së Tij jep fuqi, prej pasurisë së Tij jep pasuri, prej mundësisë së Tij jep mundësi, mirëpo njeriu mendon se është vet ai i cili e ka fituar dhe ai është i cili mund të veproj, i cili mund të ndryshoj dhe mund të zëvendësoj.

Me zhvillimin teknologjiko-shkencor, njeriu ka mundur të arrijë te zbulimet, mirëpo asnjë zbulim teknologjik nuk arrihet prej asgjëje, por:

- ata e marrin lëndën (materien) të cilin e ka krijuar Allahu,

- e në atë (materien), e angazhojnë dhe e shfrytëzojnë mendjen e krijuar prej Allahut,

Shembull: Për prodhimin e gotës, merret lënda prej dheut të veçantë të cilin e ka krijuar Allahu, e edhe për ta prodhuar, shfrytëzohet aftësia dhe energjia të cilën e ka krijuar Allahu. Këtë e ilustronjë kështu edhe pse duhet ditur se

ka dallim në mes të asaj çka prodhon njeriu dhe ajo që krijohet me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar, e disa nga dallimet janë:

- çdo prodhim të cilën e prodhon njeriu, atyre prodhimeve nuk mund tu dhurohet jetë. Njeriu nuk mund ta bëjë që ajo gotë të shumëzohet vet dhe ta riprodhojë vetveten (ashtu siç e shumëzon njeriu veten e tij).
- njeriu nuk mund të prodhojë një gotë mashkull dhe një gotë femër dhe që pastaj ata të shtohen,
- nuk mund t'ia jep specifikën e rritjes (zhvillimit) ashtu që gota e vogël të zhvillohet dhe të bëhet e madhe.
- sendi i prodhuar mbetet vetëm siç prodhohet dhe nuk prodhon të ngjashme me veten.

Përpos këtyre specifikave, krijimtaria e Zotit të Lartmadhëruar ndryshon edhe për atë se, Zoti krijon prej asgjëje, e nga kjo rrjedh se njeriu është i krijuar prej asgjëje. Por edhe materia është krijesë e Allahut e edhe ajo është e krijuar nga asgjëja.

Krijimtaria e Tij nuk bëhet vetëm prej sendeve që ekzistojnë por Ai krijon edhe prej sendeve të paekzistuar.

Ky është dallimi në mes të Krijimtarisë së Allahut dhe prodhimit të krijesave.

Allahu është Krijuesi më i bukur

Krijimtaria e Allahut është e asaj natyre që, zhvillohet vetvetiu, prodhon gjëra të tilla që të shtohen vetvetiu. E, krijesa nuk mund ta bëjë një vepër të tillë. Edhe përkundër kësaj, Zoti i Lartmadhëruar njeriun e ka quajtur krijues. E ka çmuar dhe e ka respektuar veprën e mendjes së njerëzve në atë çka ata krijojnë, mirëpo Vetën e ka quajtur se është prej krijesve më të bukur. Lexojeni thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

ثُمَّ خَلَقْنَا النُّطْفَةَ عَلَقَةً فَخَلَقْنَا الْعَلَقَةَ مُضْغَةً فَخَلَقْنَا الْمُضْغَةَ عِظَامًا فَكَسَوْنَا الْعِظَامَ لَحْمًا ثُمَّ أُنشَأْنَاهُ خَلْقًا آخَرَ فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ ﴿١٤﴾

“Më pas, atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra, dhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). I lartë është All-llahu, më i miri Krijues!” (El Muëminunë : 14)

Pa dyshim se:

- Zoti i Lartmadhëruar ka krijuar prej asgjëje, ndërsa ti ke krijuar prej asaj që ekziston.
- E krijuara nga Zoti të Lartmadhëruar ka ndjenja dhe zhvillohet, ndërsa e krijuara nga ti, nuk ka ndjenja dhe nuk zhvillohet.
- Zoti i Lartmadhëruar ka krijuar krijesë që shumëzohet prej llojit të vet. Ti nuk mund të krijosh diçka të tillë.

Shembull: Nëse ne dëshirojmë ushqim, shkojmë në arë, e lëvrojmë dhe e mbjellim, pastaj e korrim, pastaj e bluajmë, pastaj e gatujmë dhe e përgatitim ushqimin. Kështu pra, këtë begati unë e marr prej gjithësisë së Allahut me mendjen që ma ka dhënë Allahu, dhe me forcën fizike si mbështetëse të saj. Të gjitha këto janë dhurata prej Allahut, dhe për çdo gjë që kam vepruar, unë e kam shfrytëzuar atë që është ekzistencë (e krijuar), mirëpo bazë esenciale unë nuk kam sjell, sepse e krijuara e parë është prej Allahut të Lartmadhëruar.

- Kokrra e grurit të cilën e keni mbjellë dhe e keni korrur, nga e keni marrë dhe nga ka ardhur?
- Kush është prodhuesi i mëparshëm dhe prej nga ka ardhur ajo e mëparshmja?
- Kush e ka mbjell para dy viteve dhe si ka kaluar kokrra e grurit para se të vijë në dorën tënde që ta rifillosh ti për mbjellje?

Ajo është prej prodhimtarisë së Atij, i Cili ka përsosur çdo gjë, prej Allahut të Lartmadhëruar.

A mos vallë, farën e parë Allahu i Lartmadhëruar e ka gjetur prej të prodhuarës së mëparshme?

Jo, farën e parë e ka krijuar prej asgjëje.

Kështu është me çdo gjë në gjithësi. E krijuara e parë është prej Allahut. Pastaj, Zoti i Lartmadhëruar ia ka mundësuar njeriut që t'i mësoj specifikat dhe cilësitë e të krijuarës së parë, që ta merr atë dhe të bëj të krijuarën e dytë prej saj, e pastaj të tretën, të katërtën, e kështu me radhë. Pastaj kjo përsëritet gjatë tërë jetës pandërprerë, njëra pas tjetrës. Lexoje thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

يَوْمَ نَطْوِي السَّمَاءَ كَطَيِّ السِّجِلِّ لِلْكُتُبِ كَمَا بَدَأْنَا أَوَّلَ خَلْقٍ نُعِيدُهُ وَعَدَّا عَلَيْهَا إِنَّا كُنَّا

فَاعِلِينَ ﴿١٠٤﴾

“Ashtu siç e kemi filluar si krijesë të parë, ashtu e kthejmë atë.” (El Enbija : 104)

Kështu arrijmë deri te bindja se, baza (e para) e çdo gjëje në këtë botë është prej Allahut të Lartmadhëruar.

Kurse, njerëzit tani flasin vetëm për cilësitë të cilat i posedon dhe si mund të arrihet deri te lloji më i mirë i grurit, bimëve, e të ngjashme me to.

Ne u themi atyre: Këto cilësi të trashëguara dhe vetitë më cilësore, mos i keni krijuar ju apo janë të krijuara prej Allahut të Lartmadhëruar. E vërteta është se, ju po merrni nga ajo që tashmë ekziston. Ju po dëshironi t'ia mbështetni vetes këtë krijimtari dhe po dëshironi të thoni se ju jeni ata që i keni krijuar (zbuluar) dhe se këto nuk janë të trashëguara dhe nuk kanë qenë më parë, e kjo është diçka që nuk e keni bërë dhe kurrë nuk do të mund ta bëni, për këtë ju duhet që t'i nderoni dhe respektoni krijesat e Allahut në gjithësi dhe të thoni se në të vërtetë çdo gjë është prej Allahut dhe nuk është prej juve.

Kjo është krijimtaria e Allahut

Njeriu, kur të sheh civilizimin dhe zhvillimin shkencor, ai duhet të mendoj me logjikën e besimit (imanit) se si ka arritur deri te ai civilizim dhe zhvillim shkencor dhe të shikojë me syrin e logjikës se si Allahu i ka nënshtruar për njeriun ato zbulime.

Isha në vizitë në qytetin San Francisko të Amerikës dhe ata që më shoqëronin dëshironin që të më tregonin se çka ka arritur shkenca. Më dërguan në hotelin më të madh, ku çdo gjë ishte vetëm me një prekje, ku edhe shërbimi ishte shumë i mirë, saqë çka të dëshirosh ta sjellin derisa ti rri ulur në dhomë. E prek një sustë dhe të vjen menjëherë kafja të cilën e dëshiron. E prek një sustë dhe të vjen menjëherë kafja të cilën e dëshiron. E prek sustën tjetër të vjen çaji, ose ushqimi të cilin e kërkon.

Më thanë: - Çka mendon për këtë arritje?

U thashë: - Pasi që njeriu me kapacitetin e tij ka arritur deri në këtë nivel të shërbimit, a thua si do të jetë xheneti i cili është i krijuar prej Allahut me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar. Patjetër se begatitë në të janë shumë më të shumta se sa atë çka mund të ofroj njeriu me civilizimin e tij duke u bazuar me shkaqe.

Përpos kësaj, kjo e arritur, është një rezultat i bashkëpunimit të një numri të madh të njerëzve. Disa e vlojnë qumështin, të tjerët e përgatitin ujin e nxehtë, të tjerët sheqerin. E disa të tjerë i inspektojnë derisa të realizohet procesi. Nëse shohin se diçka mungon, intervenojnë për ta plotësuar.

Pra, çdo shërbim, begati dhe kreativitet, që ka për bazë kapacitetin e njeriut, siç e pamë, mund të realizohet për një minutë dhe vetëm me një prekje të sustës, por, në prapaskenë bëhet përgatitje e madhe, ku bashkëveprojnë një numër i madh i njerëzve.

Çështja që neve na intereson nuk është çështje e një prekjeje të një suste e cila të sjell çka të dëshirosh. Kjo e para është një proces. Mirëpo, njeriut që e arriti këtë zhvillim teknologjik ia parashtrojmë pyetjen:

A mundet zhvillimi teknologjik që të të ofroj çka të dëshirosh vetëm me të dëshiruar në mendje dhe kësisoj ajo që dëshiron të të vij para vetes?.

(Shaëraviu përgjigjet) Kurrsesi, kjo është e pamundur dhe larg mendsh, mirëpo në xhenet, me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar, vetëm mendimi i diçkaje e sjell para vetes atë diçka.

Ofrimi i sendeve para vetes nuk bëhet nga veprimtaria njerëzore por me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar. Kjo është ajo logjika e besimit (imani) me të cilën duhet t'i qasemi çfarëdo zbulimi teknologjiko shkencor.

Nëse na thuhet neve, se p.sh.: mundemi që ta lansojmë një aeroplan i cili për një orë mund të sillet rreth e përqark tokës, e cila deri më sot ende nuk ka ndodhë, por edhe nëse ndodhë, ne duhet ta pranojmë me fjalën **“Lavdërimi i takon vetëm Zotit”**. Por nëse kjo është realizuar me fuqinë dhe veprimtarinë njerëzore, a thua si është çështja nëse realizohet me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar?

I gjithë ky zhvillim teknologjiko-shkencor është zbulim i ligjeve të Allahut në tokë, e kjo arrihet duke i pasuar shkaqet, sepse çdo begati të cilën e përjetojmë, e përjetojmë prej ligjit të shkaqeve, i cili ligj na dërgon deri te fuqia e Shkaktuesit të atyre shkaqeve.

Ky zhvillim shkencor na sjell në mendjet tona forcat të cilat Allahu i ka vendosur në gjithësi, në mënyrë që ta kuptojmë madhështinë e Allahut dhe të kuptojmë se atë që do ta përjetojmë në botën tjetër do të jetë begati e cila nuk mund të përshkruhet në krahasim me begatitë e kësaj bote.

Këto çështje nuk duhet të na largojnë nga besimi, por përkundrazi duhet që të na ofrojnë edhe më shumë në besim. Nuk duhet që këto te arritura të na i mashtrojnë mendjet tona, por duhet që të na e forcojnë edhe më shumë përvullshmërinë ndaj Allahut të Lartmadhëruar, por fatkeqësisht, ne nuk e konsiderojmë shkencën si çështje të forcimit të besimit, por e konsiderojmë arritje shkencore marramendëse me të cilën mendojmë se e kemi tejkaluar te gjitha premiset .

Kur njeriu ka shkuar në hënë, çka kanë thënë njerëzit për ajetin e Kur'anit fisnik?:

يَمْعَشَرُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِنِ اسْتَطَعْتُمْ أَنْ تَنْفُذُوا مِنْ أَقْطَارِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ فَانْفُذُوا لَا تَنْفُذُونَ إِلَّا بِسُلْطَانٍ ﴿٣٣﴾

“O turmë e xhinëve dhe e njerëzve, nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të tokës, depërtoni pra. Por nuk mundeni vetëm se me ndonjë fuqi të fortë.” (Err-Rrahman : 33)

Disa kanë thënë: Njeriu është ngjitur mbi sferat e qiejve dhe të tokës edhe pse Zoti i ka sfiduar xhinët dhe njerëzit të tentojnë të ngrihen mbi sferat e qiejve dhe tokës.

Disa dijetarë janë munduar që çështjen ta zbusin dhe në lidhje me këtë ajet kanë thënë: Qëllimi i ajetit është fuqia e diturisë.

Ne u themi atyre (dijetarëve): Në këtë ajet, qëllimi është fuqia e Zotit të Lartmadhëruar, andaj mos e zbusni çështjen, mos e nënvlerësoni fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar.

Hëna në të cilën ka shkuar njeriu është planet i cili sillet rreth tokës dhe është planeti më i afërt i tokës.

Por, ku i bie hëna në sferat qiellore dhe të tokës?

Është planet prej planetëve të kësaj bote, ku ekzistojnë edhe shtatë qiej tjerë, secili përfshinë aso hapësirë të madhe saqë askush nuk mund ta dijë përpos Krijuesit të tyre, i cili thotë:

إِنَّا زَيْنَّا السَّمَاءَ الدُّنْيَا بِزِينَةِ الْكَوَاكِبِ ﴿٦﴾

“Vërtet, Ne e kemi hijeshuar qiellin e kësaj bote me stoli të planetëve.”
(Es-Saffat : 6)

Çdo gjë që e shohim mbi tokë, është vetëm një pjesë e qiellit të kësaj bote, por ka edhe trupa qiellor të tjerë të cilat janë larg me miliona vite drite, që nënkupton se nëse njeriu do të udhëtonte me shpejtësi të dritës, e cila është shpejtësi marramendëse.

Po të tubohen të gjitha forcat e tokës, nuk mund ta shtyjnë një njeri që të ngjitet në hapësirë me shpejtësi të dritës, e kësaj mund t’ia shtojmë edhe paaftësinë e njeriut që ta përballoj këtë shpejtësi.

Ne themi: Nëse supozojmë se një njeri ka fluturuar me shpejtësi të dritës, atij i nevojiten plot një milion vjet që të arrij tek ai trup qiellor. Ky është trupi qiellor të cilin e njohim. Por, ka trupa qiellor, yje dhe kosmose për të cilat ne nuk dimë asgjë. Përderisa shkenca ka arritur që nëpërmjet teleskopit të shohë ato largësi të cilat gjenden në lartësi të qiellit, atëherë sa do të ishte hapësira reale e hapësirës së qiejve dhe tokës?.

Sa largësia në mes të tokës dhe hënës?

Natyrisht se kjo është **“asgjë”** në krahasim me gjatësinë dhe gjerësinë e qiejve, në të cilat asnjë njeri nuk mund t’i arrijë ato, përpos se me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar. Zoti i Lartmadhëruar nuk e ka përfunduar ajetin me:

لَا تَنْفُذُونَ

“...Por nuk mundeni.”(Er Rrahman : 33),

por e ka vazhduar deri tek:

إِلَّا بِسُلْطَانٍ

“...vetëm se me fuqi të fortë...”(Er Rrahman : 33)

Përgjigja është se: po të perrundonte ajeti fisnik te **“pamundësia e ngritjes së xhinëve dhe njerëzve në hapësirat e qiejve dhe tokës”**, atëherë do të vinim në një pozitë mosbesimi në miëraxhin e të dërguarit të Allahut s.a.v.s..

Prej të gjitha krijesave të Allahut, duke përfshirë melekët, xhinët, njerëzit, i vetmi që ka shkuar deri te Sidretul Munteha është Muhamedi s.a.vs.. Ky vend (sidretul munteha) është vendi ku përfundon dituria e çdo krijese të Allahut, qoftë edhe dituria e melekëve të afërt te Zotit siq është edhe meiku i zbritjes së Kur’anit (Xhibrili).

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar: **“...nuk mund të ngriheni vetëm se me fuqinë...”** e ka dëshmuar vërtetësinë e mrekullisë së Miëraxhit, sepse i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka arritur deri te Sidretul Munteha dhe atë e ka kaluar me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar. Kjo nga shkakut se në udhëtimin e miëraxhit Muhamedit s.a.v.s. i printe Xhibrili dhe ai kalonte prej një qielli në qiell tjetër derisa arritën në Sidretul Munteha. Aty është ndalur Xhibrili dhe kërkoi nga Muhamedi s.a.v.s. të del përpara. Xhibrili i ka thënë të dërguarit tonë:

“Nëse unë eci i pari, do të digjem. Nëse ti (Muhamed) ec i pari, do të digjet.”

E gjithë kjo, ka ndodhur vetëm me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar. Kjo nga shkakut se përbërja e trupit të Muhamedit s.a.v.s. ndryshonte çdoherë që kalonte prej një qielli në një qiell tjetër, me qëllim që të përballoj dritën e Zotit.

Atyre të cilët thonë se qëllimi i ajetit është **“fuqia e diturisë”**, u themi: Ku është fuqia e diturisë në krahasim me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar, kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

وَمَا أُوتِيتُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا

“Dhe, juve ju është dhënë prej diturisë vetëm pak.” (Isra : 85)

A kjo dituri e paktë është ajo fuqi e cila e ngrit njeriun në sferat e qiejve dhe të tokës.

Natyrisht se jo.

Për këtë arsye, çdonjëri i cili thotë se “**fuqia**” e përmendur në ajet ka kuptimin e “**diturisë**” ai e ka tepruar në interpretim. E vërteta është se fuqia e Allahut të Lartmadhëruar është ajo e cila e ka bërë të mundur bartjen e pejgamberit s.a.v.s. deri në Sidretul Munteha dhe kalimin prej saj.

Besimi dhe zhvillimi shkencor

Atyre, të cilët mashtrojnë me termin e shkencës, u themi: Diturinë e paktë të cilën Zoti i Lartmadhëruar ia ka dhënë njeriut, është produkt i të gjitha civilizimeve. Kjo vlen për zhvillimin e madh shkencor të cilin e shohim dhe të cilin do ta shohin gjeneratat e ardhshme pas neve deri në ditën e gjykimit. Nëse dituria e paktë ka prodhuar gjithë këtë përparim shkencor, paramendoje se çka mund të na jep dituria e Allahut në botën tjetër?.

Kështu pra, përparimi shkencor duhet të na forcojë besimin (imanin) dhe devotshmërinë, sepse ne jetojmë në botën e shkaqeve dhe ligjeve. Në këtë botë, sa i përket qasjes ndaj shkaqeve dhe ligjeve të Allahut, aftësitë dhe mundësitë e njerëzve ndryshojnë.

Ndihma e Zotit, në çdo krijesë është e ndërlidhur me shkaqe. Ai i cili i përmbahet shkaqeve dhe ligjeve me seriozitet, ai në krahasim me të tjerët zhvillohet dhe forcohet. Njeriu i cili në tokën e tij e mbjell farën dhe e punon mirë, ajo tokë i jep rezultate të mira. E tjetri i cili nuk e mbjell tokën dhe nuk kultivon pemë, atij ajo tokë nuk jep asgjë. Kjo është ajo që quhet begatia e Zotit. Zoti i Lartmadhëruar në këtë botë ka krijuar gjëra që:

- Reflektojnë në ty, dhe
- Reflektojnë me ty.

Gjërat të cilat reflektojnë në ty, të ofrojnë të mira pa kompensim, edhe pse ti nuk angazhohesh dhe nuk vepron në to. Ato janë të mira të cilat të ofrohen edhe pse ti nuk ke pasur ndikim dhe nuk ke punuar me to, si f.v.: dielli, hëna, yjet, ajri. Pra, të gjitha këto të japin të mira pa pasur nevojë që ti të angazhohesh apo të veprosh në çfarëdo forme. Të mirat e tyre janë të barabarta për të gjithë. Asnjërit nuk i jep më shumë se tjetrit dhe nuk e dallon një popull nga një popull apo një shoqëri nga një shoqëri, dhe nuk ndodh që një shoqërie t'i jep e një shoqëri tjetër ta privon. Të gjitha këto dukuri reflektojnë njëjtë për njerëzimin në përgjithësi.

Sa i përket elementeve që reflektojnë me ty, është çdo gjë e cila është në tokë. Nëse e punon dhe e mbjell tokën, toka të jep fryte. Nëse nuk mbjell nuk të jep fryte. Nëse hulumton thellësinë e tokës do të gjesh xehe te mjaftueshme dhe gjithçka ka në brendi të tokës. Nëse nuk hulumton, toka nuk ta jep thesarin e fshehur të saj.

Zhvillimi i jetës në këtë botë dhe dallimi në mes të popujve të ndryshëm, vjen nga çështjet me të cilat ti *reflekton me ta*. Kush punon me

seriozitet dhe me zell dhe i pason shkaqet, zhvillohet dhe përparon përballë popujve tjerë. Kush nuk punon, nuk merr asgjë.

Si shoqëri besimtare, është dashur që ne të parët të zhvilloheshim, mu ashtu siç e kemi pranuar dhuntinë e besimit në Zot, të pranojmë dhe të veprojmë me shkaqet dhe ligjet e tokës që të zhvillohemi edhe në dhuntitë e Zotit në gjithësi. Mirëpo, ne nuk veprojmë, përkundrazi i lejojmë të tjerët që të zhvillohen në bazë të shkaqeve dhe ligjeve dhe ne nuk veprojmë asgjë.

Popujt të cilët veprojnë në bazë të shkaqeve dhe ligjeve, Zoti iu jep atyre të mirat e kësaj bote, qofshin edhe jobesimtar, sepse Zoti i Lartmadhëruar thotë:

مَنْ كَانَ يُرِيدُ حَرْثَ الْآخِرَةِ نَزِدْ لَهُ فِي حَرْثِهِ ۖ وَمَنْ كَانَ يُرِيدُ حَرْثَ الدُّنْيَا نُؤْتِهِ مِنْهَا وَمَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ نَصِيبٍ ﴿٢٠﴾

“Kush i dëshiron të mirat e botës tjetër, do t’ia shtojmë atij të mirat. Kush dëshiron të mirat e kësaj bote, ia jap atij të mirat, por në botën tjetër nuk do të ketë shpërblim.” (Esh-Shura : 20)

Begatia e kësaj bote, është begati e Zotit për këtë botë, e cila fitohet duke punuar dhe duke vepruar me shkaqe dhe ligje.

Zoti i Lartmadhëruar, që në fillim të krijimit, ia ka siguruar njeriut produktet e nevojshme dhe të domosdoshme të jetës pa kurrfarë shkaqe. Që prej kohës së Ademit a.s. kanë qenë të gatshme elementet si: uji, ajri dhe ushqimi, elemente të cilat janë domosdoshmëri e jetës. Me këtë Zoti i Lartmadhëruar e ka paraparë sigurimin (mbijetesën) e llojit njeri. Pra, Zoti i Lartmadhëruar e ka lënë ujin të lirë në natyrë, që njerëzit të pinë, edhe frutat e lira në natyrë që t’i hanë dhe të sigurojnë jetën, po ashtu edhe ajrin për frymëmarrje, edhe tokën për të banuar. Të gjitha këto konsiderohen domosdoshmëri e jetës së njeriut, të cilat janë lënë të lira që nga fillimi i krijimit dhe këto realizohen pa angazhim të madh. Përderisa, nëse njeriu dëshiron të zhvillohet dhe të ngritë cilësinë e jetës, patjetër duhet ta shfrytëzoj mendjen e krijuar prej Zotit, për të shfrytëzuar të krijuarën, të cilën ia ka nënshtrua Allahu. Për këtë arsye, siç kemi thënë edhe më parë, bazë e ngritjes së cilësisë së konsiderohet, realizimi i një çështjeje për një kohë më të shkurtë me angazhim më të vogël.

Argumentet e Allahut dhe civilizimi njerëzor

Zoti i Lartmadhëruar na ka dhënë gjithçka çka është e domosdoshme në mënyrë që ne të mund të jetojmë. Na ka dhënë edhe mendjen edhe shkaqet me të cilat e arrijmë jetën më të mirë. Pastaj, ka kërkuar prej nesh që t'i shikojmë argumentet në gjithësi, që të mos kalojmë nëpër këto argumente e të mos i shohim. Gjithë përparimi i cili është arritur nga dijetarët të cilët i kanë analizuar argumentet e gjithësisë dhe kanë mundur të arrijnë deri te ligjet e Allahut në gjithësi dhe t'i shfrytëzojnë ato për përmirësimin e jetës së tyre, quhet shkencë – pra, shkencë quhet, të vepruarit me argumentet e Allahut në gjithësi.

Mirëpo, a mos na ka krijuar neve Allahu i Lartmadhëruar që të jetojmë vetëm në gjithësinë e shkaqeve (ligjeve)?

Jo! Ky është vetëm një segment i rrugëtimit të gjatë. Në rrugëtimin në të cilin jetojmë, pra në botën e shkaqeve, patjetër duhet të lodhemi, me qëllim që pastaj të pushojmë.

Ata të cilët kanë sjellë zbulime (teknologjike, shkencore) për njerëzimin, janë lodhur shumë derisa kanë arritur te ato zbulime.

Shumë herë kanë kaluar net të gjata pa gjumë, kanë derdhur mund dhe djersë, derisa kanë realizuar çka kanë dëshiruar. Ky është ligj i kësaj bote, për të arritur sukses duhet angazhuar mendjen. Për të arritur në nivele të larta, patjetër duhet punuar. E kështu me radhë...

Pa dyshim se Zoti i Lartmadhëruar dëshiron që të na e tërheq vërejtjen se, përpos dhuratave të kësaj bote (Rububij), ka edhe dhurata tjera, të cilat janë dhurata të botës tjetër (Uluhiye). Për t'i merituar dhuratat e Zotit (të botës tjetër) patjetër se duhet të veprosh punë të mira në këtë botë dhe t'i përmbahesh planprogramit të Allahut. Vetëm kështu mund t'i përjetosh dhe të pushosh në begatitë e Allahut në botën tjetër.

Pa marrë parasysh se sa lodhesh në këtë botë dhe pa marrë parasysh se sa do të pushosh në këtë botë, përfundimi i saj është:

- ose me vdekjen tënde;
- ose e humb shpejt, sepse të merret prej jush;

Mirëpo, nëse ti lodhesh duke punuar me planprogramin e Tij në këtë botë, atëherë në botën tjetër Zoti i Lartmadhëruar të begaton me të mira përgjithmonë.

Me pak fjalë po e përfundoj. Planprogrami i besimit, nënkupton që sa më shumë që njeriu të zhvillohet dhe të ngrihet shkencërisht, aq më shumë

duhet të forcoj besimin dhe të bëhet i devotshëm ndaj Zotit të Lartmadhëruar.

Çdo gjë në gjithësi, ne duhet t'ia atribuojmë Krijuesit të saj, e ai është Zoti i Lartmadhëruar.

Duhet të kuptojmë se çka na mundëson Krijuesi të përparojmë, ose që të përmirësojmë jetën që të kemi jetë më komode në gjithësi nuk është asgjë tjetër përpos asaj se, Allahu i Lartmadhëruar ka vendosur sekrete dhe ligje në gjithësi që ne të kemi mundësi t'i realizojmë për veten tonë. Nuk duhet të mendojmë se i kemi realizuar vet dhe i kemi arritur vetëm me mësimin tonë, e t'i konsiderojmë se ne i zotërojmë elementet (gjërat) me mendjet tona dhe me ligjet tona, por duhet të besojmë se Zoti këto gjëra i ka nënshtruar nëpërmjet neve për ne.

Të besuarit e njeriut në planprogramet e njeriut ka qenë piknisja e largimit nga planprogrami i Allahut, sepse njeriu është vetmashtuar me mendjen dhe aftësinë e tij.

KAPITULLI I KATËRT

E prodhuara harxhohet
Zbatimi i planprogramit, siguri e shoqërisë
Si do të bëhet ekspozimi i zjarrit?
Koha dhe jeta në berzah

E prodhuara harxhohet

Njerëzit jetojnë në këtë botë dhe duke jetuar prodhojnë mjete teknologjike, të cilat funksionojnë sipas përllogaritjeve të tyre dhe në shërbim të jetës së tyre. Prodhimi teknologjik tashmë është bërë pjesë e pandashme jetës së tyre, dhe ka ardhur deri në atë nivel që askush nuk ka mundur ta paramendon një zhvillim të tillë. Kjo është ajo që e quajmë dinamika dhe statika e kësaj bote.

Allahu e ka bërë që: Dielli të lind çdo ditë dhe të perëndon çdo ditë. E ka bërë natën dhe ditën, i ka bërë detet me ligjet e tyre. Toka është pjesë e botës statike (ligjet e saj janë të pandryshueshme).

Të gjitha begatitë, Allahu i ka bërë statike në këtë botë, për këtë arsye njeriu vetmashtrohet dhe nuk mendon për to, ai i merr ato të gatshme, nuk mendon dhe nuk analizon krijimin dhe ligjin e tyre. Shumë herë nuk pyet për fuqinë mbinatyrore e cila është e krijuar nga Ai (Allahu), i cili e mbron dhe e mirëmban dhe e bën të funksionojë me sistem të përpiktë dhe në mënyrë precize. Për këtë arsye, shumica e njerëzve as që mendojnë për ato begati statike të gjithësisë, por i marrin dhe i shfrytëzojnë sikurse janë gjëra të cilat funksionojnë dhe ju shërbejnë vetvetiu.

Është interesante të shohësh se si në gjithësinë të cilën e ka krijuar Allahu, për çdo ditë përfitohet dituri edhe më e madhe për ligjet dhe argumentet e Allahut, dhe sa herë që njeriu e shton diturinë, ai përparon, mirëpo në të njëjtën kohë e pakëson të vepruarit me planprogramin e Allahut,

Ka qenë dashur që kjo dituri të na ofroj më shumë te njohja e Zotit të Lartmadhëruar, sepse Ai është i cili na mundëson neve që t'i zbulojmë fshehtësitë e fuqisë së Tij në këtë botë. E përkundrazi, zhvillimi shkencor po na shton dëshirat tona dhe po na shtyn edhe më shumë të shikojmë vetëm këtë botë dhe teoritë materiale (fizike) të saj.

Sa më shumë që përparon njerëzimi dhe ec me kohën, aq më shumë mbizotërojnë epshet mbi të. Çdo herë që zhvillohet shkenca dhe njeriu përparon, në vend se të shtohet të vepruarit me planprogramin e Allahut, ndodh e kundërta, pakësohet të vepruarit me planprogramin e Allahut. Kjo vërtetohet me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

“...sepse e konsideron veten të pavarur (nga Allahu), por padysim se te Zoti yt do të kthehen.” (El-Alek : 7, 8)

Cilësi e njerëzve bëhet padrejtësia, atëherë kur njerëzit e konsiderojnë veten se janë të pavarur prej Zotit të Lartmadhëruar dhe atëherë kur mendojnë se nuk kanë nevojë për të adhuruar Zotin e tyre.

Nëse e shikojmë aspektin e jashtëm, shohim se shkenca na e ofron atë që e dëshirojmë:

- Nëse dëshirojmë të udhëtojmë: kemi metoda komode, të lehta, të shpejta, me aeroplan luksoz, me ambient të përshtatshëm. Me to njeriu nuk ndien lodhje.
- Nëse dëshirojmë ushqim: kemi ushqime të ambalazhuar me mjete të pastra dhe moderne.
- Ekziston mundësia që ti të qëndrosh në dhomë, thërret në telefon dhe ta sjellin në shtëpi ushqimin e dëshiruar.
- Nëse na paraqitet ndonjë sëmundje, kemi preparatet më moderne teknologjike të cilat mund të na paraqesin çka kemi në brendi të trupit, e mësojmë atë çka nuk e kemi ditur dhe na sqarohet neve se ku jemi të sëmurë dhe cilën sëmundje e kemi dhe cila është rruga e shërimit. Aparatet teknologjike na mundësojnë ta identifikojmë sëmundjen apo gjendjen e shëndoshë të secilës pjesë të trupit.
- Përmes sistemit të trurit na e tregojnë vendin se ku kemi pësuar tronditje apo ku jemi të sëmurë.
- Përmes sistemit të mëlçisë na e përcaktojnë se ku jemi të sëmurë dhe cila është shkalla e sëmundjes dhe cila është rruga e shërimit.
- Analizat e gjakut kanë përparuar, tashmë aparatet mund të na tregojnë përbërjen e gjakut.

Aq shumë ka ecur medicina, sa njerëzit kanë filluar të besojnë se medicina është ajo që shëron, por e vërteta është se medicina vetëm intervenon në sëmundje ndërsa Allahu është Ai që shëron.

Mund të ndodh që diagnoza dhe intervenimi të jetë gabim dhe mund të shkaktoj vdekjen. Shumë herë shërimi vjen nga mjeku fillestar i sapodiplomuar, ndërsa në të njëjtën sëmundje dështojnë specialistët të cilët e kanë mësuar atë mjek fillestar për mënyrën e shërimit po të asaj sëmundje. Kjo, nuk nënkupton se mjeku fillestar di më shumë se profesorët e tij, të cilët e kanë mësuar atë, por nënkupton se çdo sëmundje e ka kohën e caktuar të shërimit të cilën e ka caktuar Allahu i Lartmadhëruar. Kur të vjen

koha e shërimit, Allahu ia mundëson dhe ia zbulon shërimin edhe mjekut fillestar, duke ia mësuar sekretin e sëmundjes, dhe ai mjek e shëron, përderisa në sëmundjen e njëjtë dështojnë profesorët e tij. Mirëpo njerëzit nuk e vërejnë këtë, por shërimin ia kushtojnë aftësisë dhe inteligjencës së mjekut.

Kështu njerëzit e harrojnë fuqinë e Allahut dhe e forcojnë mbështetjen tek fuqia e njeriut dhe në atë që ai është suksesshëm nga aspekti i jashtëm.

I shikojnë shkaqet e njerëzve dhe harrojnë Shkaktuesin (Allahun) e atyre shkaqeve. I adhurojnë begatitë ndërsa e harrojnë Dhuruesin e atyre begative. Nëse dikujt i ofron një lloj molle të mirë thotë: Kjo është e kultivuar në arën e filanit. Harrojnë se begatues është Krijuesi i saj, e ai është Allahu i Lartmadhëruar.

Për fat të keq, vetëm një numër i vogël nga ne, janë nga ata që kur të fillojnë ngrënien e ushqimit, e fillojnë duke thënë:

“Në emër të Allahut, i cili ka dhënë, ka krijuar dhe ka dhuruar.”,

e kur të ngopen, të rrallë janë ata që thonë:

“Falënderojmë Allahun, i cili na ka furnizuar me ato begati.”

Njeriu e adhuron mendjen e tij dhe ka krijuar bindje se begatitë të cilat i ka realizuar janë rezultat i mendjes së tij dhe ai vet është mendjemprehtë dhe se ai është ideator dhe inteligjent dhe me atë sukses mburret para njerëzve dhe mendon se pasuria e tij është e përgjithmonshme dhe se ai është menaxher i mirë dhe planifikon çdo gjë, njësoj sikurse është rasti i pronarit të dy xheneteve (plantacioneve) i cili ia atribuonte vetes së tij të mirat dhe begatitë, siç e tregon Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an:

وَدَخَلَ جَنَّتَهُ وَهُوَ ظَالِمٌ لِّنَفْسِهِ قَالَ مَا أَظُنُّ أَن تَبِيدَ هَذِهِ أَبَدًا ﴿٣٥﴾ وَمَا أَظُنُّ السَّاعَةَ قَائِمَةً وَلَئِن رُّدِدْتُ إِلَىٰ رَبِّي لَأَجِدَنَّ خَيْرًا مِّنْهَا مُنْقَلَبًا ﴿٣٦﴾

“Pastaj hyri në kopshtin e vet dhe duke qenë i padrejtë me vetveten, tha: Unë nuk mendoj se do të shkatërrohet ndonjëherë dhe nuk mendoj se do të ndodhë çasti i Kijametit. Por edhe nëse më kthejnë te Zoti im, sigurisht se do të gjej një vend më të mirë se ky.” (El Kehf : 35, 36)

Kjo na njofton se, pronari i kopshteve, begatitë ia ka përshkruar vetvetes dhe ka thënë se me shkaqet njerëzore ka mundësi t'i mbroj dhe t'i siguroj (nga shkatërrimi) begatitë dhe se kurrë nuk do t'i humb.

Ne, kur të shohim diçka të mirë, a e lavdërojmë prodhuesin?

Po, ne sot e lavdërojmë njeriun dhe themi: Filani kopshtin e tij e ka bërë xhenet. Filani e ka bërë këtë dhe këtë dhe nuk themi se ai e ka arritur këtë me ndihmën e Allahut. Nuk e përmendim Allahun e Lartmadhëruar i Cili është edhe Dhuruesi edhe Penguesi (Ndaluesi).

Zbatimi i planprogramit, siguri e shoqërisë

Ne po mbështetemi te gjërat të cilat na sigurojnë jetë më të lehtë dhe të mira materiale, dhe llogarisim se këtë e kemi arritur me punën tonë të pavarur nga fuqia e Allahut, dhe po e besojmë dhe e adhurojmë fuqinë e njeriut, duke menduar se ne mund të bëjmë ligje në veti për vete edhe pse ato ligje janë në mospërputhje me planprogramin e Allahut. Dhe jo vetëm kaq, por edhe ligjin e Krijuesit po e quajmë si ligj të dhunshëm. Shpifim dhe e quajmë se është ligj i prapambetur apo e majta. Por e vërteta është se, ai i cili largohet nga planprogrami i Allahut, në të vërtetë, mu ai është duke u kthyer mbrapa.

Sekreti i mbështetjes së njeriut në materie si dhe përkushtimi i tij në jetën materiale, e cila njihet si ideologjia e materializmit, është në atë se nuk na ndihmon të shkojmë drejt një edukimi cilësor i cili i mbizotëron epshet tona të pangopura, përderisa sa i përket planprogramit të Allahut, ai na ndihmon në edukimin jetësor, e cila na siguron jetë fisnike, por fatkeqësisht ne nuk jemi të orientuar në këtë të dytën.

Kur Zoti i Lartmadhëruar na ka thënë **“Mos vidh”**, askush nuk mund të thotë se me këtë ndalesë ma ka cenuar të drejtën dhe lirinë time që ta zgjas dorën dhe t’ia marr pasurinë tjetrit. Kjo teori kështu është e pakuptimtë. Por, e vërteta është se me këtë ndalesë, tërë shoqërisë ia ka marrë të drejtën që ta zgjat dorën dhe ta marrin pasurinë time. Kështu më ka mbrojtur mua, sepse unë jam i dobët si i vetëm në krahasim me shoqërinë e cila ka fuqi të më merr çdo gjë.

Kur Zoti i Lartmadhëruar më ka ndaluar të preki në nderin e tjetrit, e ka kufizuar lirinë time ashtu që edhe nëse unë e pëlqej një grua të martuar të tjetër kujt, të mos preki në nderin e saj. Mirëpo ne nuk po e analizojmë atë se Zoti i Lartmadhëruar i ka ndaluar mijëra të rinj të pamartuar dhe të martuar që të prekin nderin tim. Nderi im është i ndaluar për të gjithë shoqërinë.

Kështu veprohet me planprogramin e Allahut. Ai më mbron mua, e mbron nderin tim dhe fëmijët e mi, mirëpo shkurtpamësia ime dhe epshi im i ngutshëm, më bën që të harroj atë me të cilën më mbron Allahu.

Çdo herë që përparon civilizimi materialist, degjenerimi moral në shoqëri vjen deri në atë nivel sa që e ndaluara bëhet e lejuar, ndërsa ky tjetërsim është jashtë ligjeve dhe rregullave të Allahut.

Kur njeriu krijon bindje se është i pavarur me diturinë e tij ose me autoritetin e tij ose me pasurinë e tij ose me fuqinë e tij ose me diçka që Allahu ia ka mundësuar atij të arrij, vjen Allahu i Lartmadhëruar që ta nxjerr nga ajo hipnozë dhe ta qet para realitetit dhe të drejtës. Kjo ndodh:

- ose atëherë kur vdes njeriu;
- ose kur të ndodhë dita e kiametit dhe e shkatërrimit.

Për çdo arritje të njeriut që ia mundësoi Allahu e që njeriu mendon se e arriti me forcat e veta, Zoti i Lartmadhëruar i thotë: Përderisa ti e ke realizuar vet, nëse ke mundësi apo rrugëdalje, ruaje vet.

E vërteta e parë e jetës është vdekja. Vdekja qëndron pranë çdo gjëje e cila është në këtë botë, çdo gjë i nënshtrohet vdekjes i turpëruar.

Njeriu i cili ka menduar se specialistët më të njohur mund t'ia ruajnë shëndetin e tij dhe se ata do ta mbajnë jetën në trupin e tij para vdekjes, tregohen të paralizuar dhe të paafte. Nuk mund të gjejnë zgjidhje dhe nuk mund të bëjnë asgjë.

Po ashtu edhe pasuria e njeriut me të cilën njeriu ka menduar se me të mund të bëjë çka të dojë dhe të veprojë si të dëshiron, por edhe shpresa se ai me fuqinë dhe pozitën e tij mund të veprojë çka të dëshiron është çështja tjetër e cila tregohet e paafte që t'i jep energji dhe forcë që t'i vazhdoj jeta në trupin e tij. Në momentin e vdekjes, e sheh çdo gjë që i ka munguar dhe e sheh para vetes çdo gjë. Atëherë e sheh çka është dashur të besoj dhe çka ka kërkuar Allahu prej tij, e kupton realitetin e lirisë së zgjedhjes. Ai moment është çasti i shtangimit, çasti kur njeriu mbetet syhapur dhe ai i cili mendonte se është i fuqishëm dhe mund të bëjë ç'të dojë, bëhet i nënçmuar, i frikësuar, dhe i pafuqishëm që të bëjë gjë.

Që nga momenti kur shpirti del prej trupit, largohet prej çdo çështjeje të kësaj bote dhe shkon në botën tjetër ku ligjet më nuk janë në funksion (shërbim) të veprimit (dëshirës) së tij. Vdekja, nuk është fundi, ashtu siç mendojnë shumica e njerëzve, por është të kaluarit prej jetës në jetë tjetër, prej kësaj bote e cila i ka ligjet e saj, në jetën pas vdekjes e cila ka ligje tjera. Atëherë sheh, atë që nuk e ka parë më parë. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë:

...هَذَا فَكْشَفْنَا عَنْكَ غِطَاءَكَ فَبَصَرُكَ الْيَوْمَ حَدِيدٌ ﴿٢٢﴾

“Tash ta kemi ngritur perden (e syve) dhe sot shikimi yt është i mprehtë.” (Kaf : 22)

I dërguari i Allahut s.a.v.s. në hadith ka thënë:

“Njerëzit janë duke fjetur, kur të vdesin, zgjohen.”

Si është e mundur që i dërguari i Allahut s.a.v.s. të thotë: Njerëzit janë duke fjetur, kur të vdesin, zgjohen?!

Si është e mundur që i dërguari i Allahut s.a.v.s. të thotë: Njerëzit janë duke fjetur... kur në botën të cilën jetojnë, janë zgjuar!? ...dhe kur të vdesin, zgjohen.

Si është e mundur që njeriu i cili është zgjuar, i cili e mbush tokën plot gjallëri, që në të vërtetë të jetë duke fjetur dhe kur të vdes dhe të mbulohet me dhe' zgjohet?!

Përgjigjja në këtë është se: Në këtë botë njerëzit janë të angazhuar ndaj epsheve, pasurive dhe në realizimin e dëshirave të tyre. E gjithë kjo njeriun e largon nga realiteti i kësaj bote dhe nuk e lë të analizoj argumentet e Allahut. Zoti i Lartmadhëruar u paraqet argument pas argumenti që t'i bëj ata që të besojnë, por ata refuzojnë dhe kjo i bie sikurse të jenë në gjumë kundrejt realitetit rreth tyre dhe çdo gjëje që u është premtuar nga Allahu dhe kur të vdesin shohin qartë, pa kurrfarë mbulese, e ai moment është kur e vërejnë Allahun, programin e tij dhe realitetin apo të vërtetën e kësaj bote.

Vërtetë njeriu është në gjumë të lehtë dhe nuk udhëzohet sepse i ka mbyllur sytë, nëse i hap sytë sheh dhe kupton. Kështu pra, çështja e parë e cila i është dhënë është e para e cila i merret, e ajo është jeta. Njeriu kur të vdes e sheh vendin e tij se a do të jetë në xhenet apo xhehenem. Në çastin e vdekjes e kupton se do të vdesë. Njerëzit mendojnë se çasti i vdekjes është i njëjtë për çdo njeri, që secilit njeri i vjen çasti i vdekjes dhe vdes, por e vërteta është ndryshe, sepse Zoti i Lartmadhëruar na ka lajmëruar se në çastin e vdekjes, bëhet lamtumira e kësaj bote dhe në botën tjetër nuk shkojnë në mënyrë të njëjtë, por që nga këtu fillon ndryshimi. Lexoje fjalën e Zotit të Lartmadhëruar:

الَّذِينَ تَتَوَفَّيْهُمْ الْمَلَائِكَةُ طَيِّبِينَ يَقُولُونَ سَلَامٌ عَلَيْكُمْ ادْخُلُوا الْجَنَّةَ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٣٢﴾

“Të cilëve melekët ua marrin shpirtrat duke qenë të pastër. U thonë atyre:

- Shpëtimi dhe paqja goftë mbi ju! Hyni në xhenet, si shpërblim për veprat që keni kryer!” (En-Nahl : 32)

Kështu pra, njeriu i mirë dhe besimtar, në çastin e vdekjes i sheh melekët.

Edhe mohuesi (pabesimtari) i sheh melekët në çastin e vdekjes, por ka dallim të madh njëra me tjetrën.

Njeriu i cili ka qenë besimtar i mirë, i sheh melekët e mëshirës të cilat e përgëzojnë dhe e dërgojnë në xhenet. U japin selam, fytyrat e tyre janë të ndritura, dhe atëherë gëzohet njeriu besimtar, sepse kalon në një jetë më të mirë dhe më të pastër se sa në këtë botë në të cilën ka qenë. Fytyra e tij është e gëzuar, i sheh shtretërit komodë, e sheh se bota e sprovave ka përfunduar dhe se ai do të kalojë në botën e begatë, ku do të kënaqet me të mirat e Allahut të Lartmadhëruar, i shkëlqen fytyra. Kur t'i vjen çasti i vdekjes e kupton se ai është duke e ndjerë se është duke shkuar në një shkallë më të lartë se sa në atë të cilën ka jetuar në këtë botë dhe se i ka ndodhë me të vërtetë premtimi i Allahut për një përfundim të mirë.

Edhe pabesimtari i sheh melekët në çastin e vdekjes. Këtë e tregon Zoti i Lartmadhëruar kur na njofton se ai ballafaqohet me një takim të vështirë:

وَلَوْ تَرَىٰ إِذْ يَتَوَفَّى الَّذِينَ كَفَرُوا الْمَلَائِكَةُ يَضْرِبُونَ وُجُوهَهُمْ وَأَدْبَرَهُمْ وَذُوقُوا عَذَابَ الْحَرِيقِ ﴿٥٠﴾ ذَٰلِكَ بِمَا قَدَّمْتُمْ أَيْدِيكُمْ وَأَنَّ اللَّهَ لَيْسَ بِظَلَمٍ لِلْعَبِيدِ ﴿٥١﴾

“Eh sikur t'i shihje se si melekët ua marrin shpirtrat mohuesve! I godasin ata në fytyrë dhe shpinë (duke u thënë): - Shijoni dënimin e zjarrit! Kjo për shkak të asaj që keni bërë me duart tuaja, sepse Allahu nuk është i padrejtë me robërit e vet!” (El-Enfal : 50, 51)

Kështu, ne shohim se në çastin e vdekjes ka dallim të madh në mes të njeriut besimtar dhe njeriut pabesimtar.

Pabesimtarit, melekët i thonë: - A nuk po e sheh se si ke gënjyer në jetën e paravdekjes. A po e sheh dënimin i cili po të pret. Nëse ke mundësi dhe fuqi nxirre veten nga kjo situatë. Ik, po pate mundësi, por nuk mundesh. Të ka mashtruar jeta e dunjasë, ke bërë krime dhe padrejtësi, ke bërë mëkate. Ke folur për Allahun gjëra të padrejta, je treguar kryelartë. Tani ka përfunduar çdo gjë që ka qenë për ty në jetën e dunjasë. Zotat tu, të cilët i ke adhuruar përpos Allahut, kanë ikur dhe janë fshehur sepse të kanë mbështetur në të keqe dhe në mëkate, ata nuk mund t'i bëjnë vetes së tyre as dëm dhe as dobi, por edhe të gjithë ata që të kanë ndihmuar ty në dunja për të bërë padrejtësi, tani nuk kanë mundësi që të të mbrojnë.

Si do të bëhet ekspozimi i zjarrit?

Kur'ani fisnik na tregon se, në çastin e vdekjes ka goditje dhe ndëshkim prej melekëve për pabesimtarët, e kjo vlen për pabesimtarin i cili është ushqyer me të mirat e Allahut.

Dihet se nuk ka dënim pa pasur jetë. Ti nuk mund ta dënosh trupin e vdekur, por që trupi të përjetoj vuajtjen, patjetër duhet ta ketë shpirtin. Për këtë arsye procesi i goditjes dhe i ndëshkimit prej melekëve bëhet në çastin e vdekjes në trupin kur ka jetë. Për këtë arsye, ne shohim se fytyra e pabesimtarit pas vdekjes së tij është e zverdhur. Shohim se eshtrat dhe trupi i shtangohen. E gjithë kjo është për shkak se ai pak para vdekjes veç e sheh përfundimin e keq të tij i cili e pret.

Kështu pra, për dallim nga jeta e kësaj bote në çastin e vdekjes ka dallim në mes të besimtarit dhe pabesimtarit,. Në këtë botë ndoshta pabesimtari mund të jetë i bukur, i fuqishëm, i lartë, me pushtet dhe me pozitë të lartë, gjë të cilën nuk e ka besimtari, por që në çastin e vdekjes fillon dallimi dhe përfundon çdo gjë e cila është përfundimtare në këtë botë.

- Pabesimtari e sheh se melekët i kanë ardhur me program të ndëshkimit dhe fillon goditja ndaj tyre, ndërsa

- besimtari i sheh melekët se kanë ardhur me program të begative dhe me përgëzim të xhenetit.

Përpos kësaj paraqitet edhe sprova e rëndë për pabesimtarët në çastin e vdekjes nga melekët. Lexo ajetin e Zotit të Lartmadhëruar:

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا أَوْ قَالَ أُوحِيَ إِلَيَّ وَلَمْ يُوحَ إِلَيْهِ شَيْءٌ وَمَنْ قَالَ سَأُنْزِلُ
مِثْلَ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَلَوْ تَرَىٰ إِذِ الظَّالِمُونَ فِي غَمَرَاتِ الْمَوْتِ وَالْمَلَائِكَةُ بَاسِطُو أَيْدِيهِمْ
أَخْرِجُوا أَنْفُسَكُمُ الْيَوْمَ تُجْزَوْنَ عَذَابَ الْهُونِ بِمَا كُنْتُمْ تَقُولُونَ عَلَى اللَّهِ غَيْرَ الْحَقِّ وَكُنْتُمْ
عَنْ آيَاتِهِ تَسْتَكْبِرُونَ ﴿٩٣﴾

“E, kush është mëkatar më i madh se sa ai që trillon gënjeshtër ndaj Zotit, ose thotë:

- Mua po më shpallet se (Muhamedit) nuk i është shpallur asgjë, ose se sa ai që thotë:

- Do të thur diçka të ngjashme me atë që e ka zbritur All-llahu.

E, sikur t'i shihje mizorët kur janë në agoni të vdekjes, e engjëjt kanë shtrirë duart e veta (me ndëshkim) e (u thonë): - Shpëtojeni pra vetveten (nëse mundeni). Tash përjetoni dënimin e turpshëm për shkak se e thoshit të pavërtetën për All-llahun.

Dhe ndaj argumenteve të Tij ishit kryeneç.” (El En’am : 93)

Melekët, çdo pabesimtari dhe çdo kriminel i thonë:

- Nëse sot ke forcë dhe fuqi, tani ashtu siç e tregoje fuqinë tënde në jetën e dunjasë, bëji vetes zgjidhje dhe liroju nga kjo vështirësi.
- Nëse ke pushtet dhe forcë, liroje veten, por ti nuk mundesh.
- Ti, në jetën e dunjasë pretendoj se ke forcë dhe fuqi, por sot e kuptove të vërtetën dhe realitetin dhe e mësove se forca e Allahut është mbi të gjithë pa përjashtim dhe se të gjitha si pozita, fuqia, që të gjitha kanë qenë prej Allahut, ndërsa ti personalisht nuk ke poseduar asgjë.
- E ke llogaritur veten se mund të veprosh çka të duash e mund të veprosh çka të duash, dhe se ti ke fuqi, por ja tani je në çastin e së vërtetës, ku nuk ka iluzione dhe dyshime por ka vetëm vërtetësi dhe realitet.

Berzahu (jeta në mes të dy jetëve) është një lloj jete të cilën njeriu e jeton në mes të vdekjes dhe ringjalljes. Zoti i Lartmadhëruar shumë pak na ka mësuar për rregullat e kësaj jete, por e vërteta është se është një lloj i ekzistimit.

Njeriu, kur të jetë i vdekur dëgjon, por nuk mund të kthej përgjigje. Muhamedi s.a.v.s. u ka ligjëruar të pabesimtarëve të vrarë në luftën e Bedrit duke i thirrur:

“O Ebu Xhehl bin Hisham, o Umej bin Halef, o Utbe bin Rebia, o Shejbe bin Rebia. A nuk e keni marrë atë çka me të vërtetë u ka premtuar Zoti juaj, sepse unë e kam marrë atë që ma ka premtuar Zoti im!”

Këtë fjalim të peygamberit s.a.v.s. e dëgjon Omeri r.a. dhe i thotë: *O i dërguar i Allahut. Si mund të të dëgjojnë dhe a mund të të japin përgjigje, kur janë trupa të pajetë?* Muhamedi s.a.v.s. i thotë: ***Pasha Atë, që shpirti im është në dorën e Tij, as ju nuk mund të dëgjoni më mirë, por ata nuk kanë mundësi të përgjigjen.***

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'anin fisnik na ka treguar se çka ju ndodh disave prej të vdekurve në varret e tyre:

النَّارُ يُعْرَضُونَ عَلَيْهَا غُدُوًّا وَعَشِيًّا وَيَوْمَ تَقُومُ السَّاعَةُ أَدْخِلُوا آلَ فِرْعَوْنَ أَشَدَّ الْعَذَابِ ﴿٦٦﴾

“Zjarri u ekspozohet në të natën dhe ditën, por në ditën e gjykimit (u thuhet):

- Familje e Firaunit, hyni në dënimin më të fuqishëm.” (Gafir : 46)

Kjo na bën që të kuptojmë se në berzah ka jetë dhe se në këtë lloj jete njeriu ka ndjenja dhe mendje me të cilën i dallon gjërat, sepse po të ishte vdekja vetëm heshtje dhe humbje ndjenjash, nuk do të ishte e mundur që familjes së Firaunit t'i paraqitej zjarri dy herë në ditë. Çështja e ekspozimit të zjarrit, ka kuptimin se ata e dallojnë dhe e ndjejnë që është zjarr. Sepse po të ishte ndryshe, nuk do ta dinin se është zjarr dhe nuk do ta ndjenin ndëshkimin, kurse ky lloj ekspozimi i zjarrit çdo ditë nuk do të kishte kuptim, sepse kuptim ka vetëm nëse i djeg dhe u shkakton dhimbje të madhe, e kjo dhimbje vjen si pasojë e lajmit se sigurt do të dënohen në zjarr. Pritja e dënimit është më e dhimbshëm se vet dënimi. Po të mos ndienin dhimbje nga ai ekspozim, atëherë nuk do të kishte pasur efekt ai proces i ekspozimit.

Koha dhe jeta në berzah

Sipas thënies së Zotit të Lartmadhëruar, “zjarri” u ekspozohet atyre (familjes së Firaunit) në mesditë dhe në mesnatë. Ky është një sinjalizim se është një lloj kohe e jetës në berzah të ndryshme nga bota në të cilën jetojmë, sepse “mesdita” dhe “mesnata” janë periodë me të cilat karakterizohet jeta e tokës.

Mirëpo, në cilën kohë të mesnatës dhe të mesditës i ekspozohet zjarri familjes së Firaunit?

Ajeti fisnik na tregon dy gjendje të familjes së Firaunit, e ato janë:

- Ekspozimi zjarrit; dhe
- Hyrja në zjarr.

A i është ekspozuar zjarri në jetën e kësaj bote familjes së Firaunit?

Natyrisht se jo.

Ata (familja) po ta shihnin zjarrin derisa kanë qenë gjallë në këtë botë (para vdekjes), do t'i binin në sexhde Zotit të Lartmadhëruar dhe do ta mbytnin Firaunin i cili e konsideronte veten Zot, atë do ta konsideronin gënjeshtar, ndërsa është e kundërta, “sepse ai do t'ju prij për në zjarr”, e këtë e bazojmë në fjalën e Zotit të Lartmadhëruar:

يَقْدُمُ قَوْمَهُ يَوْمَ الْقِيَمَةِ فَأَوْرَدَهُمُ النَّارَ وَبِئْسَ الْوَرْدُ الْمَوْرُودُ ﴿٩٨﴾

“Në ditën e kiametit, ai (Faraoni) i prinë popullit të vet dhe i fut në zjarr. Sa i shëmtuar është ai vend i ofruar.” (El Hud : 98)

Po të thoshim se: “zjarri” do t'i ekspozohet familjes së Firaunit në ditën e Kiametit, prapë do të ishte gabim, sepse në ditën e Kiametit do të hyjnë në të. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

النَّارُ يُعْرَضُونَ عَلَيْهَا غُدُوًّا وَعَشِيًّا وَيَوْمَ تَقُومُ السَّاعَةُ أَدْخِلُوا آلَ فِرْعَوْنَ أَشَدَّ الْعَذَابِ ﴿٤٦﴾

“Dhe në ditën e ringjalljes dhe të Kiametit (do të thuhet): - Futeni familjen Firaunit në ndëshkimin më të madh.” (Gafir : 46)

Ekzistojnë tri faza të jetës së njeriut:

- Jeta e kësaj bote;
- Jeta prej vdekjes deri në ringjallje (jeta në berzah);
- Jeta në botën tjetër.

Prej këtyre tri fazave, do të mundohemi të gjejmë se në cilën fazë të jetës do t'i paraqitet zjarri familjes së Firaunit.

Pasi që nuk ka ndodhur në këtë botë dhe në ditën e gjykimit do të hyjnë në të, atëherë ekspozimi i zjarrit patjetër se duhet të mbetet në periudhën në mes të vdekjes dhe ringjalljes, pra në jetën në berzah.

Me këtë, vërtetohet se ekziston jeta në berzah dhe gjatë asaj jete do t'u ekspozohet zjarri familjes së firaunit.

Pyetja është: A u ekspozohet zjarri përderisa janë në varrezat e tyre, apo kjo realizohet në atë mënyrë që Zoti i Lartmadhëruar i tubon ata që t'ua ekspozoj zjarrin?

(Përgjigja është se): Pa marrë parasysh se a bëhet ekspozimi duke qenë ata në varreza, apo në çfarëdo forme tjetër. Kryesorja që kuptohet prej ajetit fisionik është se ekziston një lloj jete tjetër në berzah, ku ka ndjenja dhe ekzistencë të menduarit.

Po ashtu, kuptojmë se: njeriu në berzah e mëson rezultatin se a do të shkoj në xhenet apo në xhehenem, dhe ai, ose e sheh vendin e tij në xhenet, ose e sheh vendin e tij në xhehenem. Këtë e vërteton pejgamberi s.a.v.s. kur thotë:

“Varri, ose është kopsht prej kopshteve të xhenetit ose skëterrë prej skëterrave të zjarrit (xhehenemit).”

Për këtë arsye, dënimin në varr qëndron në atë se *njeriu e sheh vendin e tij në xhehenem*, me dënim të trishtueshëm, kurse ne veçse e kemi thënë më herët se *pritja e fatkeqësisë* është më e keqe se vet fatkeqësia. Kjo shpjegohet me atë se, p.sh.: Nëse e kupton se fëmija yt i vetëm, pas një viti me siguri do të vdes nga një aksident komunikacioni, a nuk është dënim për ty gjatë gjithë vitit, saqë e dëshiron vdekjen vetëm e vetëm të lirohesh nga pikëllimi dhe vështirësia e atij mundimi. Kështu, të priturit e fatkeqësisë është dënim më i madh se vet fatkeqësia.

Kemi edhe ajetin tjetër, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَتَوَلَّوْا قَوْمًا غَضِبَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ قَدْ يَئِسُوا مِنَ الْآخِرَةِ كَمَا يَئِسَ الْكُفَّارُ مِنْ أَصْحَابِ الْقُبُورِ ﴿١٣﴾

“O ju që keni besuar, mos u miqësoni me një popull për të cilët All-lahu ka shprehur hidhërim, popull që ka humbur shpresën ndaj botës së ardhshme, ashtu siç jobesimtarët nga radhët e të vdekurve nuk kanë më shpresë (që do të ngjallen) në këtë botë, ose në ringjallje (në botën tjetër).” (El Mumtehine : 13)

Patjetër duhet të përqendrohemi në thënien e Zotit të Lartmadhëruar ***“...ashtu siç jobesimtarët nga radhët e të vdekurve nuk kanë më shpresë***

(që do të ngjallen)...” e cila e ka kuptimin se ata janë të dëshpëruar, dhe kjo tregon se gjatë jetës në berzah ekziston një lloj ndjenje e cila ka hyrë në shpirtrat e dëshpëruar të tyre, sepse po të ishte njeriu në varrin e tij pa ndjenja ai nuk do të kishte pasur mundësi të shpresoj apo të mos shpresoj, mirëpo vet çështja se ata dëshpërohen, tregon se ata me siguri e kanë kuptuar përfundimin e tyre, i cili është në zjarr.

Këto janë disa pasqyrimë të cilat na i ka dhënë Allahu për jetën në Berzah, sepse aty ka jetë dhe ajo jetë posedon ligjet e saj. Ne duhet të kuptojmë se Zoti i Lartmadhëruar e ka specifikuar familjen e Firaunit me ekspozim të zjarrit në jetën në berzah, për shkak të mizorisë së tyre dhe adhurimit të tyre ndaj Firaunit dhe na tregon faktin se ato nuk kanë bërë mëkate duke qenë të imponuar, por kanë bërë mëkate duke urdhëruar, përveç kësaj, Musai a.s. i ka shkuar familjes së Firaunit me argumente të shumta që t’u dëshmoj atyre se vetëm Allahu është Zot, por ato nuk kanë pranuar, përkundrazi vetëm janë tallur. Dhe, shkuarja e pabesimtarëve dhe mëkatarëve në zjarr të xhehenemit do të bëhet vetëm pas llogarisë së ditës së gjykimit, përderisa në fazën e jetës në varreza njeriu e di vendin e tij se ku do të përfundojë:

- ose do të jetë i begatuar në varrin e tij, e begatia e tij do të jetë se do ta dinë se çka e pret,

- ose se do të jetë prej banorëve të zjarrit, Zoti na mbrojtë prej tij, e ai është në një ndëshkim i madh, se ai e kupton se ku do të përfundoj.

Përderisa, sa i përket shkuarjes në xhenet apo në xhehenem, bëhet vetëm pas dhënies së llogarisë në ditën e gjykimit.

Përfundimi i kësaj që shpjeguam është se: edhe pse shkenca është zhvilluar aq shumë, është gabim që njeriu të mendoj se ai ka fuqi dhe se fuqia e tij është e para dhe e fundit dhe se ai ka mundësi të bëjë çdo gjë në tokë, sepse vdekja i vjen befasish që t’ia shuaj iluzionin e madh të tij dhe e bën ta kuptoj se ai nuk është gjithçka dhe se çdo gjë që është në këtë botë është prej krijimtarisë së Allahut të Lartmadhëruar dhe ka skaduar afati që ai të pendohet, sepse pendimi në çastin e vdekjes, kur njeriu e sheh vendin e tij, është pendim i detyrimit. Në çastin e vdekjes, pendimi i tij nuk është pendim i besimit (imanit), sepse dihet se besimi (imani) duhet që të jetë besim ndaj të padukshmes, siç e tregon Zoti i Lartmadhëruar:

الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْغَيْبِ وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ ﴿٣﴾

“Ata të cilët e besojnë në të padukshmen dhe e falin namazin....” (El Bekare : 3)

Ai sekret i është zbuluar dhe ka marrë fund faza që ai të besoj (faza e imanit).

KAPITULLI I PESTË

Statika ndryshon
Testimi i ngjalljes dhe ringjalljes
Shkaqet dhe fuqia absolute
Kur dielli të lind nga perëndimi
Qielli dhe Tymi
Sfida vlen edhe për sot dhe do të vazhdoj

Statika ndryshon

Zoti i Lartmadhëruar na ka treguar se, ekziston një lloj jete (jeta në varreza) që quhet *jeta në berzah*. Njerëzit mendojnë se ajo jetë është sikurse jeta e kësaj bote, mirëpo ky perceptim është i gabuar, sepse koncepti i jetës së dunjasë i ka ligjet e saj, ndërsa jeta në botën tjetër i ka ligjet e saj.

Sa i përket perceptimit të njeriut, të gjitha ato ligje ndryshojnë tërësisht ndaj njëra-tjetrës. Shembull:

- jeta në botën tjetër është e përgjithmonshme. Në të nuk ka vdekje.
- në jetën në varreza (berzah) zbulohen sekretet të cilat në këtë botë kanë qenë të fshehura.

Zoti i Lartmadhëruar na ka treguar për disa shenja të mëdha të cilat do të ndodhin para fundit të botës. Pasi që Zoti i Lartmadhëruar na ka lajmëruar se këto shenja do të ndodhin, ne jemi të sigurt se do të ndodhin, mirëpo nuk është e patjetërsueshme të dimë se si do të ndodhin.

Ka dallim në mes të *besimit në të vërtetën* dhe dijenisë se *si ndodhë ajo e vërtetë*.

Besimi në të vërtetën është diçka tjetër, ndërsa dijenia se si ndodh ajo e vërtetë është diçka tjetër. Mënyra e realizimit të shenjave të ditës së kiametit është prej sekreteve të Allahut të Lartmadhëruar. Për këtë arsye, Ibrahim i a.s. e ka pyetur Zotin e tij për mënyrën e procesit të jetës dhe vdekjes, siç na tregon Kur’ani fisnik:

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ رَبِّ أَرِنِي كَيْفَ تُحْيِي الْمَوْتَىٰ قَالَ أَوْ لَمْ تُؤْمِنْ قَالَ بَلَىٰ وَلَٰكِن لِّيَظْمَنَ قَلْبِي

“Dhe kur Ibrahim i tha Zotit të tij: - Si i ngjall të vdekurit?

(Zoti) tha: - A nuk po beson?

(Ibrahimi) Tha: - Po, por dëshiroj që të qetësoj zemrën time.” (El Bekare : 260)

Disa që dyshojnë, kanë dashur të dëshmojnë me këtë ajet fisnik se ky ajet është një bazë e cila tregon se kjo pyetje e ka dëmtuar imanin e babait të pejgamberëve, Ibrahimit a.s.. Të cilin Zoti i Lartmadhëruar e ka bërë Imam të njerëzimit dhe e ka pastruar me sprova të panumërta dhe të pakufishme. E ka forcuar me forcën e shkëmbinjve të rrënjosur dhe ka bërë që prej lozes së tij të pasojnë Pejgamberët. Gjithë ky nderim ndaj Ibrahimit a.s. ka qenë për shkak të besimit të vërtetë.

Prej bazave të besimit, është të besuarit se Allahu ka mundësi të ngjallë të vdekurit. Pyetja e Ibrahimit ka qenë vetëm në çështjen e *mënyrës*.

Zoti i Lartmadhëruar ka dashur t'ia bëjë me dije Ibrahimit dhe të gjithë njerëzimit se Zoti nuk pyetet për *mënyrën*, dhe mos pyet *si*, sepse Zotit të Lartmadhëruar i mjafton t'i thotë një gjëje *bëhu* dhe ajo *bëhet*. Nga ky prizëm, *mënyra* është mbi aftësinë e *logjikës*. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar e ka vendosur që ta testoj imanin (besimin) e Ibrahimit a.s.:

قَالَ فَخُذْ أَرْبَعَةً مِّنَ الطَّيْرِ فَصُرْهُنَّ إِلَيْكَ ثُمَّ اجْعَلْ عَلَىٰ كُلِّ جَبَلٍ مِّنْهُنَّ جُزْءًا ثُمَّ ادْعُهُنَّ يَأْتِينَكَ سَعْيًا وَاعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٢٦﴾

“...tha: - Merri katër zogj. Shpërndaji në çdo kodër secilën prej tyre. Pastaj thirri, e ata do të vijnë me të shpejtë dhe ta dish se Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.” (El Bekare : 260)

A mos ia ka mësuar Zoti i Lartmadhëruar Ibrahimit mënyrën? Jo! Por e ka bërë që ta shoh (ringjalljen), pa ia treguar sekretin e saj, sepse siç e treguam edhe më parë: Kjo është mbi kapacitetin e logjikës njerëzore.

Demonstrimi praktik i ngjalljes dhe ringjalljes

Ndryshimi i statikes (ligjit të pandryshuar) nuk ka ndodhë vetëm me Ibrahimin a.s. (me rastin e shpendëve), por ka edhe raste tjera, siç është rasti me njërin prej pejgamberëve Jehud, pastaj rasti me Zekerijain a.s., pastaj edhe me Merjemen.

Le ta shohim rastin kur njëri prej pejgamberëve të beni Israilëve ishte duke kaluar pranë një fshati i cili ishte shkatërruar nga dënimi i Zotit të Lartmadhëruar, siç na e tregon Kur’ani fisnik:

أَو كَالَّذِي مَرَّ عَلَى قَرْيَةٍ وَهِيَ خَاوِيَةٌ عَلَى عُرُوشِهَا قَالَ أَنَّى يُحْيِي هَذِهِ اللَّهُ بَعْدَ مَوْتِهَا فَأَمَاتَهُ اللَّهُ مِائَةَ عَامٍ ثُمَّ بَعَثَهُ

“Ose sikurse ai i cili kaloi pranë një vendbanimi deri sa ishte shkatërruar deri në themelet e saj dhe tha: - Si do t’i ringjallë Allahu të vdekurit e saj. Menjëherë Allahu e bëri që të vdes për 100 vite, e pastaj e ringjalli...” (El Bekare : 259)

Pasi që Allahu i kishte shkatërruar banorët e atij vendbanimi në mënyrë totale, ky pejgamber ka pyetur se *si* i ringjall Zoti i Lartmadhëruar?

Zoti i Lartmadhëruar ka dashur të na e tërheq vërejtjen se, kur është në pyetje Allahu, nuk ekziston pyetja *si*. Për këtë arsye, e ka bërë që të vdes dhe të mbetet i vdekur 100 vite, e pastaj e ka ringjallur, ashtu siç na tregon Zoti i Lartmadhëruar kur e ka pyetur:

قَالَ كَمْ لَبِثْتَ قَالَ لَبِثْتُ يَوْمًا أَوْ بَعْضَ يَوْمٍ قَالَ بَلْ لَبِثْتَ مِائَةَ عَامٍ فَانْظُرْ إِلَى طَعَامِكَ وَشَرَابِكَ لَمْ يَتَسَنَّهْ

“(Allahu) Tha: - Sa vite ke fjetur?

Tha: - Kam fjetur një ditë apo një pjesë dite.

(Allahu) Tha: - Përkundrazi, ju keni fjetur 100 vite.” (El Bekare : 259)

Kur ka pyetur për mënyrën (e ringjalljes së të vdekurve), Allahu e ka bërë që të vdes dhe të mbetet i vdekur 100 vite. Kur është zgjuar, sheh se vet nuk ka ndryshuar asgjë, por ka qenë në të njëjtën gjendje në të cilën ka vdekur. Është zgjuar ashtu siç ka qenë, i ri dhe i fuqishëm. Rreth tij nuk ka pasur asgjë, edhe sepse ai ka qenë i vdekur për 100 vite. Për këtë arsye, kur e ka pyetur Zoti i Lartmadhëruar “...sa vite ke fjetur?”. Ai duke bërë krahasim me gjumin e rëndomtë, është përgjigjur: “Kam fjetur një ditë apo një pjesë dite.” Është përgjigjur kështu, sepse zakonisht njeriu nuk

mund të flejë më shumë. Atëherë Zoti i Lartmadhëruar i ka sjell atij argumentin lëndor që e fakton atë se ai ka qenë i vdekur 100 vite dhe është ringjallur. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَأَنْظُرْ إِلَى حِمَارِكَ وَلِنَجْعَلَكَ آيَةً لِلنَّاسِ وَنَنْظُرْ إِلَى الْعِظَامِ كَيْفَ نُنْشِزُهَا ثُمَّ نَكْسُوهَا
لَحْمًا

“Shikoje ushqimin dhe pijen tënde se si nuk është prishur,

(ne anën tjetër) kurse shikoje gomarin tënd (se si i janë shkapërderdhur eshtrat), dhe që të bëjmë ty argument për njerëzit, shiko në eshtrat (e gomarit) se si i bashkojmë dhe i plotësojmë dhe i veshim me mish.”

Kështu, Zoti i Lartmadhëruar i ka treguar për fuqinë e Tij, se si e ka ruajtur ushqimin e tij që të mos prishej dhe të mos ndryshoj nga ndikimi (klimatik) qindvjeçar.

Pastaj ka shikuar në gomarin e tij dhe e ka parë se gomari i tij ishte bërë krejt eshtra të shkapërderdhur. Pra, gomari i ka ngordhur, është kalbur, pastaj i janë shpërndarë eshtrat, saqë janë bërë eshtra të shkapërderdhur. E kjo nuk ka mundur t'i ndodh për një ditë e një natë.

Pastaj Allahu i ka dhënë argument tjetër. Ia dëshmon rikthimin dhe ribashkimin e eshtrave të shpërndarë dhe kthimin e gomarit në jetë normale. Pastaj (pejgamberi) tha:

قَالَ أَعْلَمُ أَنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢٥٩﴾

“Tha: - Unë e di se Allahu ka mundësi për çdo gjë.” (El Bekare : 259)

Fuqia absolute e Zotit të Lartmadhëruar e ka bërë që koha të pasivizohet (ndalet) për ushqimin, ashtu që të mos prishej dhe të qëndroj i freskët. Përderisa, koha ka vazhduar të jetë aktive sa i përket gomarit, për këtë arsye eshtrat e tij janë shkapërderdhur.

Allahu i Lartmadhëruar me fuqinë e Tij bën që një send të bëhet e kundërta e ligjit të vet. Mirëpo a mos ia tregoi Zoti i Lartmadhëruar mënyrën se si e bën atë?

Jo! Por Zoti i Lartmadhëruar e ka bërë demonstrimin praktik me qëllim që ta kuptoj se Zoti i Lartmadhëruar ka mundësi për çdo gjë.

(Rasti tjetër) Kur hyri Zekerijai a.s. në mihrab të Merjemes, dhe pa se aty kishte pemë të cilat nuk ishin të atij sezoni, si veprooi ai?

Ai duke qenë i frymëzuar me fuqinë e argumenteve të cilat i ka parë, i kujtoi shkaqet dhe e dinte se tek ai dhe te bashkëshortja e tij mungojnë,

atëherë iu drejtua dhe iu lut Zotit të Lartmadhëruar, dhe siç tregon Kur'ani fënisnik:

قَالَ رَبِّ اَنِّىْ يَكُوْنُ لِىْ غُلَمٌ وَقَدْ بَلَغَنِى الْكِبَرُ وَاُمْرَأَتِىْ عَاقِرٌ قَالَ كَذٰلِكَ اَللّٰهُ يَفْعَلُ مَا يَشَآءُ



“Tha: - O Zoti im! Po si të kem fëmijë, kur kam arritur moshën e pleqërisë, ndërsa gruaja ime është plakë dhe shterpë.

(Meleku) Tha: - Kështu, Allahu vepron si të dëshiron.” (Ali Imran : 40)

Shkaqet dhe fuqia absolute

A mos i ka treguar Zoti i Lartmadhëruar (Zekerijait a.s.) për mënyrën se si pa kurrfarë shkak do t'ia dhuroj atij djalë?!

Shkaqet na dëshmojnë që gruaja plakë dhe sterile nuk mund të lind fëmijë. Kur kësaj i shtohet edhe pleqëria e burrit të saj, atëherë gjasat e pamundësisë së lindjes janë edhe më të mëdha, bile kjo sipas shkaqeve dhe ligjeve njerëzore llogaritet si absurditet. Mirëpo, Allahu është Ai i cili i ka caktuar ato shkaqe dhe ato shkaqe para fuqisë së Tij në momentin kur dëshiron Ai nuk kanë vlerë. Zoti i Lartmadhëruar pejgamberit të tij nuk i ka treguar mënyrën se si do të realizohet ai proces, mirëpo Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِنَّ رَبَّكَ فَاعَلٌ لِّمَا يُرِيدُ ﴿١٧﴾

“Kështu, Allahu vepron çka të dëshirojë.”

(Rast tjetër) Mejremja, bija e Imranit, edhe pse kishte parë mrekulli mbinatyrore të shumta, u habit kur u përgëzua nga melekët se do të lind Isain a.s.. Asaj i kishte ardhur pranë ushqim prej pemëve të cilat kishin qenë jashtë sezonit dhe i kishin ardhur pa ia sjellë askush, pra pa ndërmjetësim. Ato kanë qenë begati nga Allahu, të realizuara pa kurrfarë shkak, mirëpo prapë se prapë kur u përgëzua me një djalë, ajo kërkonte shkaqe. Këtë e tregon Zoti i Lartmadhëruar:

قَالَتْ أَنَّى يَكُونُ لِي غُلَامٌ وَلَمْ يَمْسَسْنِي بَشَرٌ وَلَمْ أَكُ بَغِيًّا ﴿٢٠﴾ قَالَ كَذَلِكَ قَالَ رَبُّكَ هُوَ عَلَيَّ هَيِّئٌ وَلَنَجْعَلَنَّ آيَةً لِلنَّاسِ وَرَحْمَةً مِنَّا وَكَانَ أَمْرًا مَّقْضِيًّا ﴿٢١﴾

“(Merjemja tha) - Si mund të kem djalë kur nuk më ka prekur njeri dhe nuk jam e pandershme.

(Meleku) I tha: - Kështu është! Zoti ka thënë: Për Mua kjo është shumë e lehtë. Ne, atë do ta bëjmë shenjë për njerëzimin dhe mëshirë nga ana Jonë. Dhe kjo punë ka marrë fund.” (El Merjem : 20, 21)

Në suren Ali Imran:

قَالَتْ رَبِّ أَتَىٰ يَكُونُ لِي وَلَدٌ وَلَمْ يَمْسَسْنِي بَشَرٌ قَالَ كَذَلِكَ اللَّهُ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ إِذَا قَضَىٰ أَمْرًا فَإِنَّمَا يَقُولُ لَهُ كُن فَيَكُونُ ﴿٤٧﴾

“Ajo tha: - Zoti im! Si mund të kem unë fëmijë, kur nuk më ka prekur asnjë njeri?!”

Tha (meleku): Kështu Allahu krijon ç’të dojtë Vet. Kur merr vendim për diçka, vetëm thotë bëhu dhe ajo bëhet.” (Ali Imran : 47)

Kështu, kur Merjemja ka bërë pyetje, se si është e mundur të lind djalë përderisa ajo nuk ka qenë e prekur nga asnjë njeri, kur dihet se “fëmija lind” me shkaqet e kësaj bote dhe shkaqet na mësojnë se fëmija nuk mund të lind pa kontaktin e burrit me gruan. Zoti i Lartmadhëruar nuk i ka treguar se në çfarë mënyre do të realizohet lindja e fëmijës, por vetëm i ka thënë:

“Tha: Kështu tha Zoti yt.” - قَالَ رَبُّكَ

Kështu, ne e shohim se kur Zotin e Lartmadhëruar e kanë pyetur pejgamberët e tij, të cilët nga të gjithë njerëzit i ka zgjedhur Allahu dhe i ka ngarkuar që programin qiellor ta transmetojnë në tokë dhe ka ndodhur çka ka ndodhur, Ai u ka thënë:

“Tha: Kështu ka thënë Zoti yt.”

Kështu është sqaruar edhe kur kemi folur për argumentet e gjithësisë të cilat Allahu do t’ia shfaq robërve të Tij kur të afrohet dita e gjykimit, e cila do të ndodh në momentin e saj. Nuk ka më fjalë, as pyetje se si do të ndodh, pasi që ne e kemi parë fuqinë absolute të Allahut. Dhe nuk ka asgjë në qiell dhe në tokë që i bën ballë Allahut.

Për atë se çka do të ndodhë dhe si do të paraqiten shenjat, kur të afrohet fundi për tu shkatërruar kjo botë, Zoti i Lartmadhëruar në Kur’anin fisnik thotë:

وَإِذَا وَقَعَ الْقَوْلُ عَلَيْهِمْ أَخْرَجْنَا لَهُمْ دَابَّةً مِّنَ الْأَرْضِ تُكَلِّمُهُمْ أَنَّ النَّاسَ كَانُوا بِآيَاتِنَا لَا يُوقِنُونَ ﴿٨٢﴾

“Dhe kur të vjen realizimi i fjalës Sonë kundër tyre, Ne do të bëjmë që nga toka të del një kafshë, e cila do t’u flas atyre, për shkak se nuk i janë bindur shenjave dhe shpalljeve Tona.” (En-Neml : 82)

Zoti i Lartmadhëruar na tregon se, pasi që njeriu do të arrij në kulmin e zhvillimit shkencor dhe kur të llogarit se ka arritur të zotëroj çdo gjë dhe

kur të mendoj se toka i është nënshtruar atij, atëherë do të vjen Zoti i Lartmadhëruar me fuqinë e tij, me shenja, përballë të cilave ai (njerëzimi) do të jetë i paaftë.

Njeriu ka arritur të shkojë në hënë, e ndoshta do të shkon edhe në Mars.

Shkenca për çdo ditë na sjellë diçka të re.

Njeriu të gjitha gjatësitë e hapësirave qiellore i ka shkurtuar.

Ka arritur në një situatë ku, në qoftë se ndodhë ndonjë aksident në ndonjë vend, do t'i shohësh të gjithë njerëzit nga të katër anët e tokës duke shkuar për informim në atë vend.

Ka arritur në pikën ku, njeriu mund të flet me çdo vend të botës dhe që në momentin e mbajtjes së një fjalimi, zëri i tij arrin të dëgjohet në tërë tokën.

Shpikjet tjera që do të vijnë në të ardhmen, do të jenë edhe më shumë të avancuara dhe, kur njeriu do të mashtrohet me diturinë e tij, të testuar me atë që e ka realizuar, Zoti i Lartmadhëruar ua nxjerr atyre një **kafshë nga toka**. Kjo **kafshë** do t'i sfidojë aftësitë e njerëzve. E tërë dituria e cila u është dhënë dhe çdo zbulim shkencor të cilin Zoti i Lartmadhëruar ua ka mundësuar që ta zbulojnë në gjithësi, do të jetë e paaftë që ta bëj **kafshën** të flas, e, Zoti i Lartmadhëruar do ta nxjerr kafshën e Tij nga toka që t'u flet atyre.

Mirëpo, ajo **kafshë**, ashtu që mrekullia mbinatyrore të jetë edhe më e madhe a do të flet vetem me një gjuhë, apo do të flasë me të gjitha gjuhët e tokës,?.

Kur të del ajo, askush nuk do të mund të bëjë asgjë. Kjo kafshë të gjithë njerëzve do t'ua dëshmoj se dituria e tyre është e cekët dhe e kufizuar. Njerëzit kanë menduar se me atë çka kanë arritur shkencërisht, e kanë zotëruar çdo gjë në tokë, mu atëherë, nën hijen e asaj bindjeje false, e shohin këtë **kafshë** e cila u flet atyre, e cila i sfidon dhe dëshmon se si ka ndodhur ai (zhvillim shkencor).

Ne, veç e kemi sqaruar më herët, se për Allahun nuk ka si. Kjo **kafshë** do të jetë prej shenjave të cilat tregojnë se dita e gjykimit është çështje e cila veç do të ndodhë gjithsesi.

Për këtë shenjë (ditën e gjykimit) do të flasë kafsha?

Shenja tjetër, prej shenjave të cilat na flet i dërguari i Allahut s.a.v.s. është:

“Nuk do të ndodhë dita e gjykimit derisa të lind dielli nga perëndimi i saj.”

Njerëzit në këtë botë e shohin se dielli lind nga Lindja. Kjo lindje e diellit nga lindja është bërë me dëshirën e Zotit të Lartmadhëruar, i cili e përmbys dhe e ndryshon këtë ligj dhe këtë rregull, në kohën e përfundimit të botës!

Parashtrohet pyetja: Si do të ndodhë kjo?

Nuk kërkohet nga ne që ta dimë. E rëndësishmja është se sistemi i gjithësisë do të rrokulliset. Zoti i Lartmadhëruar do ta ndryshoj sistemin statik, për të cilin kanë besuar të gjithë se është i përgjithmonshëm dhe se nuk do të ndryshoj dhe nuk do të zëvendësohet me sistem tjetër. Madje njerëzit do të mendojnë se dituria e tyre të cilën e kanë arritur, do tu jep mundësi që të kenë fuqi ta pengojnë ndryshimin. Pastaj, në një çast të vetëm paraqiten shenjat e Allahut, të cilat i rrëzojnë të gjitha pretendimet (iluzionet). Atëherë njerëzve u sqarohet paaftësia dhe dobësia e tyre dhe se përballë fuqisë së Allahut të Lartmadhëruar nuk mund të bëjnë asgjë sepse askush pos fuqisë së Tij (absolute) nuk ka fuqi të ndryshoj diçka.

Kur dielli të lind nga perëndimi

Siç kemi thënë edhe më herët, ka dallim në mes të besimit në të vërtetën dhe diturisë se si do të ndodhë ajo e vërtetë.

Pejgamberi s.a.v.s. na ka lajmëruar se para ditës së gjykimit, dielli do të lind nga perëndimi. Kjo na dëshmon të vërtetën dhe realitetin se, Zoti i Lartmadhëruar është i Vetmi i cili e ndryshon atë që nuk mund të ndryshohet dhe se nuk ka asgjë në gjithësi që është statike dhe të përgjithmonshme dhe se çdo gjë që e shohim se është statike, i vjen koha dhe Zoti i Lartmadhëruar e ndryshon si të dëshirojë.

Për të qenë më afër mendjeve tona, nëse dëshirojmë të sjellim një shembull, Zoti është shembull sjellësi më i mirë. Të shohim pak sistemin diellor në të cilin jetojmë, po tjetër çka kemi?! Toka sillet rreth diellit, toka rrotullohet në vetvete, hëna sillet rreth tokës. Në Kur'anin fisnik Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَالشَّمْسُ تَجْرِي لِمُسْتَقَرٍّ لَّهَا ذَلِكَ تَقْدِيرُ الْعَزِيزِ الْعَلِيمِ

“Dhe dielli qarkullon për në vendmbërritjen e vet. Ky është përcaktim i të Fuqishmit, të Diturit.” (Jasinë : 38)

Zoti i Lartmadhëruar ka dashur që të na e tregoj mënyrën e lëvizjes së diellit. Zoti i Lartmadhëruar e ka përdor termin “qarkullon” në mënyrë që të na e bëj me dije se dielli lëviz me shpejtësi të madhe, sepse qarkullimi është më i shpejtë se të ecurit. Vendmbërritja e diellit është një vend të cilin e di vetëm Allahu i Lartmadhëruar.

Përderisa dielli qarkullon për në vendmbërritjen e destinuar të tij, atëherë duhet të dimë se çdo veprim, e ka kundërveprimin në masë të njëjtë, dhe e kthen sendin në drejtim të kundërt të veprimit. Ne këtë mundemi pak a shumë ta parafytyrojmë dhe ta marrim vetëm si shembull, sepse absolutisht nuk ka aspak lidhje me mënyrën e vërtetë të ndodhisë. Pra, ne theksojmë vetëm atë se, mund të jetë e mundur që vendmbërritja e diellit të jetë caku i fundit i qarkullimit të një drejtimi të caktuar, e që pastaj të kthehet në drejtim të kundërt të qarkullimit të forcës së saj dhe atëherë të lind nga perëndimi. Shembull: Nëse i bie topit me forcë në mur, topi kthehet me të njëjtën forcë në drejtim të kundërt. Nëse sistemi diellor shkon deri te vendmbërritja e tij, atëherë do të vjen dita, kur do të përfundoj udhëtimi i tij dhe kthehet në drejtim të kundërt. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dielli qarkullon për në vendmbërritjen e vet.”(Jasinë : 38)

Kjo do të thotë se vendmbërritja e vet për tek e cila është koncentruar, është vendi ku do të ndalet.

Ndalja e tij në vendmbërritjen e vet, bën që të kthehet në drejtimin e saj të kundërt.

Dhe, nëse është duke lindur nga lindja, atëherë do të vjen (lind) nga perëndimi.

Ky është vetëm një ilustrim i përafruar, sepse asnjë prej të gjithë neve nuk mund të thotë fjalën e fundit, bile as nuk mund supozojmë se si do të ndodhë, por është vetëm një pasqyrim me synim përafrimi të ndodhisë, që mendja e njeriut ta mendoj mundësinë e lindjes së diellit nga perëndimi i saj.

Sa i përket kësaj shenje të madhe, nuk duhet të na ik nga mendja një e vërtetë e rëndësishme që është e ndërlidhur me të, e ajo është se: Kur të lind dielli nga perëndimi, më nuk pranohet pendimi. Muhamedi s.a.v.s. në hadith të respektuar thotë:

“Vërtetë, Allahu e zgjat dorën e Tij natën, që t’ia pranoj pendimin, keqbërësit të ditës

dhe e zgjat dorën e Tij ditën, që T’ia pranoj pendimin. keqbërësit të natës, derisa të lind dielli nga perëndimi i saj.”

Kështu pra, lindja e diellit nga perëndimi është prej shenjave të mëdha, të cilat do të ndodhin prej Allahut. Dhe kur të ndodhë, më pendimi nuk pranohet.

Qielli dhe Tymi

Të kalojmë në një prej shenjave të mëdha të ditës së gjykimit e cila do të paraqitet. Lexo thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

فَارْتَقِبْ يَوْمَ تَأْتِي السَّمَاءُ بِدُحَانٍ مُّبِينٍ ﴿١٠﴾ يَغْشَى النَّاسَ هَذَا عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١١﴾ رَبَّنَا
أَكْشِفْ عَنَّا الْعَذَابَ إِنَّا مُؤْمِنُونَ ﴿١٢﴾

“Andaj, ti prite atë (ditë), kur qielli do të lëshoj tym të qartë, që do t’i mbuloj njerëzit (e do tu thuhet): Ky është dënim i dhimbshëm! (Mohuesit do të thonë): O Zoti ynë, lirona prej dënimit! Ne tashmë besojmë.” (Duhan : 10-12)

Kjo është prej shenjave të mëdha e cila do të paraqitet për të përfunduar bota. Të gjitha shenjat të cilat i kemi treguar janë shenjat e mëdha të përfundimit të botës. Kjo shenjë është se nga qielli do të vjen një tym i cili do ta përfshijë gjithë tokën. Ky tym do të kaplojë çdo send, dhe kjo do të ndodhë atëherë kur njeriu do të mëkatojë, do të vetmashtrohet dhe nuk do ta zbatojë planprogramin e Allahut dhe kur të krijoj bindje se kjo botë vepron sipas ligjeve të tij, pra, atëherë paraqitet ky tym, që me të të dënohen njerëzit dhe ky tym do ta mbështjell tokën, e atëherë njerëzit do t’i drejtohen Allahut të Lartmadhëruar, që t’i liroj nga ai ndëshkim, sepse ata do të besojnë, do të pendohen dhe do të drejtohen në rrugën e planprogramit. Mirëpo, në momentin që Allahu do t’ua largon dënimin, do të largohen nga besimi dhe do të bëhen jobesimtar. Pas kësaj, vjen katastrofa e madhe dhe hakmarrja e Zotit ndaj atyre të cilët i shohin argumentet e Zotit, por i kundërshtojnë.

Për këtë sfidë, na ka treguar Zoti i Lartmadhëruar dhe i dërguari i Allahut s.a.v.s.. Kjo është prej shenjave të mëdha të cilat do të ndodhin para përfundimit të kësaj bote. Zoti i Lartmadhëruar e ka sfiduar gjithë njerëzimin me gjithë arritjet dhe fuqinë që e ka që t’i dal përballë fuqisë së Zotit. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ ضَرْبَ مَثَلٍ فَاسْتَمِعُوا لَهُ إِنَّ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ لَنْ يَخْلُقُوا ذُبَابًا وَلَوْ
 اجْتَمَعُوا لَهُ وَإِنْ يَسْلُبْهُمُ الذُّبَابُ شَيْئًا لَا يَسْتَنْقِذُوهُ مِنْهُ ضَعُفَ الطَّالِبُ وَالْمَطْلُوبُ ﴿٧٣﴾ مَا
 قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ إِنَّ اللَّهَ لَقَوِيٌّ عَزِيزٌ ﴿٧٤﴾

“O ju njerëz, ju është sjell një shembull, andaj dëgjojeni atë me vëmendje: Idhujt që ju i adhuron në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as një mizë edhe nëse bashkohen të gjithë për këtë. I dobët është përgjëruesi (adhuruesi), por edhe ai të cilit i përgjërohen (idhujt). Ata nuk e vlerësojnë Allahun me vlerën e Tij të vërtetë. Padyshim se Allahu është i fortë dhe i Plotfuqishëm.” (El Haxh : 73, 74)

Kjo sfidë e Allahut e cila i drejtohet gjithë njerëzimit, vazhdon edhe sot. Kjo sfidë ka filluar para 14 shekujve, ka vazhduar pandërprerë deri më sot, dhe do të vazhdojë deri sa të përfundojë kjo botë, por njerëzit nuk do të munden kurrë që ta krijojnë një mizë. Kjo është krijesa e dobët (miza), me të cilën Allahu i Lartmadhëruar ka dashur të sfidoj tërë botën në përgjithësi, pa përcaktuar ndonjë popull, ndonjë grup të caktuar, apo gjini të caktuar. Zoti i Lartmadhëruar ka kërkuar nga të gjithë shkencëtarët e botës pa përjashtim, që të gjithë të bashkohen, t’i ndihmojnë njëri-tjetrit, t’i bashkojnë forcat që të krijojnë diçka të gjallë, mirëpo deri më tani edhe pse kanë arritur të realizojnë gjëra të shumta si në astronomi, po ashtu edhe në shkencat tjera, ata nuk kanë mundur të krijojnë as një pjesë të një qenie të gjallë.

Sfida vlen edhe për sot dhe do të vazhdoj

Sfida për njeriun është qysh prej kohës së zbritjes së Kur'anit fisnik. Sfida do të bëhet edhe para përfundimit të botës. Kësaj sfide askush nuk ka mundur t'i dalë në ballë, sepse sfidues është Zoti i Lartmadhëruar. Sa herë që kalon një kohë, Zoti vjen me sfida edhe më të mëdha për njerëzimin.

Parashtrohet pyetja: Pse?

: - Sepse sa herë që koha kalon, dobësohet vija e besimit dhe njerëzit orientohen në shkencë dhe vetëmashtrohen me mendjen e tyre. Zoti i Lartmadhëruar ju ka sqaruar atyre për diturinë e tyre të paktë në krahasim me fuqinë e Zotit.

Ndoshta disa pyesin: A dobësohet Kur'ani afër fundit të botës ashtu siç dobësohet vija e besimit?!

Ne themi: Jo!

Imani (besimi) dobësohet, por Kur'ani lartësohet. Këtë ne e shohim edhe sot, përderisa besimi (imani) dobësohet, Kur'ani lartësohet. Ne shohim edhe interesim për botimin e mus'hafit, me ujë të arit. Ne e shohim se çdo njeri dëshiron të ketë në shtëpinë e tij shumë mus'hafa, ose në automjet, ose në vendin e punës. Nëse bën një hulumtim, do të shohësh se ata nuk e kanë lexuar asnjëherë. Ne e shohim se edhe jomuslimanët shfaqin interesim që të botojnë mus'hafin në formate të ndryshme dhe të mëdha. Dëgjojmë se si ndonjë njeri e shkruan Kur'anin vetëm në një faqe të madhe. Janë botuar mus'hafe në Japoni, Itali, Gjermani. E gjithë kjo është aktuale, saqë Zoti i Lartmadhëruar ka bërë që edhe jomuslimanët të botojnë Kur'anin, në atë mënyrë që i takon merita fjalës së Lartmadhërisë së Tij. Për këtë arsye, është për tu habitur kur e sheh atë i cili nuk është musliman që është në shërbim të botimit të Kur'anit, ndërsa nuk është në shërbim të librit të fesë së cilës i takon.

Çështja e Kur'anit do të lartësohet, nga shkaku se është i ruajtur nga Zoti i Lartmadhëruar. Ndërsa sa herë që kalon koha, çështja e besimit dobësohet.

Ka qenë dashur të jetë e kundërta, duke pasur parasysh ngritjen dhe zhvillimin arsimor të njeriut dhe duke zbuluar atë që Allahu ua ka mundësuar të zbulojnë sekretet e gjithësisë dhe ligjet të cilat kanë ndikuar në zhvillim dhe përparim. Pas kësaj shohim thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

إِنَّمَا مَثَلُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا كَمَاءٍ أَنْزَلْنَاهُ مِنْ السَّمَاءِ فَاخْتَلَطَ بِهِ نَبَاتُ الْأَرْضِ مِمَّا يَأْكُلُ
النَّاسُ وَالْأَنْعَامُ حَتَّى إِذَا أَخَذَتِ الْأَرْضُ زُخْرُفَهَا وَازَّيَّنَتْ وَظَنَّ أَهْلُهَا أَنَّهُمْ قَدِرُونَ عَلَيْهَا
أَتَتْهَا أَمْرًا لَيْلًا أَوْ نَهَارًا فَجَعَلْنَاهَا حَصِيدًا كَأَن لَّمْ تَغْنِ بِالْأَمْسِ كَذَلِكَ نُفَصِّلُ الْآيَاتِ
لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٢٤﴾

“Me të vërtetë, jeta e kësaj bote i ngjanë shiut që Ne e lëshojmë nga qielli, e me të përziehet toka dhe bën bimë, me të cilat ushqehen njerëzit dhe kafshët. E, kur toka vishet e zbukurohet dhe kur banorët e saj mendojnë se janë zotërues të saj (tokës), iu vjen urdhri i Ynë, natën ose ditën dhe Ne e bëjmë atë të korrur, thuaja se nuk kishte qenë e stolisur dje. Kështu pra, Ne i shpjegojmë argumentet për popullin që logjikon.”
(Junus : 24)

Në këtë ajet fisnik, Zoti i Lartmadhëruar na e tregon realitetin e kësaj bote që nga fillimi deri në fund të saj, prej fillimit deri në mbarim. Çdo gjë që është në këtë tokë ka zbritur nga qielli, para se të vijë krijesat, që ta kryejnë detyrën e tyre në tokë.

Zoti i Lartmadhëruar, jetën e kësaj bote na e shëmbëllen me ujin i cili zbret nga qielli. Pa ujin, i cili zbret nga qielli nuk mund të ketë jetë në tokë. Nëse ndalet shiu, do të vdiste çdo gjë që është në të, si njerëzit dhe gjallesat, po ashtu edhe bimët, dhe toka do të shndërrohej në shkretëtirë, me fjalë tjera do të bëhej tokë e vdekur.

Kështu pra, të gjitha shkaqet e jetesës vijnë nga qielli. Uji zbret i pastër si loti, pastaj përziehet me dheun e tokës dhe u sjell njerëzve çka u nevojitet për ushqim dhe për ushqimin e bagëtisë së tyre. U sjell atyre ushqim dhe ujë dhe çka e siguron jetën e tyre.

Atëherë, njerëzit fillojnë ta stolisin tokën. Çdo gjë çka është në tokë është stoli e saj. Kjo bazohet në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

إِنَّا جَعَلْنَا مَا عَلَى الْأَرْضِ زِينَةً لِّهَا لِنَبْلُوهُمْ أَيُّهُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا ﴿٢٥﴾

“Çdo gjë që gjendet në tokë, Ne e kemi bërë stoli për të, për të provuar se kush prej tyre punon më së miri.” (El Khef : 7)

Duhet që të përqendrohemi te teksti i ajetit fisnik, se përse Zoti i Lartmadhëruar nuk ka thënë **“...stoli për ju...”**? (Por ka thënë **“...stoli për tokën...”**)

: Kjo, nga shkakut se askush nuk mund ta pronësojë asgjë që është në tokë, ajo mbetet në tokë deri sa të trashëgohet toka (nga vetja) dhe çka ka në të. Pronësimi i tokës është vetëm një term alegorik i pronës, sepse ato **‘prona’** zëvendësohen me **‘pronar’** të ri të asaj që kanë pronësua. P.sh.: Unë them: - “Unë e pronësoj këtë ndërtesë”, mirëpo pasi që të ndahem nga kjo botë, do të kaloj prej një dore në dorë tjetër, të shumë njerëz, e secili prej tyre do të thotë se e ka pronësua, e pastaj e lënë pas vete dhe vazhdon tjetri e bën bartjen, e kështu me radhë. Kështu pra, çdo gjë që është në tokë, duke filluar prej kopshteve të cilat janë në të, pemëve, ndërtesave të ndërtuara në mënyrë artistike të cilat kanë pamje të bukura dhe tërheqëse, janë stoli me të cilat kënaqen edhe ata të cilët nuk i pronësojnë por që vetëm i shikojnë.

E vërteta është se ne jemi duke e stolisur tokën. Sa herë që njeriu zhvillohet në aspektin teknologjik dhe shpik mjete të reja, toka zbukurohet shumë e më shumë, kështu njeriu e zbukuron tokën dhe bën vendbanime (metropole) të zbukuruara për veten, gjeneratë pas gjenerate, deri sa të trashëgohet e tërë toka me gjithë çka ka në të.

Nëse dëshirojmë ta përkufizojmë me fjalë të shkurta çështjen e përfundimit të tokës, atëherë themi se: Me Zotin e Lartmadhëruar nuk ka si. Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë bëhu ajo bëhet, dhe çdo herë që njeriu zhvillohet, mendon se e ka zotëruar tokën dhe gjithçka ka në të dhe mendon se ka mundësi të bëjë në të çka të dëshiroj. E, atëherë vjen urdhri i Zotit i cili e shkatërron çdo gjë. Ajo stolisje dhe ai zhvillim nuk paraqitet si dukuri prej dukurive të fshehta të cilat duhet besuar, por është një fakt dëshmuar i cili tregon fundin e botës.

KAPITULLI I GJASHTË

Atëherë kur do të na shpaloset e vërteta
Si e pasqyron Kur'ani fisnik fundin e botës?
Kur njeriu e adhuron mendjen e vet
Si do të bëhet rikthimi i trupave të pajetë?
Njeriu dhe elementet e tokës

Atëherë kur do të na shpaloset e vërteta

Cilësi e njeriut është krekosja dhe vetëmashtrimi. Kjo cilësi paraqitet sidomos atëherë kur Zoti ia mundëson atij të zbuloj disa sekrete të gjithësisë, dhe atëherë kur i duket se jeta po shkon në funksion të dëshirave të tij e që në fakt ai shkon drejt shkatërrimi i tij, sepse vendos ligj të tij dhe fillon të largohet nga planprogrami i Allahut. Kjo injorancë dhe ky vetëmashttrim merr përmasa edhe më të mëdha, atëherë kur nuk mbështetet në themele. Ne, sot veçse po dëgjojmë deklarata nga disa injorantë, se: epoka e besimit (imanit) ka përfunduar dhe ka fillua epoka e shkencës. Këto deklarime nuk janë asgjë tjetër, pos një hyrje, në procesin ku njeriu fillon ta adhuroj veten e tij.

Në librin e fuqishëm, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِنَّمَا مَثَلُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا كَمَاءٍ أَنْزَلْنَاهُ مِنْ السَّمَاءِ فَأَخْتَلَطَ بِهِ نَبَاتُ الْأَرْضِ مِمَّا يَأْكُلُ
النَّاسُ وَالْأَنْعَامُ حَتَّى إِذَا أَخَذَتِ الْأَرْضُ زُخْرُفَهَا وَازَّيَّنَتْ وَظَنَّ أَهْلُهَا أَنَّهُمْ قَدِرُونَ عَلَيْهَا
أَنَّهُمْ أَمْرًا لَيْلًا أَوْ نَهَارًا فَجَعَلْنَاهَا حَصِيدًا كَأَن لَّمْ تَغْنَبِ بِالْأَمْسِ كَذَلِكَ نُفَصِّلُ الْآيَاتِ
لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٢٤﴾

“Me të vërtetë, jeta e kësaj bote i ngjanë shiut që Ne e lëshojmë nga qielli, e me të përzihet dheu i tokës dhe bën bimë me të cilat ushqehen njerëzit dhe kafshët. E, kur toka vishet dhe stoliset dhe kur banorët e saj mendojnë se janë zotërues të saj, iu vjen urdhri Ynë, natën ose ditën dhe Ne do ta bëjmë si shkretëtirë, thuaja se dje nuk ishte aspak e lulëzuar. Kështu, Ne ua sqarojmë argumentet tona, njerëzve të cilët mendojnë dhe logjikojnë.” (Junus : 24)

Njeriu ka arritur që ta zbukuroj tokën aq mirë, saqë nuk njeh historia një zbukurim të tillë më parë. Çdo ditë shkenca teknologjike e zhvillon njeriun edhe më shumë, mirëpo parashtrohet pyetja: A ka shtua njeriu diçka prej bazave themelore dhe të domosdoshme të njeriut?

Duhet ta kemi të qartë se njeriu nuk është bazë (paraardhës) e tokës, por i ardhur në të. Ai vjen në tokë, jeton një kohë të caktuar, pastaj përfundon jeta e tij. Njeriu si individ nuk ka lidhje me afatin e kohëzgjatjes së kësaj bote. Kjo, nga shkakut se jeta e kësaj bote zgjat qindra mijëra apo miliona vite. Mirëpo ne nuk i kushtojmë rëndësi kësaj çështjeje. Ajo çka na

intereson më së shumti, është koha e jetës së çdonjërit në këtë botë. Ajo jetë nuk zgjat më shumë se 100 vite, ose edhe pak më shumë.

Kohëzgjatja e gjithësisë na bën që të besojmë në iluzione:

Iluzioni i parë: Kjo botë nuk ka fund. Sado që njerëzit deklarojnë për fundin e botës, ata të cilët jetojnë në të, kanë krijuar bindje se deri në përfundim të kësaj bote, kanë mbetur edhe miliona vite. Kjo bindje nuk është asgjë tjetër, pos iluzion.

Iluzioni i dytë: Gjërat në gjithësi të cilat janë në shërbim tonin, janë ata që na japin neve begati. Kurse e vërteta është se, të mirat që na i jep gjithësia janë prej fuqisë së Zotit të Lartmadhëruar.

Çdo gjë e cila është në këtë gjithësi i nënshtrohet fuqisë së Allahut të Lartmadhëruar. Praktikisht nuk mund të ndodh asgjë në këtë gjithësi jashtë dëshirës së Allahut. Njeriu nuk mund ta stolisë tokën, pos me atë që Zoti i Lartmadhëruar ka vendos të stolisë prej fuqisë së tij. Çdo gjë që është në tokë është stoli për tokën. Këtë e bazojmë me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

إِنَّا جَعَلْنَا مَا عَلَى الْأَرْضِ زِينَةً لَّهَا لِنَبْلُوهُمْ أَئِنَّهُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا ﴿٧﴾ وَإِنَّا لَجَاعِلُونَ مَا عَلَيْهَا صَعِيدًا جُرًّا ﴿٨﴾

“Dhe Ne çdo gjë në tokë e kemi bërë zbukurim për të (tokën), që t’i sprovojmë se kush prej tyre bën vepra të mira. Dhe, Ne do ta bëjmë të shkretë gjithçka që gjendet në të.” (El Kehf : 7, 8)

Kështu pra, çdo gjë që e shohim në tokë, është stoli për të. Sa të jetojmë në tokë, dëgjojmë për stolinë e saj. Kur të vdesësh ti, për ty merr fund stolia e tokës. Ti shkon, por stolia e tokës mbetet në të dhe ditën kur të vjen urdhri i Allahut dhe përfundon kjo botë, atëherë çdo stoli e botës bëhet shkrumb e hi dhe merr fund çdo gjë.

Zoti i Lartmadhëruar ka dërguar argumente për tu vërtetuar se krijues i kësaj bote është Allahu dhe kur e sheh se, njeriu është vetmashtuar dhe e ka lënë planprogramin qiellor, atëherë më nuk ka arsye që Allahu edhe më tej të mbaj në jetë këtë botë. Pas kësaj, Zoti i Lartmadhëruar e shpalos të vërtetën, dhe thua se është duke i thënë njeriut: Ti veç e ke mashtruar veten, je larguar nga planprogrami i Allahut, dhe ke krijuar bindje se ti e sjell këtë tokë sipas dëshirës tënde, e tani do ta shpalosi ty të vërtetën. Të përqendrohemi pak në konceptin e këtij ajeti fisnik në lidhje me këtë që thamë:

وَزَنَّا أَهْلَهَا أَتَّهَمَ قَدِيرُونَ عَلَيْهَا

“...dhe menduan banorët e saj (të tokës) se e zotëruan atë (kadirune alejha)...” (Junus : 24)

Ky opinion i tyre nuk është i vërtetë. Ata nuk e kanë zotëruar atë, por ata vetëm mendojnë, e ky është iluzion dhe gënjeshtër. Atëherë Zoti i Lartmadhëruar me fuqinë e Tij absolute dhe të pakufishme e ndryshon të pandryshuarën (statiken) e kësaj bote e cila nuk mund të kushtëzohet me asnjë kusht.

Si e pasqyron Kur'ani fisnik fundin e botës?

Prej argumenteve të cilat do të pasojnë, nga të cilat njeriu vazhdimisht nuk është i sigurt, e të cilat janë parahyrje e fundit të botës, për disa prej tyre na lajmëron Zoti i Lartmadhëruar, i cili thotë:

إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ ① وَإِذَا النُّجُومُ انْكَدَرَتْ ② وَإِذَا الْجِبَالُ سُيِّرَتْ ③ وَإِذَا الْعِشَارُ عُطِّلَتْ ④ وَإِذَا الْوُحُوشُ حُشِرَتْ ⑤ وَإِذَا الْبِحَارُ سُجِّرَتْ ⑥ وَإِذَا النُّفُوسُ زُوِّجَتْ ⑦ وَإِذَا الْمَوْءُدَةُ سُيِّلَتْ ⑧ بِأَيِّ ذَنْبٍ قُتِلَتْ ⑨ وَإِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ ⑩ وَإِذَا السَّمَاءُ كُشِطَتْ ⑪ وَإِذَا الْجَحِيمُ سُعِّرَتْ ⑫ وَإِذَا الْجَنَّةُ أُزْلِفَتْ ⑬ عَلِمَتْ نَفْسٌ مَّا أُخْضِرَتْ ⑭

“Kur dielli të humb shkëlqimin dhe mblidhet;

Kur yjet të rrëzohen;

dhe malet do të fluturojnë;

Kur devetë me barrë do të braktisen;

dhe egërsirat të grumbullohen;

Kur detet do të pëlçasin nga vlimi;

dhe shpirtrat (me trup) bashkohen;

Kur foshnja e varrosur për së gjalli pyetet se për çfarë faji ishte vrarë;

Kur fletët (librat) do të shpërndahen;

dhe kur qielli do të zhvishet (nga zbukurimi);

Kur xhehenemi do të flakëroj;

dhe xheneti do të afrohet;

(atëherë) çdo njeri do ta kuptoj se çka ka punuar dhe përgatitur.” (Et Tekvirë : 1-14)

Kur do të paraqiten këto dukuri të lloj-llojshme?

Do të paraqiten atëherë kur Zoti i Lartmadhëruar do ta frymëzoj gjithësinë dhe tokën të shkatërroj çdo gjë dhe pastaj pas disa çasteve do të shkatërrohet e tërë gjithësia dhe merr fund. Në lidhje me këtë Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ زِلْزَالَهَا ۖ وَأُخْرِجَتِ الْأَرْضُ أَثْقَالَهَا ۚ وَقَالَ الْإِنْسَانُ مَا لَهَا ۚ يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا ۚ بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَىٰ لَهَا ۚ يَوْمَئِذٍ يَصْدُرُ النَّاسُ أَشْتَاتًا لِّيُرَوْا أَعْمَالَهُمْ ۚ فَمَن يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ۚ

**“Kur të dridhet toka me dridhjen e saj,
kur të nxjerr barrën nga brendia e saj,
e njeriu të thotë: - Ç’po i ndodh asaj?**

Kjo (po ndodh), sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë.

**Atë ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe që t’i shohin veprat e tyre.
Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një grimë, do ta gjejë atë.
E kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një grimë, do ta gjejë atë.” (Ez-Zilzal : 1-7)**

Shpallje do të thotë *shpalosje e fshehtësisë* prej Shpaluesit deri te ai i cili e pranon të shpaluarën me kusht që këtë shpallje të mos mundet ta kuptoj askush tjetër pos pranuesit të të shpaluarës.

Zoti i Lartmadhëruar i shpallë çka të dëshiroj, atij që Ai dëshiron. Shpallja nuk ka të bëjë vetëm me pejgamberët, por përfshinë krijesa të shumta. Zoti i Lartmadhëruar u ka shpallur pejgamberëve të vet, por i ka shpallur edhe nënës së Musait a.s.:

وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ أُمِّ مُوسَىٰ أَنْ أَرْضِعِيهِ ۖ إِذَا خِفَتْ عَلَيْهِ فَإِلَيْهِ فِي الْيَمِّ وَلَا تَخَافِي وَلَا تَحْزَنِي ۚ

“Kështu, Ne e frymëzuam nënën e Musait: Jepi gji atij dhe kur të ndiesh frikë për sigurinë e tij, hidhe në lum.” (El Kasas : 7)

E ka frymëzuar edhe bletën, ashtu siç tregon në ajetin fisnik:

وَأَوْحَىٰ رَبُّكَ إِلَى النَّحْلِ أَنْ اتَّخِذِي مِنَ الْجِبَالِ بُيُوتًا وَمِنَ الشَّجَرِ وَمِمَّا يَعْرِشُونَ ﴿١٨﴾

“Zoti yt e frymëzoi bletën (duke i thënë): Ndërto shtëpi në male dhe në lisa dhe në atë që kanë ngritur njerëzit.” (En-Nahl : 68)

Allahu i ka frymëzua Havarijunët që ta pasojnë Isën a.s., djalën e Merjemës, për të cilët thotë:

وَإِذْ أَوْحَيْتُ إِلَى الْحَوَارِيِّينَ أَنْ ءَامِنُوا بِي وَبِرَسُولِي قَالُوا ءَامَنَّا وَأَشْهَدُ بِأَنَّا مُسْلِمُونَ ﴿١١١﴾

“Dhe, kur i frymëzuam Havarijunët: Besomëni Mua dhe pejgamberët.” (El Maide : 111)

Frymëzimi mund të vijë edhe prej të tjerëve përpos Zotit të Lartmadhëruar. Këtë e bazojmë në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَإِنَّ الشَّيَاطِينَ لَيُوحُونَ إِلَىٰ أَوْلِيَآئِهِمْ لِيُجَدِّلُوا كُفْرًا وَإِنْ أَطَعْتُمُوهُمْ إِنَّكُمْ لَمُشْرِكُونَ ﴿١٦١﴾

“Pa dyshim se shejtanët frymëzojnë dhe nxisin miqtë e vet që t’ju kundërshtojnë juve.” (El Enam : 121)

Mirëpo, frymëzimi legjislativ është posaçërisht shpallja e Zotit të Lartmadhëruar ndaj peygamberëve.

Para se të ndodh fundi i botës, Zoti i Lartmadhëruar e frymëzon tokën. Parashtrohet pyetja, *si*?

Ne kemi thënë më herët, te Allahu nuk ka *si*. Disa prej njerëzve do të thonë se toka është e ngurtë dhe nuk ka mend dhe nuk logjikon, e si mund ta frymëzoj atë Zoti i Lartmadhëruar?

Ne u themi: Zoti i Lartmadhëruar për çdo krijesë prej krijesave të Tij, ka bërë gjuhë të posaçme me të cilën flet. Atë gjuhë ne nuk mund ta kuptojmë, mirëpo e kupton Krijuesi dhe e kupton e krijuara. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَلَكِنَّ لَا تَفْقَهُونَ تَسْبِيحَهُمْ إِنَّهُ كَانَ حَلِيمًا غَفُورًا ﴿١١١﴾

“Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë duke e lavdëruar, por ju nuk mund ta kuptoni madhërimin e tyre.” (El Isra : 44)

Kjo nënkupton se çdo gjë në gjithësi e lavdëron dhe e adhuron Zotin e Lartmadhëruar, mirëpo dituria jonë është e kufizuar, për këtë ne nuk mund ta dëgjojmë dhe nuk mund t’i kuptojmë këto lavdërime. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَسَخَّرْنَا مَعَ دَاوُدَ الْجَبَالَ يُسَبِّحُونَ وَالطَّيْرَ وَكُنَّا فَاعِلِينَ ﴿٧٩﴾

“Ne i nënshtruam malet dhe shpendët, që bashkë me Davudin të madhërojnë (Allahun).” (El Enbija : 79)

Mos gabo të mendosh se krijesat të cilat i shohim, nuk kuptojnë apo janë më pak të logjikshme se ti. Ato krijesa mund të kenë kapacitet më të madh të diturisë sesa ti. Na është e njohur se buburreci ka logjikuar, sepse kur ushtria e Sulejmanit ka mundur t’i shkel dhe t’ua dëmtoj mbretërinë, ai i ka thirr buburrecat e tjerë që të kenë kujdes dhe të hyjnë në shtëpitë dhe vendstrehimet e tyre, për të ikur nga njerëzit dhe të shpëtojnë nga shkelja dhe thyerja e tyre. Lexo thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

حَتَّىٰ إِذَا أَتَوْا عَلَىٰ وَادِ النَّمْلِ قَالَتْ نَمْلَةٌ يَا أَيُّهَا النَّمْلُ ادْخُلُوا مَسْكِنَكُمْ لَا يَحْطِمَنَّكُمْ سُلَيْمَنُ وَجُنُودُهُ وَهُمْ لَا يَشْعُرُونَ ﴿١٨﴾

“Kur arritën në luginën e milingonave, një milingonë tha: - O milingona, hyni në vendbanimet tuaja, që të mos ju shkel Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë.” (En Neml : 18)

- Si logjikoi ky buburrec se Sulejmani dhe ushtria e tij do të kalonin në drejtim të folesë së tyre?

- Nga kush e ka mësuar?

- Si e logjikoi se nëse Sulejmani dhe ushtria e tij do të kalonin afër folesë së tyre, do të shtypnin folenë e buburrecave dhe do t'i thyenin ato?

- Si e ka mësuar dhe si ka logjikuar buburreci se nëse buburrecat do të hynin në vendet e tyre, do të shpëtonin nga shtypja?

(Shaëraviu përgjigjet) Patjetër se buburreci duhet të ketë pasur dituri apo mendje, e cila ia ka mundësuar ta kuptoj këtë. Ne nuk i dimë aftësitë e vërteta të buburrecit, por ne gabimisht e nënçmojmë duke u bazuar në vogëlsinë e saj dhe në atë se mund ta mbysim me lehtësi. Lexo çka i ka thënë Hud-Hudi Sulejmanit a.s.:

فَمَكَثَ غَيْرَ بَعِيدٍ فَقَالَ أَحَطْتُ بِمَا لَمْ مَحِطُ بِهِ ۚ وَجِئْتُكَ مِنْ سَبَإٍ بِنَبَأٍ يَقِينٍ ﴿٢١﴾ إِنِّي وَجَدْتُ
 أَمْرًا تَمْلِكُهُمْ وَأُوتِيَتْ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ وَلَهَا عَرْشٌ عَظِيمٌ ﴿٢٢﴾ وَجَدْتُهَا وَقَوْمَهَا يَسْجُدُونَ
 لِلشَّمْسِ مِنْ دُونِ اللَّهِ وَرَبَّيْنَهُمُ الشَّيْطَانُ أَعْمَلَهُمْ فَصَدَّهُمْ عَنِ السَّبِيلِ فَهُمْ لَا يَهْتَدُونَ
 ﴿٢٣﴾ أَلَا يَسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي يُخْرِجُ الْخَبَاءَ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَيَعْلَمُ مَا تُخْفُونَ وَمَا تُعْلِنُونَ
 ﴿٢٤﴾ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ ﴿٢٥﴾

“Nuk vonoi shumë, e ajo erdhi dhe tha: - Kam marr vesh diçka që ti nuk ke marr vesh deri tani dhe kam sjell informacion të vërtetë prej vendit të quajtur Sebeë. Kam parë një popull që sundohej nga një grua. Ajo posedonte çdo gjë dhe kishte një front madhështor. Kam parë se ajo dhe populli i saj adhuronin diellin, e jo Allahun. Shejtani ua kishte zbukuruar veprat e tyre, duke i larguar nga rruga e drejtë, prandaj nuk ishin të udhëzuar.

Ata nuk i përulëshin në sexhde Allahut, i Cili nxjerr gjithçka që është e fshehur në qiej dhe në tokë dhe e di çfarë mbani fshehur dhe çka e

tregoni haptazi. Allahu është Një, s'ka Zot tjetër pos Tij. Zotit të arshit të madh.” (En Neml : 22-26)

- Si ka mundur Hud-Hudi të shkel në një vend në të cilin nuk ka mundur të shkel Sulejmani a.s., i cili ka pasur ushtri dhe fuqi të cilën nuk e ka pasur asnjë njeri?

- Kush e informoi Hud-Hudin se ajo tokë është vendi i Sebeit dhe atë vend e qeverisë një grua dhe se ajo është mbretëreshë dhe se e ka një front (seli) të madh dhe se ajo dhe populli i saj e adhurojnë diellin në vend të Allahut dhe se ky është pabesim dhe se shejtani ua ka zbukuruar atë veprim dhe i ka penguar që të drejtohen në rrugën e Allahut dhe se për atë arsye ata nuk udhëzohen?

- Kush ia mësoi Hud-Hudit adhurimin e të vetmit Allah dhe se Atij i takon sundimi i qiejve dhe tokës, si dhe çështjet tjera të cilat i përmend ajeti fisnik?

- Si e logjikoi këtë Hud-Hudi derisa ne as që mendojmë për një gjë të tillë?

- Si i mësoi Hud-Hudi të gjitha këto informacione dhe si e diti se ai vend quhet Sebeë?

Kjo dhe rastet tjera të cilat i tregon Kur'ani fisnik, na dëshmojnë se ekzistojnë krijesa të Allahut të cilat posedojnë dituri të cilën ne nuk e dimë dhe se ato krijesa mund të bëjnë dallime dhe të analizojnë, dhe se edhe pse ato janë krijesa instiktive, Zoti u ka dhënë detyra, të cilat mund t'i kryejnë në këtë botë. Kur është kështu me kafshët, shpendët dhe insektet, atëherë pse të mos jetë që toka dhe qiejt, flasin dhe dëgjojnë. Lexo thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

ثُمَّ أَسْتَوَىٰ إِلَى السَّمَاءِ وَهِيَ دُخَانٌ فَقَالَ لَهَا وَلِلْأَرْضِ ائْتِيَا طَوْعًا أَوْ كَرْهًا قَالَتَا أَتَيْنَا طَائِعِينَ



“Pastaj Ai iu kthye qiellit që ishte në gjendje tymi, e i tha atij dhe tokës: Binduni me dëshirë ose me padëshirë. Ata u përgjigjën: Ne bindemi me bindje të plotë.” (El Fussilet : 11)

Zoti i Lartmadhëruar u ka folur qiejve dhe tokës, ndërsa qiejt dhe toka pasi e kanë dëgjuar fjalën e Zotit të Lartmadhëruar i janë përgjigjur. Në lidhje me këtë Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِذَا السَّمَاءُ انشَقَّتْ ① وَأَذْنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ ② وَإِذَا الْأَرْضُ مُدَّتْ ③ وَأَلْقَتْ مَا فِيهَا وَتَخَلَّتْ ④ وَأَذْنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ ⑤

**“Kur qielli qahet,
duke dëgjuar me bindje Zotin e vet,
siç e ka për detyrë.
Kur toka të sheshohet
dhe të flakë atë që ka brenda dhe të zbrazet,
duke dëgjuar me bindje Zotin e vet,
siç e ka për detyrë.” (El Inshikak : 1-5)**

Pjesa “**...duke dëgjuar me bindje...**” ka kuptimin se *ka dëgjuar për detyrën e saj*. Parashtrohet pyetja: Çfarë dimë ne për fundin e kësaj bote?

Kur Zoti i Lartmadhëruar na ka sqaruar disa ligje të gjithësisë, ne e kemi llogaritur se gjithësia na është nënshtuar dhe jemi bërë arrogant duke deklaruar se mund të bëjmë ç’të dëshirojmë. Ne menduam se mundemi që të veprojmë sipas dëshirës tonë, ashtu që ne e urdhërojmë gjithësinë dhe ajo na bindet neve. Nëse i analizojmë këto ajete, kuptojmë se në këtë gjithësi ka dituri (ligje) të pakufishme të cilat janë të panjohura për ne dhe ajo çka e dimë në krahasim me atë çka nuk e dimë është shumë e paktë.

Kur njeriu e adhuron mendjen e vet

Atëherë kur njeriu mohon Zotin e tij dhe e adhuron mendjen e tij dhe krijon bindje se ka zotëruar gjithçka në këtë botë, vjen urdhri i Allahut të Lartmadhëruar që të shkatërroj çdo gjë që ka ndërtuar njeriu në këtë gjithësi. Kur njeriu krijon këtë ndjenjë gënjeshtare se ai ka mundësi të bëjë çka të dëshiroj në këtë botë, atëherë ndërtimet e tij marrin fund. Dielli zbehet, errësohet ose lind nga perëndimi, ose e dobëson forcën e vet, ose e humb dritën e vet.

Është me rëndësi të kuptohet se ligjet e diellit, si lëvizjen e tij të cilën jemi mësuar ta shohim, lindjen e tij në mëngjes dhe perëndimin e tij në mbrëmje, do të ndryshojnë me fuqinë e Allahut,

Ligjet e yjeve të cilat lundrojnë në hapësirë me orbita të lloj-llojshme dhe të cilat nuk ndeshen njëra me tjetrën, të gjitha këto do të ndryshojnë me fuqinë e Allahut.

Po ashtu edhe malet të cilat janë të ngulitura do të lëvizin nga vendet e tyre. Për këtë Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الْجِبَالِ فَقُلْ يَنْسِفُهَا رَبِّي نَسْفًا

“Kur të pyesin ty (O Muhamed) për malet, thuaj: Ato do t’i bëjë hi e pluhur Zoti im.” (TaHa : 105)

(Pra, malet do të bëhen hi e pluhur) Ose do tu lehtësohet pesha, ose do të bëhen si leshi i shprishur. Kjo panoramë, do të ndodh saktësisht para fundit të botës, ashtu që *e bëra* do të *zhbëhet*.

Ajo që ka qenë e krijuar për shërbimin tënd, të ka shërbyer sepse Zoti e ka nënshtruar për ty. Kurse tash (në ditën e kiametit), toka e cila ka dhënë fryte e të korrura, me të cilat ushqehesh, tashmë nuk jep asgjë.

- Kodrat të cilat janë shtylla për mbajtjen e nivelit dhe baraspeshimit të tokës dhe të cilat janë plot me minerale, do të bëhen hi e pluhur.

- Dielli i cili e ngroh tokën, e ndriçon dhe sjell rreze në gjithësi, ai ndalon së kryeri detyrën e tij. Do të përfundoj roli i saj.

- Zbukurimi i tokës, për të cilën ke menduar se është rezultat i yt dhe se do të jetosh përgjithmonë në të, shkon dhe largohet nga ti. Ka marrë fund çdo gjë.

- Shkaqet e kësaj bote humbin funksionin dhe ka marrë fund edhe zotërimi yt për veten tënde, çdo gjë e jotja humb dhe merr fund.

- Edhe këmbët tua nuk të dëgjojnë ty që të shkosh aty ku dëshiron ti.

- Duart me të cilat ke punuar, nuk mund t'i zotërosh më, ato kanë marrë fund, ato nuk punojnë më sipas dëshirës tënde.
- Të gjitha pjesët e trupit, të cilat Zoti i Lartmadhëruar i ka nënshtuar për ty, aty nuk do të nënshtohen ty. Ti mund të shkosh aty ku dëshiron Allahu, qoftë edhe për xhehenem.
- Gjuha flet vetëm ashtu siç dëshiron Allahu.
- Sytë shohin vetëm sipas dëshirës së Allahut e jo siç dëshiron ti. Për këtë arsye ka prej atyre të cilët në këtë dunja kanë parë, por në botën tjetër do të verbohen.

Pse?

Sepse Zoti i Lartmadhëruar i ka dhënë mundësi syve që të shohin në këtë botë dhe Zoti është Ai i cili në botën tjetër e heqë këtë mundësi.

Njerëzit kanë menduar se ata mund të jetojnë me fuqinë e tyre, të ecin me fuqinë e tyre dhe të flasin me fuqinë e tyre. Kur kanë zbuluar ligjin e aromës, kanë menduar se mund ta shfrytëzojnë për qëllimet e tyre në këtë botë dhe se ata e kanë zotëruar atë, mirëpo harrojnë se Zoti i Lartmadhëruar ashtu siç ua ka mundësuar ato specifika ashtu edhe ua merr, siç ua merr çdo gjë tjetër rreth tyre.

Çdo gjë e kësaj bote, në botën tjetër do të ndryshoj.

Kjo është kështu sa i përket atyre të cilët do të jenë gjallë në çastin e përfundimit të kësaj bote, mirëpo parashtrohet një pyetje tjetër:

Sa i përket atyre të cilëve kanë vdekur dhe janë në varreza, në çastin e përfundimit të botës, a do të ndryshojnë ligjet për ta?

Përgjigjja është: Po. Sepse është një fazë e re e jetës për të gjithë pa përjashtim (të vdekur apo të gjallë). Për këtë arsye, do të rikthehen trupat e tyre. Edhe aroma e trupave të tyre do të kthehet. Ata do të dalin nga toka, do të ringjallen nga vdekja e cila ka qenë e domosdoshme në varreza. Zoti i Lartmadhëruar na ka treguar se jeta në varreza nuk është e përgjithmonshme, por është një periudhë specifike e përcaktuar. Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

أَلْهَيْكُمْ الْكَافِرُ ۖ حَتَّىٰ زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ ۖ

“Çka është me ju, gjithë ky rivalitet për të shtuar pasuri, deri sa t'i vizitoni varret.” (Et Tekathur : 1, 2)

Duhet analizuar me kujdes se pse është përdorur fjala **“vizitoni”** e nuk është përdorur fjalia **“të jetoni përgjithmonë”**?

Sa e dimë ne, përkufizimi i “**vizitës**” është kur ti shkon te shoku apo te i afërti që ta **vizitosh**, qëndron një kohë të shkurtë, pastaj largohesh. Nuk bëhesh rezident, por vizitor. Pa marrë parasysh vizita a është e shkurtë apo e gjatë, ajo vizitë përfundon. Kësisoj do të jetë gjendja për të gjithë të vdekurit në varreza, prej kohës së Ademit a.s. e deri te varreza e fundit (e ditës së kiametit), ata janë vizitor të varrezave. Qëndrojnë aty një kohë, pastaj largohen.

Parashtrohet pyetja: Njeriu, në varreza, a e kupton gjatësinë kohore? Ata të cilët kanë vdekur prej kohës së Ademit a.s. e deri në fundin e botës, a e kuptojnë epokën kohore në varret e tyre?

Përgjigjja është: Jo.

Më tregoni, se si do të përgjigjen ata të cilët do të ngrihen nga varret e tyre kur t’i pyes Zoti: - Sa keni qëndruar?

Lexo fjalën e Zotit të Lartmadhëruar:

وَيَوْمَ تَقُومُ السَّاعَةُ يُقْسِمُ الْمُجْرِمُونَ مَا لَبِثُوا غَيْرَ سَاعَةٍ كَذَلِكَ كَانُوا يُؤْفَكُونَ ﴿٥٥﴾ وَقَالَ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ وَالْإِيمَانَ لَقَدْ لَبِثْتُمْ فِي كِتَابِ اللَّهِ إِلَى يَوْمِ الْبَعْثِ فَهَذَا يَوْمُ الْبَعْثِ وَلَكِنَّكُمْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٥٦﴾

“Ditën kur do të vjen çasti (i kiametit), kriminelët do të betohen se kanë qëndruar (në tokë) veçse një periudhë të shkurtër kohore. Kështu, ata shmangen nga e vërteta. Ata të cilëve u është dhënë dituria dhe besimi do të thonë: Jo, me të vërtetë keni qëndruar aq sa ju ka caktuar Allahu në libër – deri në ditën e ringjalljes – e ja kjo është dita e ringjalljes, por ju nuk e keni ditur.” (Err Rrumë : 55, 56)

Kështu pra, njeriu, gjatë jetës në varreza nuk e ndjen kalimin e kohës, sepse koha është masë e ngjarjeve. Përderisa aty nuk do të ketë ngjarje, aty nuk ka kohë. Të gjithë të vdekurit janë të regjistruar në Libër, e Allahu as nuk harron dhe nuk mund t’i humbë asgjë. Zoti i Lartmadhëruar i ka numëruar dhe i ka llogaritur. Atë ditë, Zotit të Lartmadhëruar nuk mund t’i mungoj asnjë prej njerëzve. Regjistrit të atij libri nuk mund t’i shlyhet kurrë asgjë.

Si do të bëhet rikthimi i trupave të pajetë?

Çështja se *si* do të bëhet rikthimi i trupave të pajetë, është çështje me rëndësi të madhe, dhe neve na duhet patjetër që të ndalemi në këtë çështje. Disa pyesin: pasi që të zhduken trupat, Si është e mundur që të kthehen ashtu siç kanë qenë dhe si do të kthehen personat siç kanë qenë?.

Përgjigjen e jep Zoti i Lartmadhëruar kur thotë:

كَمَا بَدَأْنَا أَوَّلَ خَلْقٍ نُعِيدُهُ وَعَدَّا عَلَيْهَا إِنَّا كُنَّا فَاعِلِينَ ﴿١٠٤﴾

“Ashtu siç e kemi filluar krijimin e parë, (ashtu) do ta kthejmë (edhe krijimin e dytë), ky është Premtim nga Ne. Ne kështu do të veprojmë. “
(El Enbija : 104)

Për Zotin e Lartmadhëruar kjo është e lehtë, kur dihet se Zoti i Lartmadhëruar në fillim i ka krijuar krijesat nga asgjëja dhe i ka krijuar pa mostër paraprake. Pra, nëse Ai i ka krijuar në këtë botë pa qenë të krijuar më parë, atëherë është shumë më lehtë t'i krijojë për së dyti dhe t'i rikthejë ato në botën tjetër sepse është krijim prej të krijuarës. Ne e përdorëm fjalën *më lehtë* në aspekt alegorik, që të jetë më e përshtatshme që ta kuptoj logjika njerëzore sepse në të vërtetë për Zotin e Lartmadhëruar nuk ka *të lehtë* dhe *të vështirë*, por çdo gjë për Të është e pakrahasueshme, dhe për Të nuk ka asgjë të pamundur, qoftë në tokë, qoftë në qiell.

Nëse dëshirojmë ta përafrojmë në mendjet tona, themi se: Zoti i Lartmadhëruar, në këtë dunja, çdo njeri e ka dallua nga të tjerët, edhe nëse janë në pyetje majat e gishtërinjve. Prej fillimit të kësaj bote dhe deri në fund të saj, nuk mund të ketë mase të gishtërinjve të njëjta në mes të dy njerëzve.

Çdo trup i njeriut dallon nga tjerët. Për këtë arsye, pjesët e trupit e njohin njëra-tjetrën në një formë të veçantë ose nëpërmjet gjuhës të cilën ua ka mësuar Zoti i Lartmadhëruar. P.sh.: Nëse njeriut i krijohet një plagë e madhe, e shohim se pjesët tjera rreth e përçark asaj plage të madhe shtohen, zhvillohen dhe ngjiten ashtu që të mbyllet plaga dhe të kthehet në gjendjen e mëparshme.

Nëse e marrin një pjesë të trupit dhe dëshirojmë ta ngjisim në një trup tjetër, e shohim se me gjuhën e vet e refuzon dhe nuk e pranon pjesën e trupit tjetër .

Si e dallon trupi se çka është e saj dhe çka është e trupit tjetër, kur të gjitha trupat i ngjajnë njëra-tjetrës?.

Patjetër se ekziston një *shifër specifike* e cila e dallon pjesën e trupit tjetër dhe se ajo shifër nuk mund të shumëzohet. Përderisa, edhe nëse ka sukses operacioni i mbjelljes së një pjese të një trupi tjetër, ai i cili e mbjell organin trupor të tjetri, patjetër duhet që të përdor fasha, lidhëse, qepje dhe ilaçe, ashtu që të pengoj ose të zvogëloj reaksionin e asaj shifre, që të mos i flet dhe ta refuzon organin e huaj i cili është duke u mbjell në atë trup.

Po ashtu, çdo trup e ka erën specifike dalluese, të cilën ne nuk mund ta dallojmë. Mirëpo, disa prej kafshëve, siç është qeni, mund ta dallojnë. Për këtë arsye, kur qeni i merr erë një salvete ose një pjese të rrobës së dikujt, ai me anë të kësaj ere mund ta identifikoj pronarin e saj edhe nëse ai është i përzier në mesin e mijëra personave.

Ka me dhjetëra e dhjetëra specifika të ndryshme të cilat bëjnë që secili prej neve të dalloj nga të tjerët.

Përderisa Zoti i Lartmadhëruar na ka pajisur me këtë dituri, si mëshirë për inteligjencën tonë, na bën që të kuptojmë se kur shpirtrat të kthehen në trupat tanë do të kthehen po në ato trupa në të cilët kanë qenë, sepse ka specifika dalluese nga trupat tjerë të cilat specifika ekzistojnë te secili njeri qysh prej njeriut të parë Ademit a.s. dhe deri tek njeriu i fundit.

Njeriu dhe elementet e tokës

Është e vërtetë se, të gjithë ne jemi të krijuar prej elementeve të tokës dhe secili prej neve ka përbërje të veçantë e cila ndryshon nga përbërja e të tjerëve.

Sa i përket elementeve të trupit, ato nuk janë të njëjta tek secili njeri edhe pse elementet bazë janë të njëjta.

Secili prej neve përbëhet prej 16 elementeve të cilat gjenden në dhe' (tokë). Mirëpo këto ndryshojnë prej njerit tek tjetri. Për ta ilustruar këtë, ne mund t'i marrim si shembull ngjyrat e ylberit, kombinimi i të cilave na jep ngjyra të panumërta. Shembull:

- Nëse e marrim ngjyrën e bardhë dhe i hedhim disa pika të ngjyrës së verdhë, atëherë e bardha ndryshon.
- Nëse i hedhim më shumë pika, ngjyra prapë do të ndryshoj.
- Nëse e marrim ngjyrën e kuqe dhe i hedhim edhe dy-tri pika në të, prapë do të ndryshonte.
- Nëse ia shtojmë shtatë apo tetë pika, prapë do të ndryshonte.

Kjo është si rezultat i asaj se ngjyrat janë një proces tepër specifik dhe çdo shtim uji në secilën ngjyrë na sjell ngjyrë të re.

Nëse kjo është në kapacitetin e krijesës, atëherë si është puna me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar i cili e ka krijuar njeriun prej elementeve të tokës dhe si kemi thënë janë 16 elementet bazë. Çdo atom nga këto elemente po të shtohet do të rezultonte një njeri ndryshe, nëse pakësohet rezulton një njeri ndryshe dhe kështu me radhë dhe kështu me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar formohen kombinacione dhe numra të pakufishëm të njerëzve. Kështu, kjo na bën me dije se, kur të përfundoj kjo botë do të ekzistoj ndryshim thelbësor te çdo njeri prej njeriut bazë. Ekziston një çështje në secilin njeri nga e cila do të ndryshojnë që të gjithë.

Në fundin e botës do të jetë një britmë e cila do ta përfshijë çdo gjallesë, pos atyre që dëshiron Allahu. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَنُفِخَ فِي الصُّورِ فَصَعِقَ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ إِلَّا مَنْ شَاءَ اللَّهُ ثُمَّ نُفِخَ فِيهِ أُخْرَىٰ فَإِذَا هُمْ قِيَامٌ يَنْظُرُونَ ﴿٦٨﴾

“Dhe, do t'i fryhet surit. Do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në tokë, përveç atyre që dëshiron Allahu.” (Ez Zumer : 68)

Ky ajet na tërheq vërejtjen në dy çështje:

1. Zoti i Lartmadhëruar i ka përjashtuar disa nga këto krijesa nga vdekjet të cilat do të ndodhin. Për ta do të jetë sikur të mos ketë pasur kurrfarë vdekjeje, e kush janë këta e di vetëm Allahu.

2. Kur të merr fund kjo botë, me të merr fund edhe dituria njerëzore, me të cilën njeriu ka menduar se e zotëron botën, njerëzit do ta kuptojnë realitetin dhe e kuptojnë se dituria e tyre ka qenë vetëm dituri sipërfaqësore. Këtë e bazojmë në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

كَلَّا لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ الْيَقِينِ ﴿٥٠﴾ لَتَرَوُنَّ الْجَحِيمَ ﴿٥١﴾ ثُمَّ لَتَرَوْنها عَيْنَ الْيَقِينِ ﴿٥٢﴾

“Kujdes, ah sikur ta dini të vërtetën e diturisë. Ju me siguri do të shihni zjarrin e xhehenemit, pastaj do të shihni me syrin e vërtetë.” (Et Tekathur : 5-7)

Atëherë njeriu e kupton diturinë e vërtetë, me të cilën Zoti i Lartmadhëruar na ka pajisur në këtë botë. Duhet ta dimë se kemi tri lloje të diturisë:

- dituria e vërtetë (ilmul jekinë);
- dituria vizuale (ajnul jekinë);
- dituria praktike (hakkul jekinë).

Ne themi: Njohuritë të cilat na ka dhënë Zoti i Lartmadhëruar (nëpërmjet shpalljes) janë **dituria e vërtetë (ilmul jekinë)**, sepse burimin e kanë nga Zoti i Lartmadhëruar.

Besimtari krijon bindje se do të ndodhë në praktikë saktësisht ashtu siç është njoftuar nga Allahu i Lartmadhëruar dhe i duket sikurse është duke e parë para vetes atë lajm. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Ata dinë vetëm anën e jashtme të kësaj bote, ndërsa për botën tjetër janë të pakujdesshëm.” (Err Rrum : 7)

Secili nga ne pajiset me dituri të vërtetë nga Zoti i Lartmadhëruar.

Pas kësaj kur ta shohim të fshehtën, kjo ndodh pasi që del shpirti, pa marrë parasysh a do të jetë në berzah (jetën në varreza) apo në ditën e gjykimit, atëherë shikimi ynë është **shikim (vizuale) i vërtetë (ajnul jekinë)**, dhe atëherë do ta shohim me sytë tanë atë çka na është lajmëruar më parë.

Përderisa pas llogarisë, atëherë do të jetë e **vërteta praktike (hakkul jekinë)** sepse ai i cili hyn në zjarr ai e ka vërtetuar praktikisht diturinë dhe ai e sheh, e ndjen dhe e përjeton, atë për të cilën ka qenë i lajmëruar. Ai i cili hyn në xhenet, ai i shijon dhe i sheh brenda xhenetit të mirat e saj, për të cilat ka qenë i lajmëruar.

Kështu, me përfundimin e botës, merr fund çdo iluzion i diturisë së njeriut, ai sheh përpara çdo gjë në mënyrë praktike, pa iluzion, por me bindje të plotë. I sheh melekët, i sheh shejtanët, e sheh xhenetin, e sheh xhehenemin dhe e kupton madhështinë e Allahut të Lartmadhëruar dhe tashmë e di me bindje të thellë se askush nuk ka as forcë e as fuqi të ndryshoj këtë botë pos Allahut të Lartmadhëruar.

Me përfundimin e botës vjen fundi i shkaqeve të kësaj bote, diejve, hënave dhe yjeve, dhe pastaj lind një tokë e re me dritën e Zotit të Lartmadhëruar, pastaj shpërndahen librat, vendosen peshoret dhe çdo njeri e merr atë çka e ka punuar, dhe në fund do të përfundojnë para Zotit, i cili i ka shkaktuar shkaqet.

Këto janë disa çështje që kanë të bëjnë me fundin e botës. Lusim Allahun që të jetë i kënaqur me ne dhe të na udhëzoj në rrugën e drejtë.

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I PARË 2

DINAMIKA DHE STATIKA	3
NJERIU DHE LIGJI I NDRYSHIMEVE	7
MENDJA DHE ZBULIMET SHKENCORE	10
ME FUQINË E ALLAHUT, JO ME FUQINË TËNDE	15
SEKRETET DHE VETMASHTRIMI I NJERIUT	17

KAPITULLI I DYTË19

FILLIMI DHE MBARIMI.....	20
NJERIU DHE ELEMENTET E TOKËS.....	22
ÇKA ËSHTË SHPIRTI?	25
SHPIRTI ËSHTË PREJ ÇËSHTJEVE TË ZOTIT TIM.....	27
MOS U MASHTRO, SE VDEKJA TË VJEN NË BEFASI	32

KAPITULLI I TRETË.....34

JETA (CIVILIZIMI) DHE BESIMI (IMANI)	35
ALLAHU ËSHTË KRIJUESI MË I BUKUR	39
KJO ËSHTË KRIJIMTARIA E ALLAHUT	41
BESIMI DHE ZHVILLIMI SHKENCOR	46
ARGUMENTET E ALLAHUT DHE CIVILIZIMI NJERËZOR	48

KAPITULLI I KATËRT50

E PRODHUARA HAXXHOHET.....	51
ZBATIMI I PLANPROGRAMIT, SIGURI E SHOQËRISË.....	55
SI DO TË BËHET EKSPOZIMI I ZJARRIT?	59
KOHA DHE JETA NË BERZAH	62

KAPITULLI I PESTË66

STATIKA NDRYSHON.....	67
DEMONSTRIMI PRAKTIK I NGJALLJES DHE RINGJALLJES	69
SHKAQET DHE FUQIA ABSOLUTE	72
KUR DIELLI TË LIND NGA PERËNDIMI	76
QIELLI DHE TYMI	78
SFIDA VLEN EDHE PËR SOT DHE DO TË VAZHDOJ	80

KAPITULLI I GJASHTË.....83

ATËHERË KUR DO TË NA SHPALOSET E VËRTETA.....	84
SI E PASQYRON KUR'ANI FISNIK FUNDIN E BOTËS?.....	87
KUR NJERIU E ADHURON MENDJEN E VET	93
SI DO TË BËHET RIKTHIMI I TRUPAVE TË PAJETË?	96
NJERIU DHE ELEMENTET E TOKËS.....	98